

**VENDIM**  
**Nr. 419, datë 25.6.2014**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E  
KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A, B DHE C, PËR TRANSFERIMIN  
E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET  
RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR  
SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË  
LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKL-JA<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I**  
**TË PËRGJITHSHME**

1. Miratimin e formularit informues për lejet uble tipit A, B dhe C, si dhe të formatit standard të aktit të miratimit/refuzimit për këto leje, sipas shtojcave bashkëlidhur këtij vendimi.  
2. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim që u jepet, përkatësisht, në:

- a) ligjin nr. 10448, datë 14. 7. 2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
- b) ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;
- c) ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;
- ç) ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- d) ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- dh) ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

**KREU II**  
**PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE PËRCAKTIMI I KUSHTEVE  
PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A**

1. Kërkuesi që aplikon pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) për pajisjen me leje mjedisi të tipit A, duhet të dorëzojë këto dokumente:

---

<sup>1</sup> Ky vendim transpozon pjesërisht direktivën 2010/75/BE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes), të ndryshuar, EUR-Lex - 32010L0075 – EN, Fletorja Zyrtare OJ L 334

- a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit A, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit A, sipas nenit 25 të ligjit nr. 10448, datë 14.7. 2011, “Për lejet e mjedisit”;
- c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;
- ç) Kopjen e vendimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është

kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;

d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet;

dh) Relacion rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi.

2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit A nga QKL-ja, dërgon një kopje të aplikimit në institucionet e mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune:

a) Drejtoritë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit;

b) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU);

c) Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM).

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu nuk shprehën brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën.

4. AKM-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit A dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e përmendura në pikën 2 të këtij kreu, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit A, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri.

5. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes, firmos aktin e miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit A ose ia kthen praktikën AKM-së për shtesa apo ndryshime të këtij akti të shoqëruar me argumentet përkatëse.

6. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon vendimin e miratimit ose të refuzimit për leje mjedisi të tipit A në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.

7. Format standard i aktit të miratimit dhe aktit të refuzimit, për lejet e mjedisit të tipit A, është sipas shtojcës 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Akti i miratimit për lejen e mjedisit të tipit A, për çdo instalim, përveç kushteve të përcaktuara në formatin standard të aktit të miratimit, përfshin edhe kushtet e mëposhtme:

a) Vlerat kufi të shkarkimit për ndotësit, në mënyrë të veçantë të atyre referuar në shtojcën 2 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi në fjalë. Vlerat kufi të shkarkimeve përcaktohen duke u mbështetur në natyrën e ndotësve dhe potencialin e tyre për t’u transferuar nga një përbërës i mjedisit në një tjetër;

b) Vlerat kufi të shkarkimeve sipas përcaktimit të shkronjës “a” të pikës 8 të këtij kreu, që zbatohen për grupet e ndotësve dhe jo për ndotës të veçantë, kur kjo është e mundur;

c) Vlerat kufi të shkarkimeve, sipas përcaktimit të shkronjës “a” të pikës 8 të këtij kreu, zbatohen në pikën ku shkarkimet dalin nga instalimi, pavarësisht hollimit që mund t’u ndodhë atyre në distancë nga kjo pikë. Në rastin e shkarkimeve jo të drejtpërdrejta në ujë, gjatë llogaritjes së vlerave kufi të shkarkimeve të instalimit në fjalë, merret në konsideratë edhe përdorimi i një instalimi për trajtimin e ujit, me kusht që të garantohet një nivel i njëjtë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi dhe që një gjë e tillë të mos shkaktojë nivele më të larta ndotjeje në mjedis;

ç) Standardet teknike për funksionimin e një instalimi, të vendosura në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e ujit, menaxhimin e mbetjeve ose të zhurmave apo akte të tjera në fuqi që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, të cilat vlerësohen si vlerat kufi maksimale të shkarkimeve, sipas përcaktimit të shkronjës “a” të pikës 8 të këtij kreu;

d) Vlerat kufi të shkarkimeve, referuar shkronjës “a” të kësaj pike, në përputhje me shkronjën “e” të saj, të mbështetura në TMD-në për llojin e instalimit në fjalë, por jo në ndonjë teknikë ose teknologji të veçantë, që, në çdo rast, merr parasysh karakteristikat teknike të instalimit, vendndodhjen e tij gjeografike dhe kushtet e mjedisit në atë zonë;

dh) Vlerat kufi të shkarkimeve, sipas përcaktimit të shkronjës “a” të pikës 8 të këtij kreu, për instalimet e referuara në pikat A.7.7 (b) dhe 7.8 të shtojcës 1 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, të mbështetura në vlerësime praktike të përshtatshme për këto kategori instalimesh;

e) Vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara nga standardi i cilësisë së mjedisit, kur janë më të ulëta se ato referuar në shkronjën “d” të pikës 8 të këtij neni.

ë) Sipas rastit, vlerat kufi të shkarkimeve sipas përcaktimit të shkronjës “a” pikës 8 të këtij kreu, mund të plotësohen ose zëvendësohen nga parametra të njëjtë ose masa teknike.

Lendfilli që mbulohet nga pjesa 5.2 (a) e shtojcës 1 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, konsiderohet se plotëson kërkesat teknike të këtij ligji në qoftë se ai plotëson kërkesat teknike për lendfille të tilla, siç përcaktohet edhe në legjislacionin përkatës për lendfilllet.

Formati standard i aktit të miratimit për lejen e mjedisit të tipit A mund të përmbajë edhe kushte të tjera, siç kërkohet nga akte ligjore/nënligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

9. Kushtet që vendosen në aktin e miratimit të lejes së mjedisit të tipit A synojnë:

a) të minimizojnë ndotjen në distancë të largët ose ndotjen ndërkufitare;

b) të sigurojnë efektin akumulativ nga instalime ndotëse ekzistuese të tjera;

c) të sigurojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit;

ç) të sigurojnë mbrojtjen e tokës;

d) të sigurojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore;

dh) të sigurojnë kushte të përshtatshme për reduktimin e ndotjes nga zhurma dhe drita;

e) të sigurojnë menaxhimin e duhur të mbetjeve të gjeneruara nga instalimi;

ë) të përcaktojnë kërkesa të përshtatshme për monitorimin e shkarkimeve që specifikojnë metodologjinë dhe frekuencën e matjeve e procedurën e shqyrtimit dhe që sigurojnë se zotëruesi i lejes i jep AKM-së dhe Inspektoratit Shtetëror për Mjedisin (ISHMPU) të dhënat e kërkuara për të kontrolluar përmbushjen e kushteve të lejes së mjedisit të tipit A. Gjithsesi, për instalimet e referuara në pjesën A 7.8. (a, b dhe c) të shtojcës 1 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, në kërkesat e kësaj pike merren parasysh edhe kostot dhe përfitimet;

f) të jenë të përshtatshme për periudhat kur instalimi nuk funksionon normalisht dhe ekziston rreziku i një ndikimi në mjedis. Këto kërkesa kanë të bëjnë me fillimin e operacioneve, rrjedhjet, keqfunksionimet, ndalesat e përkohshme dhe ndalimin përfundimtar të operacioneve;

g) të përcaktojnë hapat që duhen ndërmarrë përpara vënies në punë të instalimit, për të shmangur çdo rrezik nga ndotja, dhe të kthejnë vendndodhjen e instalimit në gjendje të kënaqshme;

gj) të përcaktojnë hapat që duhen ndërmarrë pas mbylljes së instalimit;

h) të kërkojnë që operatori t’i sigurojë rregullisht AKM-së dhe ISHMPU-së rezultatet e vetëmonitorimit të shkarkimeve;

i) të kërkojnë që operatori të informojë pa vonesë AKM-në dhe ISHMPU-në për çdo aksident, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore.

10. Formatu standard i aktit të miratimit për lejen e mjedisit të tipit A nuk e përfshin vlerën kufi për shkarkimet e drejtpërdrejta të gazrave serrë në qoftë se këto shkarkime nga një instalim specifikohen në ndonjë akt tjetër për skemat e tregtimit për shkarkimet e gazrave serrë, për çdo veprimtari që kryhet në atë instalim, dhe në qoftë se nuk është e nevojshme të sigurohet që nuk do të shkaktohet ndotje e konsiderueshme e mjedisit.

11. Përcaktimet e pikës 9 të këtij kreu, nuk zbatohen për instalimet që përjashtohen përkohësisht nga kjo skemë.

12. Afati total për publikimin e vendimit të miratimit ose refuzimit të aplikimit për leje mjedisi të tipit A në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, nga data e marrjes së aplikimit nga

Qendra Kombëtare e Licencimit, është 60 (gjashtëdhjetë) ditë pune.

**KREU III**  
**PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE PËRCAKTIMI I KUSHTEVE**  
**PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT B**

1. Kërkuesi që aplikon pranë QKL-së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B duhet të dorëzojë këto dokumente:

a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;

c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;

ç) Kopjen e vendimit të AKM-së për VNM-në paraprake ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.

dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi.

2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit B nga QKL- ja, dërgon një kopje të aplikimit në institucionet e mëposhtme, të cilët japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune:

a) Drejtoritë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit;

b) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU);

c) Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM).

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën.

4. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit B dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit B, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri.

5. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes, firmos aktin e miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit B ose ia kthen praktikën AKM-së për shtesa apo ndryshime të këtij akti, të shoqëruar me argumentet përkatëse.

6. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon vendimin e miratimit ose të refuzimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve për leje mjedisi të tipit A.

7. Formatin standard i aktit të miratimit dhe i aktit të refuzimit për lejet e mjedisit të tipit B është sipas shtojcës 5, bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Akti i miratimit të lejes së mjedisit e tipit B, për çdo instalim, përveç kushteve të përcaktuara në formatin standard të aktit të miratimit, përfshin edhe kushtet e mëposhtme:

a) Vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, në mënyrë të veçantë të atyre të listuar në shtojcën 2 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi, të cilat përcaktohen duke pasur parasysh natyrën dhe potencialin e tyre për të transferuar ndotjen nga një përbërës i mjedisit në një tjetër;

b) Vlerat kufi të shkarkimeve që kërkohen në shkronjën “a” të pikës 8 të këtij kreu, të cilat mund të zbatohen për grupet e ndotësve dhe jo për ndotës të veçantë, kur kjo është e mundur;

c) Kur një standard i cilësisë së mjedisit kërkon që vlerat kufi të shkarkimeve të një instalimi të jenë më të ulëta se ato që janë vendosur sipas përcaktimit të shkronjës “ç” pikës 8 të këtij

kreu, atëherë vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara sipas shkronjës “a” të pikës 8 të këtij kreu, kërkojnë vlerat kufi më të ulëta të shkarkimeve;

ç) Kur është e përshtatshme, vlerat kufi të shkarkimeve sipas përcaktimit të shkronjës “a” të pikës 8 të këtij kreu, mund të shtohen ose zëvendësohen nga parametra të njëjtë ose masat teknike.

d) Vlerat kufi të shkarkimeve që përcaktohen në përputhje me shkronjën “a” të pikës 8 të këtij kreu, zbatohen në pikën ku shkarkimet dalin nga instalimi, dhe nuk marrin parasysh ndonjë hollim që mund t’u bëhet atyre. Gjatë përcaktimit të vlerave kufi të shkarkimeve në ujë të atij instalimi merret parasysh efekti që mund të ketë një impiant për trajtimin e ujit, me kusht që të garantohet i njëjti nivel mbrojtjeje për mjedisin në tërësi dhe me kusht që një gjë e tillë të mos çojë në nivele më të larta të ndotjes së mjedisit.

dh) Standardet teknike të shkarkimeve të një instalimi, të caktuara në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e ujit, menaxhimin e mbetjeve apo të zhurmave ose akte të tjera në fuqi që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, për qëllime të shkronjës “a”, të pikës 8, të këtij kreu, konsiderohen si vlera maksimale kufi të shkarkimeve.

Formati standard i aktit të miratimit për lejen e mjedisit të tipit B mund të përmbajë edhe kushte të tjera, siç kërkohet nga akte ligjore/nënligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

9. Kushtet që vendosen në aktin e miratimit të lejes së mjedisit të tipit B synojnë:

a) të sigurojnë se nuk shkaktohet asnjë ndotje e konsiderueshme, në veçanti me anë të zbatimit të praktikave më të mira;

b) të sigurojnë mbrojtjen e tokës;

c) të sigurojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore;

ç) të sigurojnë menaxhimin e përshtatshëm të mbetjeve të gjeneruara nga instalimi;

d) të përcaktojnë masat që duhen ndërmarrë për parandalimin e aksidenteve dhe minimizimin e pasojave të tyre;

dh) të përcaktojnë kërkesa të përshtatshme për monitorimin e shkarkimeve, duke përcaktuar metodologjinë dhe frekuencën e matjeve, procedurën e vlerësimit, si dhe të sigurojnë se zotëruesi i lejes i jep AKM-së dhe ISHMPU-së të dhënat e kërkuara për të kontrolluar përmbushjen e kushteve të lejes së mjedisit të tipit B;

e) të përcaktojnë periudhat kur instalimi nuk funksionon normalisht dhe ka një rrezik real që mjedisi të ndikohet gjatë kësaj periudhe. Në mënyrë të veçantë, përfshihen kushte që kanë të bëjnë me fillimin e funksionimit, rrjedhjet e pakontrolluara, keqfunksionimet, pezullimet e përkohshme dhe mbylljen përfundimtare të veprimtarisë;

ë) të përcaktojnë hapat që duhen marrë përpara vënies në punë të instalimit;

f) të përcaktojnë hapat që duhen ndërmarrë përpara vënies në punë të instalimit, për të shmangur çdo rrezik nga ndotja, dhe të kthejnë vendndodhjen e instalimit në gjendje të kënaqshme;

g) të përcaktojnë hapat që duhen ndërmarrë pas mbylljes së instalimit;

gj) të kërkojnë që operatori t’i sigurojë rregullisht AKM-së dhe ISHMPU-së rezultatet e vetëmonitorimit të shkarkimeve;

h) të kërkojnë që operatori të informojë pa vonesë AKM-në dhe ISHMPU-në për çdo aksident, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore.

10. Afati total për publikimi e vendimit të miratimit ose refuzimit të aplikimit për pajisjen me leje mjedisi të tipi B në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, nga data e marrjes së aplikimit nga Qendra Kombëtare e Licencimit, është 40 (dyzet) ditë pune.

#### KREU IV

#### PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE PËRCAKTIMI I KUSHTEVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT C

1. Kërkuesi që aplikon pranë QKL-së për pajisjen me leje mjedisi të tipit C duhet të dorëzojë këto dokumente:

a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit C, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;

c) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit C, sipas nenit 25 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit".

2. AKM-ja, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit C nga QKL-ja, dërgon një kopje të aplikimit pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) të qarkut ku do të jetë vendndodhja e instalimit.

3. ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga AKM-ja, dërgon një kopje të aplikimit në njësinë e qeverisjes vendore (NJQV) përkatëse, e cila jep mendimin e saj me shkrim brenda 3 (tri) ditëve pune.

4. Nëse NJQV-ja përkatëse nuk shprehet brenda afatit, ARM-ja vijon me procedurën.

5. ARM-ja, brenda 7 (shtatë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit C dhe mbledhjes së mendimeve të NJQV-së, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit C, të shoqëruar me argumentet përkatëse.

6. Titullari i ARM-së së qarkut përkatës firmos aktin e miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit C brenda 2 (dy) ditëve pune.

7. Akti i miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit C i dërgohet AKM-së.

8. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon vendimin e miratimit ose refuzimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve për leje mjedisi të tipit C.

9. Format standard i aktit të miratimit dhe aktit të refuzimit të aplikimit për lejet e mjedisit të tipit C është sipas shtojcës 6, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Akti i miratimit për lejen e mjedisit të tipit C, për çdo instalim, përmban, sipas rastit:

a) Vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, në mënyrë të veçantë ato të listuara në shtojcën 2 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi. Vlerat kufi të shkarkimeve, sipas rastit, mund të zbatohen për grupe ndotësish dhe jo për ndotës të veçantë;

b) Kushtet që sigurojnë mbrojtjen e tokës;

c) Kushtet që sigurojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore;

ç) Kushtet që sigurojnë menaxhimin e përshtatshëm të mbetjeve të gjeneruara nga instalimi;

d) Kushtet që sigurojnë mbrojtjen e ajrit dhe mbrojtjen nga ndotja akustike;

dh) Kërkesën që operatori të informojë rregullisht njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, ARM-në përkatëse dhe njësinë e Inspektoratit Shtetëror për Mjedisin të qarkut mbi të dhënat e vetëmonitorimit të shkarkimeve nga ai instalim;

e) Kërkesën që operatori të informojë pa vonesë ARM-në përkatëse dhe njësinë e Inspektoratit Shtetëror për Mjedisin të qarkut për çdo incident ose aksident që ndikon apo mund të ndikojë ndjeshëm mjedisin;

ë) kushte të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

11. Afati total për publikimin, në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, të vendimit të miratimit ose refuzimit të aplikimit për lejen e tipi C, nga data e marrjes së aplikimit nga QKL-ja është 25 (njëzet e pesë) ditë pune.

## KREU V

### NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMEVE TË TIPIT A DHE TË TIPIT B DHE RISHIKIMI I KUSHTEVE TË LEJEVE EKZISTUESE

## SEKSIONI 1

### NDRYSHIMI I PROPOZUAR NË FUNKSIONIMIN E NJË INSTALIMI TË TIPIT A DHE TË TIPIT B

1. Kur operatori i një instalimi të tipit A dhe të tipit B propozon të kryejë një ndryshim në funksionimin e këtij instalimi, ai njofton AKM-në, të paktën, një muaj përpara kryerjes së këtij ndryshimi.

2. Njoftimi i parashikuar në pikën 1, të këtij kreu, bëhet me shkrim dhe përmban një përshkrim të hollësishëm të ndryshimit të propozuar në funksionimin e instalimit.

3. AKM-ja, brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit, vendos:

a) Të njoftojë operatorin, kur nuk e sheh të nevojshëm përditësimin e kushteve të aktit të miratimit të lejes mjedisore;

b) Të njoftojë operatorin se duhet të aplikojë, pranë QKL-së, për ndryshim në kushtet e lejes, kur vlerëson se ndryshimi i propozuar në funksionimin e një instalimi të tipit A dhe/ose të tipit B, sipas njoftimit të bërë nga operatori, mund të shkaktojë ndryshim të funksionimit të instalimit.

4. Procedurat dhe afatet për ndryshim thelbësor të kushteve të aktit të miratimit për lejet e mjedisit të tipit A dhe të tipit B, janë të njëjta me kërkesat e kreut II të këtij vendimi për leje mjedisi të tipit A, dhe të kreut III të tij, për leje mjedisi të tipit B. Në aplikimin pranë QKL-së, fjalët “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” lexohen “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”.

## SEKSIONI 2

### RISHIKIMI I KUSHTEVE TË NJË LEJEJE EKZISTUESE TË TIPIT A, B DHE C

1. Operatori i një instalimi ekzistues, sipas përcaktimeve të neneve 30 dhe 31 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, e shoqëron kërkesën për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit të tipit A, B dhe C me planin e përputhshmërisë dhe formularin e kërkesës për leje mjedisi të tipit A, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Rishikimi i kushteve të lejeve ekzistuese bëhet brenda aftit ligjor të përcaktuar në nenet 30 dhe 31, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe i dokumentacionit përkatës për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të tipit A, B dhe C nga marrja e aplikimit nga QKL-ja deri në publikimin, në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, të vendimit të miratimit ose të refuzimit kryhet brenda:

a) 35 (tridhjetë e pesë) ditëve pune, për leje të tipit A;

b) 25 (njëzet e pesë) ditëve pune, për leje të tipit B;

c) 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, për leje të tipit C.

## KREU VI

### INFORMIMI DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT PËR APLIKIMIN PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A DHE B

1. Kërkuesi, përpara aplikimit në QKL, dërgon në AKM, në njësinë e qeverisjes vendore (NJQV) dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM) ku do të ketë vendndodhjen instalimi një njoftim, me shkrim dhe në formë elektronike (CD, DVD), për aplikimin që do të kryejë për t'u pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B, në të paktën 20 kopje elektronike për secilin institucion.

2. Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”.

b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;

c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;

ç) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;

d) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;

dh) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së;

e) Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;

ë) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;

f) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.

3. AKM-ja publikon, në faqen e saj të internetit, njoftimin sipas pikës 2 të këtij kreu, për të paktën 20 (njëzet) ditë kalendarike, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Pas publikimit të njoftimit në faqen e internetit të AKM-së, kërkuesi publikon në, të paktën, një gazetë të zonës ku do të ushtrohet veprimtaria dhe në një gazetë kombëtare njoftimin për aplikimin, duke iu referuar për informacion më të hollësishëm faqes së internetit të AKM-së. Njoftimi publikohet në, të paktën, dy numra të njëpasnjëshëm të secilës gazetë.

5. Njoftimi në gazetë duhet të përmbajë, të paktën:

a) llojin e instalimit/veprimtarisë;

b) emrin e personit fizik/juridik;

c) adresën e vendndodhjes së instalimit;

ç) adresën e internetit ku është publikuar njoftimi dhe adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.

6. NJQV-ja (bashkia apo komuna), në territorin e së cilës do të jetë vendndodhja e instalimit, pasi merr njoftimin sipas pikës 2, të këtij kreu, e publikon në një vend të dukshëm në mjediset e saj për të paktën 20 (njëzet) ditë.

7. Publiku ka të drejtë të konsultojë në mjediset e NJQV/AKM/ARM dhe të kërkojë një kopje të njoftimit, sipas pikës 2, të këtij kreu, nga NJQV/AKM/ARM, pa pagesë.

8. Publiku mund të bëjë komente, me shkrim ose në mënyrë elektronike, mbi njoftimin për leje mjedisi të tipit A në adresën e AKM-së brenda afatit 20-ditor të publikimit.

9. Në përfundim të afatit 20-ditor, kërkuesi, në bashkëpunim me AKM-në dhe NJQV-në, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve organizon një dëgjese me publikun dhe palët e interesuara, përfshirë OJF-të.

10. Njoftimi për dëgjese me publikun shpallet gjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve:

a) në radio ose TV dhe gazetën vendore;

b) në faqen e internetit të AKM-së dhe NJQV-së;

c) në tabelën e njoftimeve, në një vend të dukshëm në mjediset e NJQV-së dhe ARM-së së qarkut përkatës.

11. Njoftimi duhet të shoqërohet me:

a) llojin e instalimit/veprimtarisë;

b) emrin e personit fizik/juridik;

c) adresën e vendndodhjes së instalimit;

ç) vendin ku gjendet kopja e njoftimit në NJQV-në dhe adresën elektronike të AKM-së ku është publikuar njoftimi.

dh) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të dëgjesës me publikun.

12. Procesverbalit i dëgjesës mbahet nga kërkuesi dhe nënshkruhet nga pjesëmarrësit në dëgjese. Kopje të procesverbalit u vihen në dispozicion publikut, palëve pjesëmarrës në dëgjese, NJQV-së dhe AKM-së.

13. Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjesës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKL.

14. Shpenzimet e organizimit të dëgjesës mbulohen nga kërkuesi.

15. AKM-ja, gjatë hartimit të aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A dhe B, merr

parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku që vlerësohet i vlefshëm dhe argumenton arsyet kur ato nuk janë marrë parasysh.

16. AKM-ja, kur e gjykon të arsyeshme, delegon ARM-në e qarkut përkatës për të marrë pjesë në dëgjuesën me publikun.

## KREU VII

### TRANSFERIMI I LEJEVE TË MJEDISIT TË TIPIT A, B DHE C

1. Për transferimin e aktit të miratimit të lejes së mjedisit për një instalim të tipit A ose B personi fizik apo juridik i cili kërkon t'i transferohet leja, bën kërkesë në AKM për transferimin.

2. Kërkesa referuar në pikën 1, të këtij kreu, shoqërohet nga:

a) Kopje të lejes ekzistuese të mjedisit të tipit A ose B;

b) Ekstraktin e QKR-së së operatorit ekzistues;

c) Ekstraktin e QKR-së së personit fizik apo juridik të cilit do t'i transferohet leja;

ç) Dokumentin ligjor që provon kalimin e instalimit nga operatori ekzistues tek personi fizik apo juridik të cilit do t'i transferohet leja.

3. AKM-ja shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues, sipas pikës 2, të këtij kreu, brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës dhe harton urdhrin e ministrit për transferimin e aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A ose B.

4. AKM-ja përcjell në Ministrinë e Mjedisit urdhrin e ministrit për transferimin e aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A ose B, shoqëruar me argumentet për transferimin dhe kopje të dokumentacionit të përmendur në pikën 2, të këtij kreu.

5. Ministri, brenda një jave, firmos urdhrin e transferimit të aktit të miratimit për lejen e mjedisit të tipit A ose B.

6. AKM-ja mund të kërkojë informacion shtesë rreth dokumentacionit ligjor që provon kalimin e instalimit nga operatori ekzistues tek personi fizik apo juridik, të cilit do t'i transferohet leja, duke përcaktuar një afat 1 - muajor për kthimin e përgjigjes.

7. Afati i përmendur në pikën 6, të këtij kreu, nuk përlllogaritet në afatin 1 - muajor për shqyrtimin e transferimit të lejes.

8. Në rast se kërkuuesi nuk përgjigjet brenda afatit prej një muaji, siç përcaktohet në pikën 5 të këtij kreu, konsiderohet se kërkuuesi ka hequr dorë nga transferimi i lejes së mjedisit.

9. Ministri ia përcjell AKM-së urdhrin për transferimin e aktit të miratimit për lejet e mjedisit të tipit A ose B.

10. Personi fizik ose juridik aplikon pranë QKL-së për transferimin e lejes së mjedisit të tipit A dhe B duke dorëzuar urdhrin e ministrit dhe kopje të lejes ekzistuese.

11. AKM-ja, brenda 8 (tetë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga QKL-ja, harton aktmiratimin për transferimin e aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A ose B dhe e dërgon te ministri.

12. Ministri firmos aktmiratimin për transferimin e aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A ose B dhe ia dërgon AKM-së.

13. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon, në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, aktmiratimin për transferimin e aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A ose B.

14. Për transferimin e aktit të miratimit të lejes së mjedisit për një instalim të tipit C, personi fizik apo juridik i cili kërkon t'i transferohet leja bën kërkesë në ARM për transferimin, të cilën e shoqëron me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij kreu.

15. ARM-ja shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës dhe firmos dokumentin e transferimit të aktit të miratimit për leje mjedisi të tipit C.

16. ARM-ja mund të kërkojë informacion shtesë rreth dokumentacionit ligjor që provon kalimin e instalimit nga operatori ekzistues te personi fizik apo juridik, të cilit do t'i transferohet leja, duke përcaktuar një afat njëmuor për kthimin e përgjigjes.

17. Afati i përmendur në pikën 15, të këtij kreu, nuk përlogaritet në afatin njëmuor për shqyrtimin e transferimit të lejes.

18. Në rast se kërkuesi nuk përgjigjet brenda afatit prej 1 muaji, siç përcaktohet në pikën 16, të këtij kreu, konsiderohet se kërkuesi ka hequr dorë nga transferimi i lejes së mjedisit.

19. Personi fizik ose juridik që aplikon pranë QKL-së për transferimin e lejes së mjedisit të tipit C, dorëzon dokumentin e transferimit, të lëshuar nga ARM-ja, dhe kopje të lejes ekzistuese.

20. AKM-ja, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga QKL-ja, e dërgon atë pranë ARM-së të qarkut përkatës.

21. ARM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune, harton aktmiratimin për transferimin e aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit C, i cili firmoset nga titullari i ARM-së së qarkut përkatës dhe e dërgon tek AKM-ja.

22. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon, në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, aktmiratimin për transferimin e aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit C.

23. Afati total për publikimin, në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, të vendimit të miratimit të aplikimit për transferimin e aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A, B ose C, është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së aplikimit nga QKL-ja.

## KREU VIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban, administron dhe përditëson regjistrin e lejeve të mjedisit të tipit A dhe B.

2. ARM-ja mban, administron dhe përditëson regjistrin e lejeve të mjedisit të tipit C, për instalimet që operojnë në qarkun për të cilin është përgjegjëse.

3. Mënyra e administrimit dhe formati i regjistrit miratohen me urdhër të ministrit.

4. AKM-ja publikon, në faqen e saj të internetit, listën e akteve të miratimit për leje mjedisi të tipit A dhe B, e cila përmban:

- a) Emrin e subjektit dhe të administratorit;
- b) Llojin e instalimit;
- c) Vendndodhjen e instalimit;
- ç) Datën e miratimit të aktit.

5. ARM-ja publikon në faqen e saj të internetit listën e akteve të miratimit për leje mjedisi të tipit C, për instalimet që operojnë në qarkun për të cilin është përgjegjëse, e cila përmban:

- a) Emrin e subjektit dhe të administratorit;
- b) Llojin e instalimit;
- c) Vendndodhjen e instalimit;
- ç) Datën e miratimit të aktit.

6. AKM-ja dërgon, pranë ISHMPU-së dhe Ministrisë së Mjedisit, kopje të aktit të miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B.

7. ARM-ja dërgon, pranë njësisë së ISHMPU-së të qarkut përkatës, kopje të aktit të miratimit të lejeve të mjedisit të tipit C.

8. Ngarkohet ministri të nxjerrë urdhrin, në zbatim të pikës 3, të kreut VIII, të këtij vendimi.

9. Udhëzimi nr. 3, datë 2.12.2013, i ministrit të Mjedisit, "Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore të tipit A, B dhe C për aktivitete të reja dhe ekzistuese", shfuqizohet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, agjencitë rajonale të mjedisit, njësitë e qeverisjes vendore dhe Qendra Kombëtare e Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

SHTOJCA 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. \_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_\_\_

## KËRKESË PËR LEJE MJEDISI Tipi A

### AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Numri i Identifikimit të Kërkesës .....

Emri i Kërkuesit:

- a) Person juridik (Kompania) ( Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa,)

\_\_\_\_\_

ose

- b) Personi Fizik ( emri, mbiemri, Nr NIPT, adresa.....)

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar) \_\_\_\_\_
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kolonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar) \_\_\_\_\_
3. Vendndodhja \_\_\_\_\_

(Qark) .....

(Bashki)

(Komunë)

Emri, titulli i personit të autorizuar .....

( Firma, Vula)

Data.....

Tarifa e paguar në datë .....

- për kërkesë për leje mjedisi  
 ndryshim të kushteve të lejes

## INFORMACION MBI KËRKUESIN/OPERATORIN

### 1.1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Emri i Kompanisë	
Statusi Ligjor	
Ortakët/Aksionerët e Kompanisë(sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKR)	
Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë	
Adresa postale e Kompanisë, nqse ndryshon nga adresa e mësipërme	
Numri i rregjistrimit të Kompanisë(NIPT)	
Kodi kryesor i aktivitetit (sipas kolonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit nr 10448, datë 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit")	
Kodi SNAP <sup>1</sup>	
Kodi NOSE-P <sup>2</sup>	
Numri i Punonjësve	
Përfaqësuesi i autorizuar	
Emri dhe Mbiemri	
Pozicioni në Kompani	
Telefoni	
Faksi	
E-mail	

### 1.2. INFORMACION MBI INSTALIMIN/IMPIANTIN

Emri i instalimit/impianit <sup>3</sup>	
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti	
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	
Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi <sup>4</sup>	

<sup>1</sup> Nomenklatura e zgjedhur për burimet e ndotjes së ajrit, të specifikuar në Aneksin 1 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedis për kërkuesit

<sup>2</sup> Nomenklatura për burimet e shkarkimit, të specifikuar në Aneksin 1 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedis për kërkuesit

<sup>3</sup> Përshkruaj titullin sipas kolonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

Kapaciteti i projektuar	
-------------------------	--

Tabela në vijim përfshin listën e të gjithë lejeve, liçensave, autorizimeve të përfuara në datën e dorëzimit të Formularit të kërkesës.

Leja, Liçensa, Autorizimi	Nr. Ref.	Data e Lëshimit	Periudha e vlefshmërisë

Duhet të përfshihen të gjitha lejet, liçensat, autorizimet e vlefshme në datën e dorëzimit të kërkesës.

### 1.3. INFORMACION MBI PERSONIN E KONTAKTIT TË AUTORIZUAR NGA ADMINISTRATORI NË LIDHJE ME LEJEN

Emri dhe Mbiemri	
Adresa	
Pozicioni në kompani	
Telefoni	
Faksi	
E-mail	

### 1.4. PRONËSIA E TOKËS

Emri/adresa e pronarit/pronarëve të tokës, numri i identifikimit të pronës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP<sup>5</sup> ku janë ndërmarrë (nëqoftëse ndryshojnë nga ato të kërkuarit) apo do të ndërmerren aktivitetet (nëqoftëse ndryshojnë nga ato të kërkuarit).

Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve	
Të dhëna për pronësinë e tokës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP <sup>1</sup>	

<sup>4</sup> Shkruani kodet e specifikuar në kolumnën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kolumnën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

<sup>5</sup> Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Adresa	
Informacion për kontratën e qerasë nëse ka Nr. i kontratës së qerasë nëse kërkuesi nuk është pronar i tokës deri në këtë moment	

### 1.5. PRONËSIA E IMPIANTIT

Emri dhe adresa e pronarit të impiantit ku kryhet aktiviteti, si dhe informacion mbi kontratën e qerasë nëqoftëse kërkuesi nuk është pronari i impiantit.

Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve	
Adresa	
Informacion mbi kontratën (qeradhënësi dhe qeramarrësi, afati i kontratës, mënyrat e përfundimit të kontratës; periudha e vlefshmërisë) Bashkëngjisni një kopje të kontratës së qerasë	

### 1.6. KËRKESA ËSHTË BËRË PËR:<sup>6</sup>

Shënoni ✓ në kutinë përkatëse

- Impiante dhe instalime të reja
- Impiante dhe instalime ekzistuese
- Ndryshim i konsiderueshëm në impiantet dhe/ose instalimet ekzistuese
- Ndërprerje të aktiviteve

Në shtojcën 1.2 duhet të paraqisni një ekstrakt nga dokumentet e planifikimit/projektit për instalimin/impiantin e ri, që ka të bëjnë me zonën në fjalë, në mënyrë që të vlerësohen efektet kumulative të pritshme ose ndikimet negative në aktivitetet e ardhshme. Në ekstrakt të përfshihet edhe një legjendë që shpjegon qëllimin e synuar për zonën në fjalë si dhe qëllimin për një zonë më të gjerë zhvillimi.

<sup>6</sup> Kjo kërkesë nuk i referohet transferimit të lejes në rast të ndryshimit të pronësisë

### 1.7. INFORMACION NË LIDHJE ME NDRYSHIME TË KONSIDERUESHME TE PROPOZUARA TE LEJES SË TIPIT A PER NJE INSTALIM/IMPIANT EKZISTUES

Operatori/kërkuesi plotëson tabelën e mëposhtme vetëm kur kërkon ndryshime të kushteve të lejes së mjedisit të Tipit A, për një instalim/impiant ekzistues.

Emri i impiantit (sipas lejes ekzistuese të mjedisit)	
Data e dorëzimit të kërkesës për ndryshime të lejes së lëshuar të mjedisit të Tipit A	
Data e lëshimit të lejes ekzistuese të mjedisit, të Tipit A (refero <b>Nr. e identifikimit të Lejes sipas Regjistrit të AKM</b> )	
Vendodhja e impiantit/instalimit (qarku/bashkia/komuna, numri kadastral)	
Arsyeja/arsyet për ndryshimin e kërkuar në lejen e mjedisit	

Jepni përshkrimin e ndryshimeve të propozuara.

### 2. PËRSHKRIMI I INSTALIMIT, NJËSITË E TIJ TEKNIKE DHE AKTIVITETET/VEPRIMTARITË QË LIDHEN DREJTPËRDREJT ME TË

Përshkruani instalimin, metodat, proceset kryesore dhe ato ndihmëse, pakësimin e ndotjes dhe sistemet e rikuperimit të mbetjeve si dhe operacionet e instalimit. Siguroni kopje të planeve, skicave ose hartave (planet e terrenit dhe hartat e vendndodhjes, rrjedhat e procesit teknologjik në lidhje me operacionet e instalimit) dhe detaje të tjera të nevojshme për të përshkruar të gjitha aspektet e aktiviteteve të instalimit.

Të gjithë informacionet përkatëse duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 2**.

### 3. MENAXHIMI I INSTALIMIT

Jepni informacion të detajuar në lidhje me strukturën e menaxhimit të instalimit. Përfshini në informacion strukturën organizative ku tregohen qartë pozicionet që kanë të bëjnë me menaxhimin mjedisor, menaxhimin e prodhimit, kontrollin e cilësisë, monitorimin, etj. Siguroni të gjithë dokumentat përkatës në lidhje me politikën e menaxhimit mjedisor.

Jepni informacion nëse menaxhimi mjedisor dhe/ose sistemet e menaxhimit të cilësisë janë të çertifikuar nga organe çertifikues të akredituar.

Në rast se keni një sistem të çertifikuar të menaxhimit të mjedisit të vënë në jetë në instalim, jepni informacion në lidhje me standardin përkatës dhe bashkëngjisni kopjen e çertifikatës së akreditimit (ECOLABEL, EMAS, ISO 14001, etj.)

Përshtetësi kushtet e punës, siç tregohet në tabelën në vijim:

KUSHTET E PUNËS					
Numri total i punonjësve					
Shpërndarja e punonjësve	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBALTJA	MAGAZINIMI	TË TJERA
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat/ administrata		Instalimet		
Orët e punës	Zyrat/ administrata		Instalimet		
Numri i orëve të punës në vit					
Numri i orëve në vit					
Variacionet sezonale					
Turnet dhe numri i punëtorëve për turn	Gjatë variacioneve stinore		Pjesa tjetër e vitit		
Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllet	Pushimet				
	Ndërprerje të rregullta të funksionimit				

Të gjithë informacionet përkatëse duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 3**.

#### 4. LËNDËT E PARA DHE MATERIALET NDIHMËSE, MATERIALE TË TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NË IMPIANT/INSTALIM

Hartoni një listë të lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse, përzjerjeve të materialeve, lëndës djegëse, dhe energjisë së gjeneruar ose të përdorur në instalim.

Lista e hartuar duhet të jetë e plotë dhe duhet të përfshijë të gjitha materialet, lëndët djegëse, materialet e ndërmjetme, kimikatet laboratorike dhe produktet e përdorura.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet materialeve dhe produkteve që përbëhen nga/ose përmbajnë substanca të rrezikshme. Lista e mësipërme duhet të specifikojë Kodin e Riskut për secilën substancë sipas Skedës së të Dhënave të Sigurisë së Materialit (SDSM) të prodhuesit.

Për sa më sipër, duhet të plotësohen Tabelat 4.1.1 – 4.1.4.

Të gjithë informacionet përkatëse duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 4**.

**Tabela 4.1.1** Detaje mbi lëndët e para, materialet e ndërmjetme, produktet etj, që lidhen me proceset dhe përdoren apo gjenerohen në impiant/instalim.

Nr. Ref. ose Kodi	Materiali/ Substanca <sup>7</sup>	Numri CAS <sup>8</sup>	Kategoria e Materialeve të Rrezikshme <sup>9</sup>	Sasia që zakonisht magazinohet (t)	Përdorim i vjetor(t)	Konsumi për njësi produkti	Natyra e përdorimit	Kodi i Riskut R <sup>10</sup> -	Kodi i Sigurisë S <sup>11</sup> -

<sup>7</sup> Nëse materialet përfshijnë më shumë substanca të rrezikshme, jepni informacion të detajuar për secilën substancë

<sup>8</sup> Shërbim i Abstrakteve Kimike (CAS - Chemical Abstracts Service)

<sup>9</sup> (Rregullore Nr. 1272/2008 (KE) për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzjerjeve) ose kategoria e Mbetjeve/Materialeve të Rrezikshmeve sipas Rregullores për Kategoritë e Mbetjeve duke përfshirë listën sipas legjislacionit përkatës shqiptar mbi mbetjet

<sup>10</sup> Sipas Aneksit 2 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisi për kërkuuesit

**Tabela 4.1.2** Detaje mbi lëndët e para, materialet ndihmëse, materialet e ndërmjetme, produktet etj, të cilat janë të lidhura me proceset, dhe përdoren apo gjenerohen në vend

Nr. Ref. ose Kodi	Materiali/ Substanca	Erëra të pakëndshme			Substancat Prioritare <sup>12</sup>
		Erëra të pakëndshme Po/Jo	Përshkrimi	Pragu i ndjeshmërisë µg/m <sup>3</sup>	

<sup>12</sup> Lista e substancave prioritare të harmonizuara me listat në legjislacionin shqiptar mbi substancat e rrezikshme dhe të dëmshme në ujëra

**Tabela 4.1.3** Detaje mbi konsumin e ujit:

INPUTI - UJËRAT HYRËSE									
Furnizimi me ujë nga rrjeti publik		Sigurimi i ujit nga burime sipërfaqësore		Sigurimi i ujit nga burime vetiake		Sigurimi i ujit nga reshjet e mbledhura		Sigurimi i ujit nga riciklimi i brendshëm	
Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%

**TRAJTIMI I MËPARSHËM** (jepni sasinë e ujit të trajtuar më parë me qëllim përmirësimin e cilësisë para përdorimit të tij brenda procesit)

PIKAT E KONSUMIT TË UJIT											
Tualetet/Banjat		Proceset e prodhimit		Prodhimi i energjisë/avullit		Ujë Ftohës		Pastrimi industrial		Pastrime të tjera	
Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%

OUTPUTI - UJËRAT QË DALIN		
Pjesë integrale e produktit, nga produktet, mbetjet	Shkarkimet (nga pajisjet vetiake të trajtimit/kanalizimeve)	Evaporimi (shkarkimi i avullit në ajër)

KOSTOT E UJIT			
EMERTIMI	BAZA (m <sup>3</sup> /year)	KM/m3*	TOTALI
Kostot e Ujit			
TOTALI			

\* Kostot e ujit: sasia e konsumuar + tarifën fikse.

Tabela 4.1.4 Detaje mbi konsumin e Energjisë

KONSUMI I ENERGJISË			
Burimi	Konsumi Total (kWh/g, t/g dhe të ngjashme)	Konsumi për njësi prodhimi	Përqindja e konsumit total (%)
Energjia Elektrike			
Gazi Natyror			
Qymyri			
Karburanti			
Të tjera			

## 5. MENAXHIMI I MATERIALEVE

### 5.1. MENAXHIMI I LËNDËVE TË PARA, MATERIALEVE TË NDËRMJETME DHE PRODUKTEVE

Për të gjitha materialet e listuara në tabelat 4.1.1 dhe 4.1.2, jepni informacion të detajuar mbi kushtet që kanë të bëjnë me dorëzimin dhe marrjen e tyre, kushtet e magazinimit (vendodhjen e magazinës brenda instalimit dhe zonës së impiantit, metodën e magazinimit), dhe sistemin e transportimit/transferimit brenda instalimit dhe zonës së impiantit.

Jepni informacion për gjendjen në tërësi të tubacioneve, rezervuarëve etj, për të siguruar papërshkueshmërinë dhe testimin final të tyre etj. Për instalimet e reja, jepni një plan kontrolli.

Të gjithë informacionet përkatëse duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 5**.

### 5.2. MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA DHE TË LËNGSHME NË INSTALIM/IMPIANT

Jepni informacion të detajuar për secilën kategori mbetjesh, si më poshtë:

- Emri;
- Përshkrimi dhe natyra e mbetjes;
- Burimi;
- Ku magazinohet dhe karakteristikat e hapësirës së magazinimit;
- Sasia/volumi në ton dhe m<sup>3</sup>;
- Periudha(t) e gjenerimit;
- Analizat (duke përfshirë testimin dhe metodat e sigurimit të cilësisë);
- Kodi sipas listave të mbetjeve referuar legjislacionit shqiptar mbi Kategoritë e Mbetjeve.

Në rastin kur mbetje të veçanta paraqesin karakteristika të një mbetje të rrezikshme, kjo duhet të jepet qartë në informacion, në përputhje me përcaktimin e mbetjes së rrezikshme në ligjin shqiptar për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Plotësoni Tabelat 5.2.1 dhe 5.2.2, për secilën tipologji mbetjesh, përkatësisht për mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet jo të rrezikshme. Duhet të jepen si informacion plotësues, detaje mbi numrin e regjistrimit të liçensës/lejes së grumbullimit të mbetjeve të operatorit si dhe detaje të operatorit me të cilin është nënshkruar kontrata për rikuperimin/asgjësimin e mbetjeve ose datën e përfundimit të afatit të lejeve.

Të gjitha informacionet shtesë duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 5**.

Në rast asgjësimi të mbetjeve,<sup>13</sup> brenda instalimit/impianit, duhet të jepet informacion i detajuar mbi vendin e asgjësimit duke përfshirë ndërmjet të tjerave procedurat në lidhje me zgjedhjen e vendit, hartat e vendit ku tregohen qartësisht zonat e mbrojtura ujore, kushtet gjeologjike dhe hidrologjike, planin e aktivitetëve, përbërjen e mbetjeve, menaxhimin e gazit dhe ujit të filtruar, së bashku me planin e menaxhimit të mbetjeve pas ndërprerjes së operacioneve në këtë vend. Në rast të asgjësimit të mbetjeve, brenda instalimit/impianit, duhet të jepet informacion i detajuar mbi vendin e asgjësimit (duke përfshirë ndërmjet të tjerave procedurat në lidhje me zgjedhjen e vendit, hartat e vendit ku tregohen qartësisht zonat e mbrojtura ujore, kushtet gjeologjike dhe hidrologjike,

<sup>13</sup> Sipas përcaktimit të dhënë në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve

planin e aktivitetit, përbërjen e mbetjeve, menaxhimin e gazit dhe ujit të filtruar, së bashku me planin e menaxhimit të mbetjeve pas ndërprerjes së operacioneve në këtë vend.

Projekti i plotë i lëndfillit duhet të përfshihet në **Aneksin 5**.

**Tabela 5.2.1:** Mbetjet – Rikuperimi/asgjësimi, i mbetjeve të rrezikshme

- Periudha(t) e gjenerimit;
- Analizat (duke përfshirë testimin dhe metodat e sigurimit të cilësisë);
- Kodi sipas listave të mbetjeve referuar legjislacionit Shqiptar mbi Kategoritë e Mbetjeve.

Plotësoni Tabelat 5.2.1 dhe 5.2.2, për secilën tipologji mbetjesh, përkatësisht për mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet jo të rrezikshme. Duhet të jepen si informacion plotësues, detaje mbi numrin e regjistrimit të liçensës/lejes së grumbullimit të mbetjeve të operatorit si dhe detaje të operatorit me të cilin është nënshkruar kontrata për rikuperimin/asgjësimin e mbetjeve ose datën e përfundimit të afatit të lejeve.

Të gjitha informacionet shtesë duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 5**.

Në rast asgjësimi të mbetjeve,<sup>1</sup> brenda instalimit/impiantit, duhet të jepet informacion i detajuar mbi vendin e asgjësimit duke përfshirë ndërmjet të tjerave procedurat në lidhje me zgjedhjen e vendit, hartat e vendit ku tregohen qartësisht zonat e mbrojtura ujore, kushtet gjeologjike dhe hidrologjike, planin e aktiviteteve, përbërjen e mbetjeve, menaxhimin e gazit dhe ujit të filtruar, së bashku me planin e menaxhimit të mbetjeve pas ndërprerjes së operacioneve në këtë vend.

Projektimi i plotë i lëndës duhet të përfshihet në **Aneksin 5**.

---

<sup>1</sup> Sipas përcaktimit të dhënë në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve

Tabela 5.2.1: Mbetjet – Rikuperimi/asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme

Tipi i mbetjes	Numri nga Rregullorja për Kategoritë e Mbetjeve, duke përfshirë listat	Vendi kryesor i gjenerimit	Sasia		Trajtimi ose asgjësimi në instalim/implant (Metoda dhe vendndodhja)	Trajtimi, rikuperimi ose riciklimi jashtë instalimit/implantit (Metoda, vendi, kontraktori)	Asgjësimi/trajtimi jashtë instalimit/implantit (Metoda, vendi, kontraktori)
			Ton/muaj	m <sup>3</sup> /muaj			

Tabela 5.2.2 Mbetjet – Rikuperimi/asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme

Tipi i mbetjes	Numri nga Rregullorja për Kategoritë e Mbetjeve, duke përfshirë listat	Vendi kryesor i gjenerimit	Sasia		Trajtimi ose asgjësimi në instalim/implant (Metoda dhe vendndodhja)	Trajtimi, rikuperimi ose riciklimi jashtë instalimit/implantit (Metoda, vendi, kontraktori)	Asgjësimi/trajtimi jashtë instalimit/implantit (Metoda, vendi, kontraktori)
			Ton/muaj	m <sup>3</sup> /muaj			

### 5.3 ASGJËSIMI I MBETJEVE JASHTË INSTALIMIT

Në rast të asgjësimit të mbetjeve jashtë territorit të instalimit/implantit, është e nevojshme të siguroni një informacion të detajuar mbi vendin e asgjësimit si dhe të bashkëngjisni kontratat e lidhura me kompanitë/operatorët, të cilët kryejnë shërbimin e grumbullimit dhe transportimit të të gjitha llojeve të mbetjeve.

Të gjithë informacionet përkatëse duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 5**.

## **6 SHKARKIMET**

### **6.1 SHKARKIMET NË AJËR**

#### **6.1.1 INFORMACION I DETAJUAR PËR SHKARKIMET NGA BURIMET E IDENTIFIKUESHME TË NDOTJES NË AJËR**

Operatori duhet të paraqesë një listë të gjithë burimeve të shkarkimeve në ajër. Planimetritë, skicat dhe dokumentat përkatëse që tregojnë vendndodhjen e pikës së shkarkimit (kopje të planimetrisë së përfshirë në projektin e instalimit) duhet të përfshihen gjithashtu në informacion. Të gjithë informacionet e kërkuara më sipër duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 6**.

Të gjitha shkarkimet nga burimet e identifikueshme të ndotjes duhet të përshkruhen me detaje. Për shkarkimet nga instalimet me bojlerë/kaldaja me avull, me hyrje nxehtësie më shumë së 2MW, duhet të plotësohet Tabela 6.1.1. Burimet e shkarkimeve të këtij lloji duhet të shënohen si A1 (A1-1....A1-n).

Për të gjithë burimet kryesore të shkarkimeve, duhet të plotësohen Tabelat 6.1.2 dhe Tabela 6.1.3. Burimet kryesore të shkarkimeve në ajër duhet të shënohen si A2 (A2-1....A2-n).

Në rast të burimeve më të vegjël apo të mundshëm të shkarkimeve, duhet të plotësohet Tabela 6.1.4. Këto burime më të vegjël ose të mundshëm duhet të shënohen si A3 (A3-1....A3-n).

Pjesë e informimit duhet të jetë edhe informacioni mbi lartësinë e pikave të shkarkimit, lartësinë e , çative, rrjedhjeve dhe presionit.

**Tabela 6.1.1** Shkarkimet në ajër nga boljerët/kaldajat me avull (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

**Pika e shkarkimit:**

Emërtimi/përcaktimi i pikës së shkarkimit	
Përshkrimi:	
Koordinatat : (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	
Informacion për oxhakun Diametri:	M
Lartësia nga toka (m):	M
Data e vënies në punë:	

**Karakteristikat e shkarkimit:**

Kapaciteti i boljerit/kaldajës Avulli që del: Nxehtësia që hyn:	Kg/orëMW		
Lëndë djegëse Tipi: Konsumi maksimal i lëndës djegëse Përmbajtja e squfurit %:	Kg/orë		
NOx	mg/Nm <sup>3</sup> 0°C. 3% O <sub>2</sub> (lëng ose gaz), 6% O <sub>2</sub> (lëndë djegëse e ngurtë)		
Përqëndrimi aktual i O <sub>2</sub> %			
Rrjedhjet maksimale të gazeve	m <sup>3</sup> /orë		
Temperatura	°C(maks.)	°C(min.)	°C(mes.)

Jepni periudhën ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke përfshirë variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qënë vënia në punë dhe/ose ndërprerja e punës):

Periudha e shkarkimit (mesatare)	min/orë	orë/ditë	ditë/vit
----------------------------------	---------	----------	----------

**Tabela 6.1.2** Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

Nr. Referencës së pikës së shkarkimit	
Burimi i shkarkimit	
Përshkrimi	
Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	
Informacion mbi oxhakun Diametri Lartësia nga toka(m)	
Data e fillimit të shkarkimeve	

**Karakteristikat e shkarkimit:**

Rrjedha (volumi i shkarkuar):			
Vlera mesatare/ditë	Nm3/d	Maks./ditë	m3/d
Vlera maksimale/orë	Nm3/orë	Rrjedha min.	m.s-1
Faktorë të tjerë			
Temperatura	oC(max)	oC(min)	oC(vlera mes.)
Burimet e djegies:			
Vlerat e volumit të dhëna si: <input type="checkbox"/> i thatë <input type="checkbox"/> i njomë      _____%O2			

Jepni periudhën ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke përfshirë variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qënë vënia në punë dhe/ose ndërprerja e punës):

<b>Periudhat e shkarkimit (mesatare)</b>	min/orë	orë/ditë	ditë/vit
--	---------	----------	----------

**Tabela 6.1.3:** Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

Numri Referues i pikës së shkarkimit: \_\_\_\_\_

Parametri	Përpara trajtimit				Përshkrim i shkurtër	Kodi i shkarkimit					
	mg/Nm <sup>3</sup>		kg/orë			mg/Nm <sup>3</sup>		kg/orë		kg/vit	
	Mes.	Maks.	Mes.	Maks.		Mes.	Maks.	Mes.	Maks.	Mes.	Maks.

Përqendrimit duhet të bazohen në kushtet normale për temperaturën dhe presionin (0°C, 101.3 kPa). I njomë/i thatë duhet të tregohen si në rastin e tabelës 6.1.2., nëse nuk shprehet ndryshe.

**Tabela 6.1.4:** Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo burim emetimi)

Numri Referues i pikës së shkarkimit: \_\_\_\_\_

Nr. Ref. i pikës së shkarkimit	Përshkrimi	Detaje për shkarkimin <sup>1</sup>				Sistemi i aplikuar për reduktim (filtra, etj)
		Materiali	mg/Nm <sup>3(2)</sup>	kg/orë	kg/vit	

<sup>(1)</sup> Vlerat maksimale të shkarkimeve duhet të specifikohen për çdo substancë të shkarkuar. Përqendrimit duhet të specifikohen për një interval maksimal prej 30 minutash.

<sup>(2)</sup> Përqendrimit duhet të bazohen në kushtet normale për temperaturën dhe presionin (0°C, 101.3 kPa). I njomur/ i thatë duhet të përcaktohen qartë. Specifikoni kushtet referuese për oksigjenin për shkarkimet nga djegjet.

## 6.2 SHKARKIMET E MUNDSHME DHE FLURUESE

Për të gjitha burimet e mundshme dhe ato fluruese ( të shkarkimeve, duhet të plotësohet tabela 6.2.1, si dhe të sigurohet një informacion i detajuar mbi to.

Në përputhje me aktivitetet e renditura referuar kuadrit ligjor shqiptar për shkarkimet e komponimeve organike të avullueshme, tregoni nëse shkarkimet janë të përputhje me dispozitat ligjore në fuqi ose jo dhe, nëse jo, shpjegoni se si do të arrini këtë përputhshmëri. Plani i menaxhimit të tretësve organikë duhet të jetë bashkëngjitur kërkesës.

Të gjithë informacionet shtesë duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 6**.

**Tabela 6.2.1:** Shkarkimet në ajër – Shkarkimet e mundshme në ajër

Pika e shkarkimit (Nr. i Referencës) Sipas hartës që do të bashkëngjitet	Përshkrimi	Kushtet-keqfunksionimi i cili mund të shkaktojë një shkarkim	Data e shkarkimit (Maksimumi i shkarkimeve të mundshme) <sup>13</sup>		
			Materiali	mg/Nm <sup>3</sup>	kg/orë

<sup>13</sup> Llogaritni shkarkimet maksimale të mundshme për çdo gjendje të identifikuar (rrjedhë).

### 6.3 SHKARKIMET NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË

Për shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë duhet të plotësohen Tabelat 6.3.1 dhe 6.3.2.

Rendisni të gjitha pikat e shkarkimit shoqëruar me planimetritë, skicat dhe dokumentat përkatëse, bashkëngjitur këtij formulari si Aneksi 6.

Për secilën pikë shkarkimi, është e nevojshme të tregoni substancat që shkarkohen. Duhet të llogariten të gjithë llojet e shkarkimeve të lëngshme dhe llumrat në ujërat sipërfaqësorë si dhe rreshjet atmosferike që për shkak të forcës së gravitetit shkojnë drejt ujërave sipërfaqësore. Pikat shkarkimit duhet të tregohen në hartën e terrenit me koordinata të shënuara në sistemin GAUS KRUGE: 1942\_GK\_ZONE\_4. Duhet të specifikohet gjithashtu edhe identiteti dhe tipi i mjedisit ujor pritës.

**Tabela 6.3.1:** Shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë (një faqe për çdo shkarkim)

**Pika e Shkarkimit:**

Nr. i Referencës së pikës së shkarkimit (numri i referencës duhet të jetë i njëjtë me numrin e shkruar në hartën e instalimit)	
Emërtimi i pikës së shkarkimit	
Vendndodhja	
Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	
Emri/Emërtimi i mjedisit ujor pritës (lumë, liqen, etj....):	
Prurja e ujit e mjedisit ujor pritës	_____ $m^3.s^{-1}$ prurja e ujit gjatë periudhës së thatësisirës _____ $m^3.s^{-1}$ 95% prurja e ujit
Kapaciteti absorbues i ndotësit(ve):	kg/ditë

**Informacion i detajuar mbi shkarkimet:**

<b>(1) Sasia e shkarkuar</b>			
Mesatare/ditë	$m^3$	Sasia maksimale/ditë	$m^3$
Sasia maksimale/orë	$m^3$		

(1) Jepni periudhën ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke përfshirë variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qënë vënia në punë dhe/ose ndërprerja e punës):

<b>Periudhat e shkarkimit (mesatare)</b>	min/orë	orë/ditë	ditë/vit
--	---------	----------	----------



**Tabela 6.4.1:** Shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve (një faqe për çdo pikë të shkarkimeve)

**Pikat e Shkarkimit:**

Nr. Ref. i pikës së shkarkimit: (numri i referencës duhet të jetë i njëjtë me numrin e shkruar në hartën e instalimit)	
Vendndodhja e pikës së shkarkimit rrjetin e kanalizimeve	
Koordinatat (për efekt të vlerësimit të ndikimit)	X Y
Emri i kompanisë e cila menaxhon sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura	
A është sistemi i kanalizimeve i lidhur me një impiant trajtimi?	
Emri i mjedisit përfundimtar ujqor pritës të ujërave të ndotura nga rrjeti i kanalizimit (estuar, lumë ose mjedis tjetër ujqor pritës dhe ndikimi në të i cili duhet kontrolluar)	

**Informacion i detajuar mbi shkarkimet:**

<b>(1)Sasia e shkarkuar</b>			
Sasia Mesatare/ditë	m <sup>3</sup>	Sasia maksimale/ditë	m <sup>3</sup>
Sasia Mesatare/orë	m <sup>3</sup>		

(1) Jepni periudhën ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke përfshirë variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qënë vënia në punë dhe/ose ndërprerja e punës):

<b>Periudhat e shkarkimit (mesatare)</b>	min/orë	orë/ditë	ditë/vit
--	---------	----------	----------

Tabela 6.4.2: Shkarkimet në kanalizime/rrjetin e kanalizimeve – Karakteristikat e shkarkimeve (një tabelë për çdo pikë shkarkimi)

Numri Referues i pikës së shkarkimit: \_\_\_\_\_

Parametri	Përpara trajtimit				Tek vendi i shkarkimit në mjedisin ujor pritës				Efiçienca e pajisjes së trajtimit (%)
	Vlera mesatare maks. në orë (mg/l)	Vlera ditore e mesatares maks. (mg/l)	kg/ditë	kg/vit	Vlera mesatare maks. në orë (mg/l)	Vlera ditore e mesatares maks. (mg/l)	kg/ditë	kg/vit	

### 6.5 SHKARKIMET NË TOKË

Për shkarkimet në tokë duhet të plotësohen Tabelat 6.5.1 dhe 6.5.2.

Përshkruani sistemet dhe procedurat për të parandaluar ose reduktuar çlirimet e ndotësve në mjediset e ujërave nëntokësorë, si dhe procedurat për parandalimin e ndikimeve negative në mjediset e ujërave nëntokësorë.

Kërkuesi duhet të japë informacion mbi llojet e substancave (mbetje bujqësore ose jo-bujqësore) që do të shpërndahen në tokë (mbetje llumrash, hi, mbetje të lëngshme, etj.) si dhe sasinë e propozuar, periodhat dhe metodën e shpërndarjes (tub i shkarkimit, rezervuar, çisternë).

Çdo pikë shkarkimi ose zonë shkarkimi duhet të tregohet në hartën e instalimit.

Të gjitha informacionet përkatëse duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari në **Aneksin 6**.

**Tabela 6.5.1:** Shkarkimet në tokë (një tabelë për çdo pikë shkarkimi)

**Pika e shkarkimi ose zona e shkarkimit:**

Harta referuese e instalimit, Nr.	
Nr. ref. i pikës së shkarkimit ose zonës së shkarkimit	
Mënyra e çlirimit: (puset, shtresat e depërtueshme, spërkatja/lagia, përhapja, etj.)	
Vendndodhja	
Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	
Lartësia e shkarkimit/çlirimit (në lidhje me lartësinë nga mjedisi pritës )	
Klasifikimi i ujit të mjedisit ujor pritës mjedisit i ujërave nëntokësorë): (nëse është i disponueshëm)	
Vlerësimi i ndjeshmërisë së ndotjes të mjedisit të ujërave nëntokësorë (përfshirë dhe shkallën e ndjeshmërisë)	
Identiteti dhe distanca e burimeve të ujërave nëntokësore në rrezik nga ndikimet negative prej shkarkimeve (puset, burimet, etj.)	
Identiteti dhe distanca e mjediseve ujore sipërfaqësore në rrezik nga ndikimet negative prej shkarkimeve	

**Informacion i detajuar mbi shkarkimet:**

<b>(1) Sasia e shkarkuar</b>			
Mesatare/ditë	m <sup>3</sup>	Sasia Maksimale/ditë	m <sup>3</sup>
Sasia Maksimale/orë	m <sup>3</sup>		

(1) Jepni periudhën ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke përfshirë variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qënë vënia në punë dhe/ose ndërprerja e punës):

<b>Periudhat e shkarkimit (mesatare)</b>	<b>min/orë</b>	<b>orë/ditë</b>	<b>ditë/vit</b>
--	----------------	-----------------	-----------------



## 6.6 SHKARKIMET E ZHURMËS

Jepni informacion të detajuar mbi burimet (vendndodhjen, natyrën, nivelin, periudhën ose periudhat e shkarkimit) e zhurmës që është gjeneruar ose do të gjenerohet.

Tabela 6.6.1 duhet të përmbajë informacion për secilin burim shkarkimi. Çdo burim shkarkimi i zhurmës duhet të shënohet qartë në hartën e instalimit.

Dokumentacioni mbështetës duhet të përfshihet në **Aneksin 6**.

**TABELA 6.6.1:** Shkarkimet e zhurmës – Përmbledhje e listës së burimeve të shkarkimit të zhurmës

Burimi i shkarkimit	Nr. Ref. i pikës së shkarkimit	Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	Nr. Ref. i pajisjes që gjeneron ndotje aklustike	Presioni akustik <sup>1</sup> (dBA) duke ju referuar distancës	Periudha e shkarkimit

<sup>1</sup> Për segmente të ndryshme të instalimeve, mund të përdoren nivele të ndryshme të intesitetit të zhurmës.

## 6.7 VIBRACIONET

Duhet të përgatitet një informacion i detajuar për vibracionet, dhe nëse është e mundur, të paraqiten edhe informacionet që i përkasin vitit të kaluar.

Specifikoni dhe shënoni në hartë vendndodhjen e burimeve të vibracionit që mund të ndikojnë në mjedis, përtej ambienteve të instalimit dhe siguroni rezultatet e matjeve ose llogaritjeve.

Burimet e vibracionit duhet të përfshijnë edhe transportin që bëhet brenda instalimit. Për instalimet e reja, duhet të merren në konsideratë të gjitha burimet e vibracionit gjatë ndërtimit dhe operimit të instalimit. Të gjitha burimet duhet të përshkruhen në shtojcat grafike.

Të gjithë dokumentat shtesë që kanë lidhje me sa u përmend më sipër, duhet të përfshihen në **Aneksin 6**.

## 6.8 REZATIMI JO-JONIZUES

Identifikoni burimet e rrezatimit jo-jonizues që kanë ndikim në mjedisin përtej ambienteve të instalimit dhe tregoni rezultatet e matjeve ose llogaritjeve të kryera për këtë qëllim. Burimet e rrezatimit duhet të tregohen qartë në hartën e instalimit.

## 6.9 PËRSHKRUAJ GJENDJEN E VENDNDODHJES

Jepni të dhëna për gjendjen e mjedisit (ajrin, ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, tokën, zhurmat, hidrologjinë, stabilitetin, speciet e mbrojtura etj.) që kanë lidhje me ndërtimin dhe vënien në punë të instalimit.

Bëni të njohur vlerësimin e ndikimit të gjithë shkarkimeve në mjedis, përfshirë edhe vendet/mjediset ku shkarkimet nuk janë çliruar ende.

Përkrahja, ku është e nevojshme, masat për minimizimin e ndotjes në distanca të gjata dhe/ose në territorin e shteteve të tjera.

Të gjithë informacionet përkatëse duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 6**.

### **Vlerësimi i Ndikimit të Shkarkimeve në Ajër**

Përkrahja gjendjen aktuale të cilësisë së ajrit duke i kushtuar vëmendje të veçantë standardeve për cilësinë e ajrit.

Tregoni nëse shkarkimet në ajër mund të shkaktojnë dëme apo ndikojnë negativisht në mjedis, pavarësisht se mund të jenë brenda vlerave kufi të siguruara nga aplikimi i teknikave më të mira të disponueshme (TMD). Nëse vërehet erë e pakëndshme jashtë ambienteve të instalimit, duhet të bëhet një vlerësim i erës së pakëndshme, duke patur parasysh shpeshësinë/frekuencën dhe vendndodhjen e shfaqjes së saj.

Jepni informacion të detajuar mbi vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve ekzistuese apo të parashikuara në mjedis, duke përfshirë edhe vendin/mjedisin në të cilin nuk janë çliruar ende shkarkimet.

Përfshini në **Aneksin 6** modelet e shpërndarjes së shkarkimeve në ajër, të krijuara nga proceset e ndryshme në instalim. Të gjitha modelet dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me sa më sipër, duhet të përfshihen në **Aneksin 6**.

## 6.10. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË

Për të kryer vlerësimin e ndikimit në ujërat sipërfaqësorë, duhet respektuar kuadri ligjor në fuqi, për:

- Substancat e rrezikshme dhe të dëmshme të shkarkuara në ujë, si dhe klasifikimi kombëtar i mjedisve ujore dhe ujërave bregdetare;
- Kushtet për shkarkimin e ujërave të ndotura në kanalizimet publike;
- Kushtet për shkarkimin e ujërave të ndotura në ujërat sipërfaqësorë;
- Klasifikimi i ujërave dhe rrjedhave ujore.

Për këtë vlerësim duhet të plotësohet Tabela 6.10.1.

Tregoni nëse shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë, mund të shkaktojnë dëme apo ndikojnë negativisht në mjedis, pavarësisht se mund të jenë brenda vlerave kufi të siguruara nga aplikimi i teknikave më të mira të disponueshme (TMD).

Jepni informacion të detajuar për vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve ekzistuese apo të parashikuara në mjedis, duke përfshirë edhe vendin/mjedisin në të cilin nuk janë çliruar ende shkarkimet.

Përfshini në **Aneksin 6**, informacionin e detajuar për vlerësimin si dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me sa më sipër.

**Tabela 6.10.1:** Cilësia e ujërave sipërfaqësorë

Vendndodhja e monitorimit/ Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942\_GK\_ZONE\_4: \_\_\_\_\_

Parametri <sup>1</sup>	Rezultatet (mg/l)				Metoda e marrjes së mostrës (automatike, rrymë e vetme, përbërja e rrymës, etj.)	Qëllimi i vlerësimit analitik	Metoda analitike/ teknika
	Data	Data	Data	Data			

<sup>1</sup> Renditni të gjithë parametrat e detyrueshëm dhe parametrat specifik të instalimit/impianitit. Nëse është e nevojshme, shtoni rreshta të tjerë.

### 6.11. VLERËSIMI I NDIKIMIT TË SHKARKIMEVE NË RRJETIN E KANALIZIMEVE

Jepni informacion të detajuar për vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve ekzistuese apo të parashikuara në mjedis, duke përfshirë edhe vendin/mjedisin në të cilin nuk janë çliruar ende shkarkimet.

Përfshini në **Aneksin 6**, informacionin e detajuar për vlerësimin si dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me sa më sipër.

### 6.12. VLERËSIMI I NDIKIMIT TË SHKARKIMEVE NË UJËRAT NËNTOKËSORË

Përshkruani gjendjen aktuale të cilësisë së ujërave nëntokësorë, në përputhje me klasifikimin e mjediseve ujore (rrjedhave ujore, etj.) dhe ujërave bregdetare në Shqipëri.

Për këtë duhet plotësoni Tabelën 6.12.1.

Jepni informacion të detajuar për vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve ekzistuese apo të parashikuara në mjedis, duke përfshirë edhe vendin/mjedisin në të cilin nuk janë çliruar ende shkarkimet. Informacioni duhet të përfshijë edhe përhapjen në sipërfaqe, injektimin në tokë, etj.

Përfshini në **Aneksin 6**, një informacion të detajuar mbi vlerësimin, duke përfshirë raportin hidrologjik, të dhënat mbi cilësinë e ujit, klasifikimet e shtresës së depërtueshme, ndjeshmërinë, identifikimin dhe zonimin e burimeve dhe rrjedhave ujore.

Kur shkarkimet janë çliruar direkt në/ose brenda tokës, duhet të ndërmerret një testim i cilësisë së tokës. Është e nevojshme të identifikohen të gjithë mjediset e ndjeshme ujore (si rezultat i shkarkimeve të sipërfaqes).

**Tabela 6.12.1:** Cilësia e ujërave nëntokësorë

Vendndodhja e monitorimit/ Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942\_GK\_ZONE\_4: \_\_\_\_\_

Parametri <sup>1</sup>	Rezultatet (mg/l)				Metoda e marrjes së mostrës (hyrje, depozitë, etj.)	Qëllimi vlerësimit analitik	Metoda/teknika analitike
	Data	Data	Data	Data			

<sup>1</sup> Renditni të gjithë parametrat e detyrueshëm dhe parametrat specifikë të instalimit.  
Nëse është e nevojshme, shtoni rreshta të tjerë.

**Cilësia e Ujërave nëntokësorë (Lista 2 e 2)**

Parametri <sup>1</sup>	Rezultatet (mg/l)				Metoda e marrjes së mostrës (hyrje, depozitë, etj.)	Qëllimi i vlerësimit analitik	Metoda/teknika analitike
	Data	Data	Data	Data			
Niveli i ujit (mbi nivelin e detit)							

<sup>1</sup> Renditni të gjithë parametrat e detyrueshëm dhe parametrat specifikë të instalimit/implantit.  
Nëse është e nevojshme, shtoni rreshta të tjerë.

### 6.13. NDOTJA E TOKËS/UJËRAVE NËNTOKËSORË

Jepni një informacion të detajuar mbi ndotjen e njohur aktuale ose të mëparshme të tokës dhe ujërave nëntokësore, në/ose afër vendit të instalimit.

Përfshini në **Aneksin 6**, të gjithë detajet, përfshirë studime kërkimore, vlerësime, raporte, rezultate monitorimi, dhe metodat për parandalimin e ndotjes, rehabilitimin, etj.

Jepni informacion për vlerësimin e ndikimit të rikuperimit dhe të asgjësimit të mbetjeve në instalim.

Përshkruani masat e synuara në parandalimin e gjenerimit dhe rikuperimit të mbetjeve. Jepni një vlerësim të detajuar të ndikimit në mjedis të venddepozitimit/vendasgjesimit aktual apo të propozuar të mbetjeve, brenda territorit të instalimit, duke përfshirë edhe mjedisin në të cilin shkarkimet nuk janë çliruar ende.

Ky informacion duhet të përfshihet në **Aneksin 6**.

### 6.14. NDIKIMI I ZHURMËS

Për të vlerësuar ndikimin e zhurmës, duhet të kryeni matjen e nivelit të zhurmës në mjedis. Paraqisni të dhënat e marra në Tabelën 6.14.1 sipas informacionit të renditur me poshtë:

- Specifikoni nivelin maksimal të zhurmës që mund të haset në pikat karakteristike brenda ambienteve të instalimit (specifiko intervalin e kohëzgjatjes së matjes);
- Specifikoni nivelin maksimal të zhurmës që mund të haset në pikat karakteristike të ndjeshme, jashtë ambienteve të instalimit;
- Siguroni informacion të detajuar për nivelin ekzistues të zhurmës, kur instalimi nuk është në gjendje pune, përkatësisht në mungesë të zhurmës nga operimi i instalimit.

**Aneksi 6** duhet të përfshijë modelin e përhapjes së tingullit dhe masat për kontrollin dhe shuarjen e zhurmës.

Tabela 6.14.1 Vlerësimi i zhurmës në mjedisit

	Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4) (7 Veri, 6 Lindje)	Niveli i zhurmës /dB(A)		
		L(A) <sub>eq</sub>	L(A) <sub>10</sub>	L(A) <sub>90</sub>
Ambientet e instalimit				
Vendndodhja 1:				
Vendndodhja 2:				
Vendndodhja 3:				
Vendndodhja 4:				
Vendndodhjet e ndjeshme të zhurmës				
Vendndodhja 1:				
Vendndodhja 2:				
Vendndodhja 3:				
Vendndodhja 4:				

Shënim: Të gjitha vendndodhjet duhet të shënohen qartë në hartat bashkëngjitur kësaj kërkesë

## 7. REDUKTIMI I SHKARKIMIT DHE SISTEMET E KONTROLLIT

Përshkruani masat ekzistuese/të propozuara, teknologjinë dhe teknika të tjera për të parandaluar shkarkimet, ose nëse nuk është e praktikueshme, për të reduktuar shkarkimet nga impianti/veprimtaritë.

Përfshini informacion mbi sistemet e reduktimit dhe kontrollit të shkarkimeve (shkarkimet në ajër-dhe ujë së bashku me projektet korresponduese sipas Sipas Aneksit 2 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisi për kërkuesit.

Për secilën pikë shkarkimi të identifikuar, plotësoni Tabelën 7.1.1 dhe jepni projektin për sistemin e reduktimit të shkarkimit.

Informacioni duhet paraqitur në **Aneksin 7**.

**Tabela 7.1.1:** Reduktimi/trajtimi, kontrolli i shkarkimit

Numri referues i pikës së shkarkimit:

Parametri i kontrolluar <sup>1</sup>	Pajisja <sup>2</sup>	Mirëmbajtja e pajisjes	Kalibrimi i pajisjes	Mbështetja e pajisjes

<sup>1</sup> Specifikoni parametrat funksionalë të sistemeve të reduktimit/kontrollit të shkarkimeve.

<sup>2</sup> Specifikoni pajisjet e nevojshme për funksionimin e sistemeve të reduktimit/kontrollit të shkarkimeve. Specifikoni monitorimin e parametrave të kontrolluar që duhet të kryhen.

Parametri i Monitoruar	Monitorimi që duhet kryer	Pajisja e monitorimit	Kalibrimi i pajisjes së monitorimit

## 8. MONITORIMI

### 8.1. MONITORIMI DHE MARRJA E MOSTRAVE

Jepni informacion për vendodhjet e monitorimit dhe marrjes së mostrave dhe përshkruani propozimin tuaj për monitorimin e shkarkimeve. Për çdo pikë për monitorimin e shkarkimeve në ajër, ujërat sipërfaqësorë, kanalizime, për monitorim në tokë dhe mbetjet, duhet të plotësoni Tabelën 8.1.1.

### 8.2. MONITORIMI I CILËSISË SË MJEDISIT

Për monitorimin e cilësisë së mjedisit, plotësoni Tabelën 8.2.1 për secilin vend dhe pikë individuale monitorimi.

Përfshini në informacion të dhëna mbi vendndodhjen, metodat e monitorimit, marrjene mostrave si dhe shpeshtësinë/frekuencen.

Përfshini në **Aneksin 8** informacionin përkatës, i lidhur me sa u përmend më sipër.

**Tabela 8.1.1:** Vendodhjet e monitorimit të shkarkimit dhe të marrjes së mostrave (një tabelë për secilin vendndodhje monitorimi)

Numri referues i pikës së shkarkimit: \_\_\_\_\_

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Aksesi në vendodhjet e matjeve	Metoda e marrjes së mostrave	Metoda/teknika e analizës

**Tabela 8.1.2** Vendodhja e matjeve dhe monitorimit të mjedisit (një tabelë për secilën vendndodhje monitorimi)

Numri referues i pikës së shkarkimit: \_\_\_\_\_

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Aksesi në vendodhjet e matjeve	Metoda e marrjes së mostrave	Metoda/teknika e analizës

## 9. ASPEKTET MJEDISORE DHE TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME

Përshkruani shkurtimisht alternativat kryesore që keni propozuar në kërkesën tuaj, nëse keni të tilla. Përshkruani aspektet e mjedisit, që keni marrë në konsideratë, përsa i përket teknologjive të pastra, reduktimit të mbetjeve dhe zëvendësimit të lëndëve të para.

Përshkruaj masat ekzistuese ose të propozuara/planifikuara, të synuara për të siguruar:

1. Zbatimin e teknikave më të mira të disponueshme për parandalimin, ose kur nuk është e praktikueshme, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi;
2. Eliminimin e ndotjeve domethënëse;
3. Parandalimin e gjenerimit të mbetjeve, në përputhje me ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve, në rastet kur gjenerohen mbetje, ato përdoren, ose kur nuk është teknikisht ose ekonomikisht e mundshme, mbetjet duhet të asgjësohen për të evituar ose reduktuar ndikimin e tyre në mjedis;
4. Përdorimin efiçient të energjisë;
5. Marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe minimizuar ndikimet e tyre (siç përshkruhet në detaje tek Kapitulli 11);
6. Marrjen e të gjitha masave për të eliminuar rreziqet e ndotjes dhe krijimin e kushteve të favorshme në instalim, pas ndërprerjes së funksionimit të tij (siç përshkruhet në kapitullin 12).

Përfshini në **Aneksin 9** të gjithë informacionet e mbetura, që kanë lidhje me sa më sipër.

## 10. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT

Operatorët që dorëzojnë një kërkesë për Leje Mjedisi duhet të bashkëngjisin edhe një propozim - program për përmirësimin e funksionimit të instalimit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Jepni një tabelë ku rendisni të gjitha masat me afatet dhe vlerësimet financiare përkatëse për zbatimin e programit/planit në bazë vjetore. Propozoni një metodë të raportimit të rezultateve nga zbatimi i masave/planit/programit.

Jepni vlerësimin e efektit të secilës masë për pakësimin e shkarkimeve, efiçencën e energjisë dhe përdorimin e lëndëve të para, ujit dhe energjisë.

## **11.PËRSHKRIMI I MASAVE TË TJERA PARANDALUESE TË PLANIFIKUARA**

### **11.1 PARANDALIMI I AKSIDENTEVE DHE REAGIMET GJATË EMERGJENCAVE**

Bëni një listë të situatave të mundshme, të cilat mund të kenë një ndikim në mjedis.

Përshkruani masat ekzistuese ose të planifikuara, duke përfshirë procedurat e emergjencës që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis të shkarkimeve, në rast të aksidenteve apo rrjedhjeve.

Tregoni se cilat janë masat e reagimit emergjent, të marra jashtë orarit normal të punës (gjatë natës, fundjavës, pushimeve).

Përshkruani procedurat e ndërmarra në raste të jashtëzakonshme (fillimin e aktivitetit, rrjedhje, keq-operimet, ndërprerjet afat-shkurtra të operimit, etj).

Vendosni afatet për marrjen e veprimeve dhe masave përkatëse; jepni informacion mbi personat përgjegjës, në përputhje me Rregulloren për përmbajtjen e raporteve mbi sigurinë, natyrën e informacionit rreth masave të sigurisë dhe përmbajtjen e planeve të ndërhyrjeve të brendshme dhe të jashtme.

Përfshini në **Aneksin 11**, të gjithë informacionet përkatëse që kanë lidhje me sa më sipër.

## **12.REHABILITIMI, NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË, RIFILLIMI DHE KONTROLI PAS NXJERRJES NGA PËRDORIMI**

Përshkruani masat ekzistuese ose të propozuara që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis pas ndërprerjes së aktiviteteve në të gjithë instalimin apo në pjesë të ndryshme të tij, duke përfshirë masat për menaxhimin e mbetjeve të mundshme ndotëse, pas mbylljes së instalimit.

Përfshini në **Aneksin 12**, të gjithë informacionet përkatëse që kanë lidhje me sa më sipër.

## **13.PLANI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE**

Përshkruani planet ekzistuese ose të propozuara për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë tentativën e trajtimit/menaxhimit në mjediset e instalimit.

Përfshini në **Aneksin 13**, të gjithë informacionet përkatëse që kanë lidhje me sa më sipër.

## 14.PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Paraqisni një përmbledhje të kërkesave për leje mjedisi, pa specifikuar detajet teknike.

Përmbledhja duhet të identifikojë të gjitha efektet mjedisore të njohura, të cilat kanë lidhje me kryerjen e aktiviteteve në instalim, dhe përshkruani masat ekzistuese ose të propozuara që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis.

Ky përshkrim duhet të përmbajë oraret dhe ditët normale të punës për kryerjen e operacioneve gjatë një jave.

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

Përshkrimi:

- Instalimi dhe aktivitetet e tij;
- Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi;
- Burimet e shkarkimeve nga instalimi;
- Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes;
- Natyra dhe sasia e shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis;
- Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme;
- Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur;
- Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme);
- Masat për përdorimin eficient të energjisë;
- Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:
  - a) janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;
  - b) janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme
- Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Informacioni i mësipërm duhet të përfshihet në **Aneksin 14**.

## 15.DEKLARATË

# DEKLARATË

Duke nënshkruar këtë deklaratë, në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për Mbrojtjen e Mjedisit", ligjit "Per lejet e mjedisit" dhe akteve nënligjore përkatëse unë paraqes kërkesën për leje mjedisi/ rishikimin e lejes së mjedisit.

Konfirmoj që informacioni i dhënë në këtë kërkesë është i vërtetë, i saktë dhe i plotë.

Unë nuk kam vërejtje lidhur me bërjen publike të kësaj Kërkesë , për aq sa nuk bie ndesh me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e të dhënave tregtare.

**Emri i nënshkruesit:** \_\_\_\_\_

**Pozicioni brenda Kompanisë:** \_\_\_\_\_

**Firma:** \_\_\_\_\_ **Data :** \_\_\_\_\_

Vula e  
Kompanisë/Operatorit

SHTOJCA 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_\_\_

## KËRKESË PËR LEJE MJEDISI Tipi C

AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT

Numri i Identifikimit të Kërkesës .....

Emri i Kërkesësit:

a) Person juridik (Kompania) ( Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa,)

\_\_\_\_\_

ose

b) Personi Fizik ( emri, mbiemri, Nr NIPT, adresa.....)

Për impiantën/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kolonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar)\_\_\_\_\_
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kolonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar)\_\_\_\_\_
3. Vendndodhja\_\_\_\_\_

(Qark) .....

(Bashki)

(Komunë)

Emri, titulli i personit të autorizuar .....

( Firma, Vula)

Data.....

Tarifa e paguar në datë .....

- për kërkesë për leje mjedisi  
 ndryshim të kushteve të lejes

## 1. INFORMACION MBI KËRKUESIN/OPERATORIN

### 1.1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Emri i Kompanisë	
Statusi Ligjor	
Ortakët/Aksionerët e Kompanisë(sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKR)	
Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë	
Adresa postale e Kompanisë, nqse ndryshon nga adresa e mësipërme	
Numri i regjistrimit të Kompanisë(NIPT)	
Kodi kryesor i aktivitetit (sipas kolonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit nr 10448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit")	
Numri i Punonjësve	
Përfaqësuesi i autorizuar	
Emri dhe Mbiemri	
Pozicioni në Kompani	
Telefoni	
Faksi	
E-mail	

### 1.2. INFORMACION MBI INSTALIMIN/IMPIANTIN

Emri i instalimit/impianit <sup>1</sup>	
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti	
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	
Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi <sup>2</sup>	
Kapaciteti i projektuar	

<sup>1</sup> Përshkruaj titullin sipas kolumnës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

<sup>2</sup> Shkruani kodet e specifikuara në kolumnën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuara në kolumnën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

### 1.3. INFORMACION MBI PERSONIN E KONTAKTIT TË AUTORIZUAR NGA ADMINISTRATORI NË LIDHJE ME LEJEN

Emri dhe Mbiemri	
Adresa	
Pozicioni në kompani	
Telefoni	
Faksi	
E-mail	

### 1.4. PRONËSIA E TOKËS

Emri/adresa e pronarit/pronarëve të tokës, numri i identifikimit të pronës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP<sup>3</sup> ku janë ndërmarrë (nëqoftëse ndryshojnë nga ato të kërkuesit) apo do të ndërmerren aktivitetet (nëqoftëse ndryshojnë nga ato të kërkuesit).

Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve	
Të dhëna për pronësinë e tokës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP <sup>1</sup>	
Adresa	
Informacion për kontratën e qerasë nëse ka Nr. i kontratës së qerasë nëse kërkuesi nuk është pronar i tokës deri në këtë moment	

<sup>3</sup> Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

### 1.5. PRONËSIA E IMPIANTIT

Emri dhe adresa e pronarit të impiantit ku kryhet aktiviteti, si dhe informacion mbi kontratën e qerasë nëqoftëse kërkuesi nuk është pronari i impiantit.

Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve	
Adresa	
Informacion mbi kontratën (qeradhënësi dhe qeramarrësi, afati i kontratës, mënyrat e përfundimit të kontratës; periudha e vlefshmërisë) Bashkëngjisni një kopje të kontratës së qerasë	

### 1.6. KËRKESA ËSHTË BËRË PËR:<sup>4</sup>

Shënoni ✓ në kutinë përkatëse

- Impiante dhe instalime të reja
- Impiante dhe instalime ekzistuese
- Ndryshim i konsiderueshëm në impiantet dhe/ose instalimet ekzistuese

Shto në dokumentat e kërkesës një ekstrakt nga dokumentet e planifikimit që kanë të bëjnë me zonën në fjalë.

### 1.7. INFORMACION NË LIDHJE ME NDRYSHIME TE KONSIDERUESHME TE PROPOZUARA TE LEJES SË TIPIT C PER NJE INSTALIM/IMPIANT EKZISTUES

Operatori/kërkuesi plotëson tabelën e mëposhtme vetëm kur kërkon ndryshime të kushteve të lejes së mjedisit të Tipit C, për një instalim/impiant ekzistues.

Emri i impiantit (sipas lejes ekzistuese të mjedisit)	
Data e dorëzimit të kërkesës për ndryshime të lejes së lëshuar të mjedisit të Tipit C	
Data e lëshimit të lejes ekzistuese të mjedisit, të Tipit C (refero <b>Nr. e identifikimit të Lejes sipas Regjistrit të lejeve</b> )	
Vendodhja e impiantit dhe e instalimit (qarku, bashkia/komuna, numri kadastral)	
Arsyeja/et për ndryshimin e kërkuar në lejen e mjedisit	

Jepni përshkrimin e ndryshimeve të propozuara

<sup>4</sup> Kjo kërkesë nuk i referohet transferimit të lejes në rast të ndryshimit të pronësisë

## 2. PËRSHKRIMI I INSTALIMIT/IMPIANTIT

Përshkruani instalimin, metodat, proceset, produktet dhe operacionet e instalimit nëse është e nevojshme siguroni kopje të planeve, skicave ose hartave dhe detaje të tjera të nevojshme për të përshkruar të gjithë aspektet e aktivitetëve.

.....

.....

.....

### LËNDËT E PARA

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A përdorni lëndë të para?			
A përdorni materiale ndihmëse?			
A përdorni përzjerje materialesh ?			
A përdorni lëndë djegëse (dhe/ose energji)?			
A përdorni kimikate laboratorike?			
Lutemi rendisni materialet	1, 2, 3, etj.		

### SHKARKIMET NË AJËR

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A ka shkarkime në ajër (nga oxhaqet)			
A ka shkarkime në ajër (nga burime të shpërndara)?			
Shkarkimet a janë toksike?			
A ka erëra të pakëndshme nga shkarkimet?			

**SHKARKIME TË UJËRAVE TË NDOTURA**

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A ka shkarkime të ujërave të ndotura?			
A kryhet trajtimi i ujërave të ndotura?			
A ka ujëra të ndotura toksike?			
A bëhen shkarkime në rrjetin e kanalizimeve?			
A bëhen shkarkime në sipërfaqet ujore?			
Jepni sasinë e ujërave të ndotura (m3/ditë)			

**MBETJET E NGURTA**

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A gjenerohen mbetje të ngurta?			
A gjenerohen mbetje të ngurta të rrezikshme?			
Të asgjësuar në territorin e impiantit/instalimit?			
Përshkruani mënyrën e asgjësimit			

**PËRDORIMI/ PRODHIMI I ENERGJISË**

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A përdoret energji?			
A prodhohet kjo energji në territorin e impiantit?			
A keni informacion tjetër?			

**ZHURMA & VIBRACIONET**

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A gjenerohen zhurma?			
A gjenerohen vibracione?			
A gjenerohen zhurma në sfond?			

### 3. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË OPERIMIT – (NQSE KA)

Paraqisni programin/planin për përmirësimin e funksionimit të instalimit dhe për mbrojtjen e mjedisit:

.....

.....

### 4. DEKLARATË

## DEKLARATË

Duke nënshkruar këtë deklaratë, në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ligjit “Per lejet e mjedisit” dhe akteve nënligjore përkatëse unë paraqes kërkesën për leje mjedisi/ rishikimin e lejes së mjedisit.

Konfirmoj që informacioni i dhënë në këtë kërkesë është i vërtetë, i saktë dhe i plotë.

Unë nuk kam vërejtje lidhur me bërjen publike të kësaj Kërkese , për aq sa nuk bie ndesh me parashikimet e legjisilacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e të dhënave tregtare.

Emri i nënshkruesit: \_\_\_\_\_

Pozicioni brenda Kompanisë: \_\_\_\_\_

Firma: \_\_\_\_\_ Data : \_\_\_\_\_



SHTOJCA 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

MIRATOHET

MINISTRI  
LEFTER KOKA

Nr. \_\_\_Prot.

Nr. i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrimit të AKM)

(firma, vula)

Datë \_\_\_\_\_

**AKT MIRATIMI**  
**Leje Mjedisi Tipi A**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisi, AKM propozon dhënien e lejes me kushtet bashkëngjitur për Kërkuesin si më poshtë;

a) Person juridik (Kompania) ( Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa)

\_\_\_\_\_

ose

b) Personi Fizik ( emri, mbiemri, Nr NIPT.....)

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" \_\_\_\_\_
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" \_\_\_\_\_
3. Vendndodhja \_\_\_\_\_

Vlefshmëria e kësaj Leje dhe kushteve të saj fillon në datë \_\_\_\_\_

Tarifa e paguar në datë .....

për kërkesë për leje mjedisi

ndryshim të kushteve të lejes

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

(emri, mbiemri, firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

REFUZOHET

MINISTRI  
LEFTER KOKA

Nr. \_\_\_ Prot.  
Nr. i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrit të AKM)

(firma, vula)  
Datë \_\_\_\_\_

**AKT REFUZIMI**  
**Leje Mjedisi Tipi A**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisi, AKM jep mendimin për refuzimin e lejes me argumentimet bashkëngjitur për Kërkuesin si më poshtë;

a) Person juridik (Kompania) ( Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa,)

ose

b) Personi Fizik ( emri, mbiemri, Nr NIPT.....)

Për impiantin/instalimin:

4. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" \_\_\_\_\_

5. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" \_\_\_\_\_

6. Vendndodhja \_\_\_\_\_

Tarifa e paguar në datë .....

- për kërkesë për leje mjedisi  
 ndryshim të kushteve të lejes

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**  
(emri, mbiemri, firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

AKM

## Përmbajtja

Kushti	1	Objekti
Kushti	2	Menaxhimi i Instalimit
Kushti	3	Funksionimi dhe Infrastruktura
Kushti	4	Plani i përputhshmërisë
Kushti	5	Interpretimi
Kushti	6	Njoftimet
Kushti	7	Shkarkimi
Kushti	8	Menaxhimi i Mbetjeve
Kushti	9	Zhurma
Kushti	10	Lëndët e para dhe përdorimi i energjisë
Kushti	11	Monitorimi
Kushti	12	Dokumentimi dhe raportimi tek autoriteti kompetent
Kushti	13	Aksidentet dhe veprimet gjatë emergjencave
Kushti	14	Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve

## Akronime dhe Shkurtime

DPP	Drejtoria e Punëve Publike
KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
KEM	Katalogu Evropian i Mbetjeve
MM	Ministria e Mjedisit
N <sub>eq</sub>	Niveli Ekuivalent i Tingullit
ISO	Organizata ndërkombëtare për standardizimin
PKIN	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes
POA	Përbërës Organikë të Avullueshëm
TMD	Teknikat më të Mira të Disponueshme
RESHTN	Regjistri Evropian i Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve
RSHTN	Regjistri Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve
RSHN	Regjistri i Shkarkimit të Ndotjes
RVM	Raporti Vjetor i Mjedisit
SMM	Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit
VKSH	Vlerë Kufi e Shkarkimit

## KUSHTI 1 – OBJEKTI

- 1.1. Kjo Leje, dhe kushtet e përcaktuara në të, jepet për veprimtaritë dhe kapacitetet e përcaktuara në kapitullin 2-4 të kërkesës për këtë Leje, ose e modifikuar sipas kushteve të kësaj Leje. Operatori është i autorizuar të zhvillojë veprimtaritë dhe/ose veprimtaritë shoqëruese siç specifikohen në Tabelën 1.1.1 dhe 1.1.2.

TABELA 1.1.1 – Lista e Veprimtarive		
Veprimtaria sipas Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 17.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit"	Përshkrim i veprimtarisë së specifikuar	Kapaciteti kufi i veprimtarisë së specifikuar

TABELA 1.1.2 – Lista e Veprimtarive Shoqëruese	
Veprimtaritë shoqëruese kryesore	Përshkrim i veprimtarisë së specifikuar

- 1.2. Operimi, kontrolli, mirëmbajtja e instalimit dhe shkarkimet nga instalimi duhet të kryhen vetëm në përputhje me kushtet e kësaj Leje. Të gjitha programet, planet dhe dokumentet e tjera që do të gjenerohen si rezultat i kësaj Leje do të jenë pjesë përbërëse e saj.
- 1.3. Ndryshimet në lidhje me funksionimin dhe ndryshimet e konsiderueshme në lidhje me instalimin, që mund të çojnë në një ndryshim në natyrën e shkarkimeve ose rritje të tyre, në sistemin e pakësimit të shkarkimeve, në lëndën djegëse, lëndët e para dhe materialet ndihmëse, produktet ose gjenerimin e mbetjeve, në menaxhimin e instalimit dhe kontrollin, mund të kryhen vetëm pas një kërkesë paraprake me shkrim dhe miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.
- 1.4. Kjo Leje jepet me qëllim parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes në përputhje me Ligjin Nr. 10431, datë 09.09.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" dhe legjislacionin mjedisor në fuqi dhe nuk e përjashton mbajtësin e kësaj Leje nga detyrimet që rrjedhin nga ligjet e tjera në fuqi.
- 1.5. Instalimi për të cilin është dhënë kjo Leje nuk duhet të vihet në punë derisa të jenë marrë masat e mëposhtme dhe AKM si autoritet kompetent të jetë njoftuar me shkrim për këtë.
- 1.5.1. Nëse është e nevojshme, shtoni kushte tjera ose theksoni: nuk kërkohet ASNJË masë para-operacionale shtesë.

- 1.6. Në këtë Leje, vendndodhje nënkupton zonën e përcaktuar nga vija e kuqe (me ngjyrë të errët) në hartën e mëposhtme (me koordinatat e përzgjedhura - gjatësia dhe gjerësia - Koordinatat e vendit sipas Sistemit të Koordinatave GAUS KRUGE: 1942\_GK\_ZONE\_4. Veprimtaritë e autorizuara sipas kushtit 1.1 nuk duhet të shtrihen përtej vendndodhjes, që është zona e përcaktuar në hartën e mëposhtme.

## **Harta**

**Koordinatat e vendit sipas Sistemit të  
Koordinatave GAUS KRUGE:  
1942\_GK\_ZONE\_4**

## **KUSHTI 2 – MENAXHIMI I INSTALIMIT**

- 2.1.** Të gjitha impiantet, pajisjet dhe mjetet teknike të përdorura për operimin e instalimit për të cilin është dhënë kjo Leje duhet të mbahen në kushte të mira funksionimi.
- 2.2.** Operatori i pajisur me Leje duhet do të punësojë në vendndodhje si person përgjegjës për instalimin, në përputhje me natyrën e punës, një menaxher me arsimin dhe eksperiencën e duhur. Menaxheri ose një person i caktuar prej tij si person përgjegjës, që të ketë gjithashtu arsimin dhe eksperiencën e duhur, duhet të jenë te pranishëm në vendndodhje vazhdimisht gjatë orarit të operimit të instalimit. Menaxheri/Personi përgjegjës duhet të jenë te disponueshëm për t'u takuar me personat e autorizuar të autoritetit kompetent në çdo kohë.
- 2.3.** Operatori duhet të sigurojë që të gjithë punonjësit, të kontraktuarit apo persona të tjerë që kryejnë detyra specifike të jenë të kualifikuar si duhet, të trajnuar dhe të njohur si duhet me kushtet e kësaj Leje.
- 2.4.** Operatori duhet të krijojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të mjedisit (SMM), i cili përmbush kushtet e kësaj Leje. SMM duhet të përmbajë një vlerësim të të gjitha fazave të veprimtarive në instalim dhe një shqyrtim të të gjitha varianteve për teknologji dhe prodhim më të pastër, zvogëlimin dhe minimizimin e mbetjeve, dhe që përfshin nivelet minimale të përputhshmërisë.
- 2.5.** Lista e objektivave mjedisore afatshkurtra dhe afatgjata (objektivat dhe detyrat).
  - 2.5.1.** Operatori duhet të përgatisë një listë të objektivave afatshkurtra dhe afatgjata për një periudhë minimale prej 5 vjetësh. Lista duhet të përmbajë gjithashtu dhe afatet kohore për përmbushjen e objektivave të përcaktuara. Lista duhet të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat e autoritetit kompetent dhe të paraqitet brenda 6 muajve nga dhënia e kësaj Leje. Lista duhet të rishikohet një herë në vit dhe shtesat duhet t'i dërgohen autoritetit kompetent për miratim si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit (Kushti 2.11.2).
- 2.6.** Programi i Menaxhimit të Mjedisit (PMM)
  - 2.6.1.** Brenda 6 muajve nga data e dhënies së kësaj Leje, operatori duhet të hartojë dhe më tej të mirëmbajë PMM, përfshirë afatet kohore për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e synimeve. PMM duhet të jetë pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit dhe autoriteti kompetent duhet ta miratojë atë përpara zbatimit.

PMM duhet të përfshijë :

    - a) Përcaktimin e përgjegjësisë për objektivat (detyrat) afatshkurtër;
    - b) Burimet me anë të të cilave mund të zbatohen detyrat;
    - c) Afatin kohor në të cilin mund të përfundohen detyrat;
    - d) Raportimin mbi programin.

2.6.2. Operatori, duhet të përfshijë brenda Raportit Vjetor të Mjedisit, një raport mbi përmbushjen e objektivave dhe detyrave të rëna dakord. Ky raport duhet të ruhet për të paktën pesë vjet dhe duhet të vihet në dispozicion të personave të autorizuar nga autoriteti kompetent për inspektimin.

## **2.7. Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve (RrShTN)**

2.7.1. Për substancat që duhet të përfshihen në RrShTN duhet rënë dakord me autoritetin kompetent.

2.7.2. Jo më vonë se (\_\_\_\_) muaj nga data e dhënies së kësaj Leje, operatori bie dakord me autoritetin kompetent mbi substancat që duhet të përfshihen në RrShTN si dhe metodologjinë për përcaktimin e këtyre substancave.

## **2.8. Dokumentacioni**

2.8.1. Operatori duhet të hartojë dhe mirëmbajë dokumentacionin lidhur me menaxhimin e mjedisit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe kërkesat e autoritetit kompetent.

2.8.2. Operatori duhet t'i sigurojë një kopje të Lejes çdo personi përkatës detyrat e të cilit lidhen me ndonjë kusht të kësaj Leje.

## **2.9. Veprimet Korrigjuese**

2.9.1. Operatori duhet të hartojë procedurat për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese për rastet kur nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë Leje. Për këtë arsye duhet të përcaktohen përgjegjësitë dhe autorizimet për të filluar investigimet dhe për të ndërmarrë veprimet korrigjuese përkatëse në rastet e dështimit/pamundësisë për të përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë Leje.

## **2.10. Trainimi**

2.10.1. Operatori duhet të hartojë procedurat për identifikimin e nevojave për trainim dhe duhet të zhvillojë trainimet e duhura për të gjithë punonjësit, puna e të cilëve mund të ketë ndikime të rëndësishme në mjedis. Të dhënat e regjistruara të trainimeve duhet të jenë të disponueshme për autoritetin kompetent.

2.10.2. Punonjësit që kryejnë detyra specifike duhet të kualifikohen nëpërmjet trainimeve dhe eksperiencave të përshtatshme.

## **2.11. Përgjegjësia**

2.11.1. Operatori duhet të sigurojë praninë e një personi përgjegjës në çdo kohë gjatë operimit të instalimit. Personi përgjegjës duhet të jetë i autorizuar dhe i disponueshëm për t'u takuar me persona të autorizuar nga Ministria ose Inspektorati.

## **2.12. Komunikimi**

2.12.1. Operatori duhet të hartojë një procedurë për t'i mundësuar publikut marrjen e informacionit lidhur me performancat mjedisore në çdo kohë. Kjo procedurë duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent për miratim së bashku me dokumentacionin e Lejes.

2.12.2. Operatori duhet të paraqesë një Raport Vjetor të Mjedisit tek autoriteti kompetent çdo vit kalendarik. Ky raport, duhet të përfshijë minimalisht informacionin e specifikuar në Shtojcën 6.2 bashkëngjitur (Përmbajtja e Raportit të Mjedisit).

## **KUSHTI 3 – OPERIMI DHE INFRASTRUKTURA**

- 3.1.** Operatori duhet të krijojë të gjithë infrastrukturën e duhur në lidhje me këtë Leje, në përputhje me kushtet e kësaj Leje, përpara fillimit të funksionimit të instalimit.
- 3.2.** Operatori duhet të parashikojë në çdo pikë shkarkimi një vend për pajisjet e marrjes së mostrave ose monitorimit, duke përfshirë edhe pajisjet për mbledhjen e të dhënave dhe komunikimin e tyre siç kërkohet nga autoriteti kompetent.
- 3.3.** Operatori duhet të sigurojë akses të sigurt në të gjitha pikat e marrjes dhe monitorimit të mostrave në vendndodhje si dhe tek ato që ndodhen jashtë saj, në përputhje me kërkesat e autoritetit kompetent ose të inspektoratit të mjedisit.
- 3.4.** Ruajtja në depozita dhe fuçi
  - 3.4.1.** Sipërfaqet ku janë vendosur depozitat dhe/ose fuçitë duhet të jenë të papërshkueshme dhe rezistente ndaj materialit të ruajtur brenda tyre.
  - 3.4.2.** Të gjitha zonat me depozita dhe/ose fuçi duhet të jenë minimalisht të mbyllura me argjinatura/rrethime lokale ose në distancë me vëllim të barabartë ose më të madh se vlerat e mëposhtme:
    - a) 110% të kapacitetit të depozitës më të madhe që tërhiqet nga graviteti në drejtim të argjinaturës/rrethimit;ose
    - b) 25% të shumës së kapaciteteve të të gjithë depozitave që tërhiqen nga graviteti në drejtim të një argjinature/rrethimi të dhënë.
  - 3.4.3.** Të gjitha rrjedhjet nga zona e rrethuar duhet të devijohen për t'u mbledhur dhe asgjësuar në mënyrë të sigurt.
  - 3.4.4.** Çfarëdolloj tubi hyrje ose dalje, valvule, tubat e daljes dhe matësit duhet të mbahen brenda zonës së argjinaturës/rrethuar.
  - 3.4.5.** Të gjitha argjinaturat/rrethimet duhet të testohen për dëmtime dhe mundësinë e depërtimit të ujit të paktën çdo tre vjet.
  - 3.4.6.** Operatori duhet të ketë sasi të mjaftueshme të përthithësit në vendndodhje, i cili do të përthithë çdo derdhje në instalim. Përthithësi, pas përdorimit duhet të asgjësohet në mënyrë të përshtatshme për tipin e materialit përthithës.
  - 3.4.7.** Operatori, duhet të kryejë një vlerësim të riskut në mënyrë që të përcaktojë nëse është e nevojshme të mbahet uji i përdorur për shuarjen e zjarrit përpara paraqitjes së kërkesës për Leje.
  - 3.4.8.** Nëse përcaktohet që risku ekziston, operatori duhet të përgatisë një Program për Menaxhimin e Riskut, i cili duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent për miratim. Programi duhet të zbatohet tërësisht brenda 3 muajve nga marrja e Lejes.
- 3.5.** Nuk duhet të ketë mbetje të ndërtimit brenda instalimit dhe rrugët duhet të mirëmbahen në mënyrë që të mos shkaktohet gjenerim i pluhurave.
- 3.6.** Të gjithë transportuesit shirit në vend të hapur si dhe ato në ambientet e brendshme me shpejtësi të barabartë ose më të madhe se 3m/s duhet të mbyllën nga sipër.

## KUSHTI 4 – PLANI I PËRPUTHSHMËRISË DHE AFATET KOHORE - VETËM PËR INSTALIMET EKZISTUESE

4.1 Operatori duhet të zbatojë Planin e Përputhshmërisë siç përcaktohet në Tabelën 4.1.1. Përmbajtja e Planit të Përputhshmërisë dhe afatet kohore të zbatimit janë paraqitur në tabelën më poshtë:

TABELA 4.1.1 – Plani i Përputhshmërisë						
Kushti Ref.	Veprimtaria e Përputhshmërisë	Kostot e investimit (EUR)	Fillimi i veprimtarisë (datë)	Fundi i veprimtarisë (datë)	Rezultatet e veprimtarisë	Metoda e kontrollit
		(Totali)				

### SHËNIM

*Veprimtaritë:* Përshkrim i veprimtarisë/veprimtarive që duhet të zhvillohen në mënyrë që të arrihet përputhshmëria e instalimeve me legjislacionin e mjedisit

*Investimet:* Investimet për veprimtarinë

*Fillimi:* Data (muaji/viti) në të cilën është planifikuar fillimi i veprimtarisë

*Përfundimi:* Data (muaji/viti) në të cilën është planifikuar përfundimi i veprimtarisë ose nisja e operimit

*Rezultatet e Veprimtarisë:* Duhet të përshkruhen rezultatet specifike (shembull: reduktimi i shkarkimeve)

*Metoda e kontrollit:* Përshkrim i mënyrës sipas të cilës mund të kontrollohet veprimtaria e kryer

TABELA 4.1.2 – Afatet kohore

	Veprimtaritë	KOSTOT VJETORE – EURO				
		Viti*	Viti*	Viti*	Viti*	Viti*

\*Analizat kosto-përfitim të operatorit, përfshirë shpenzimin vjetor të nevojshëm për zbatimin e secilës veprimtari të tabelës 4.1.2.

## **KUSHTI 5 – INTERPRETIMI**

### **5.1. Vlerat kufi për shkarkimet në ajër duhet të interpretohen si më poshtë:**

#### **5.1.1. Monitorim i vazhdueshëm:**

- a) Asnjë vlerë mesatare për 24 orë nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të shkarkimit;
- b) 95% të të gjithë vlerave mesatare për 30 minuta nuk duhet të tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimit me më shumë se 20%;
- c) Asnjë vlerë mesatare për 30 minuta nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të shkarkimit më shumë se dy herë.

#### **5.1.2. Monitorim jo i vazhdueshëm:**

- a) Nëse për ndonjë arsye, 30 minuta marrje mostre nuk është e mundur të realizohet, është e nevojshme të aplikohet një periudhë e përshtatshme e marrjes së mostrës, dhe vlerat e përfutuara nuk duhet të tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimit.
- b) Për rrjedhjen, asnjë mesatare ditore nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi.
- c) Për parametrat e tjerë, asnjë vlerë mesatare për 30 minuta nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të shkarkimit.
- d) Pragjet e rrjedhjes në masë duhet t'i referohen shkarkimeve të shprehura në njësi të kg/orë mbi të cilat zbatohet vlera kufi e shkarkimit të përqendrimit.
- e) Vlerat prag të rrjedhjes në masë duhet të llogariten mbi bazën e përqendrimit të përcaktuar si një mesatare në një periudhë të dhënë të shumëzuar me një matje të përshtatshme të rrjedhjes. Asnjë vlerë e përcaktuar në këtë mënyrë nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të përcaktuar të rrjedhjes në masë.

### **5.2. Vlerat kufi të përqendrimit për shkarkimet në ajër të përcaktuara në këtë Leje duhet të bazohen në vëllimin e gazit në kushte normale:**

#### **5.2.1. Gazet jo të djegshëm:**

- a) Temperatura 273K, trysnia 101.3kPa (pa korrigjim për oksigjenin ose përmbajtjen e ujit).

#### **5.2.2. Gazet e djegshëm:**

- a) Temperatura 273K, trysnia 101.3kPa, gaz i thatë; 3% oksigjen për lëndët djegëse të lëngshme dhe të gazta, 6% oksigjen për lëndët djegëse të ngurta.

### **5.3. Vlerat kufi për shkarkimet në ujë:**

#### **5.3.1. Matje e vazhdueshme:**

- a) Asnjë vlerë e pH nuk duhet të jetë jashtë gamës së specifikuar.
- b) Asnjë vlerë e rrjedhjes nuk duhet të tejkalojë kufirin e specifikuar.

#### **5.3.2. Matja jo e vazhdueshme:**

- a) Asnjë vlerë e pH nuk duhet të jetë jashtë gamës së specifikuar.
- b) Asnjë vlerë e temperaturës nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi.

- c) Për të gjithë parametrat përveç pH-it, temperaturës dhe rrjedhjes, asnjë mostër mesatare ditore nuk duhet të tejkalojë vlerat kufi të shkarkimit të specifikuara në Shtojcën 3 të Ligjit për Lejet e Mjedisit.
- d) Për të gjithë parametrat përveç pH-it, temperaturës dhe rrjedhjes, asnjë mostër e rastësishme nuk duhet të tejkalojë 1.2 herë vlerat kufi të shkarkimit të përcaktuara në Shtojcën 2.1 dhe /ose 3.1.

#### **5.4. Zhurma**

- 5.4.1.** Zhurma nga instalimi nuk duhet të kalojë ato nivele të përcaktuara për të nga legjislatiioni në fuqi për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Shqipëri. Vlerat kufi e zhurmës duhet të variojnë në varësi të hartës së zhurmës që ndan territorin e Republikës së Shqipërisë në zona industriale, zona urbane, zona spitalore dhe zona të godinave qeveritare. Vlerat kufi të zhurmës do të përcaktohen në varësi të vendndodhjes së secilit instalim.

## **KUSHTI 6 – NJOFTIMET**

**6.1.** Operatori, brenda \_\_\_\_\_(orëve/ditëve) nëpërmjet telefonit, faksit ose postës elektronike, duhet të njoftojë AKM dhe Inspektoratin e Mjedisit lidhur me:

- 6.1.1.** Konstatimin e një shkarkimi të çdo substance nga çdo burim potencial, i cili tejkalon ndonjë kufi ose kriter në këtë Leje të specifikuar në lidhje me substancën;
- 6.1.2.** Konstatimin e çdo shkarkimi flurues i cili ka shkaktuar ose mund të shkaktojë ndotje përveç rasteve kur sasia e shkarkuar është kaq e parëndësishme sa do të ishte e pamundur të shkaktonte ndotje;
- 6.1.3.** Konstatimin e çdo keqfunksionimi, defekti ose avarie të impiantit ose teknikave që kanë shkaktuar ose mund të kenë potencialin të shkaktojnë ndotje; dhe
- 6.1.4.** Çdo aksident që ka shkaktuar ose mund të ketë potencialin të shkaktojë ndotje.

Në njoftim, operatori duhet të tregojë qartë datën dhe kohën e incidentit, detajet e ngjarjes dhe masat për të minimizuar çdo shkarkim.

**6.2.** Operatori duhet të hartojë një raport për çdo incident.

- 6.2.1.** Operatori duhet të përgatisë një raport për çdo incident të përmendur në kushtin 6.1. Raporti duhet të përfshijë detaje mbi natyrën, përmasat , ndikimin dhe rrethanat të cilat kanë shkaktuar incidentin. Raporti duhet të përmbajë masat e ndërmarra për normalizimin e situatës për: menaxhimin e incidentit, minimizimin e mbetjeve të gjeneruara dhe efekteve në mjedis dhe për parandalimin e përsëritjes së incidentit.
- 6.2.2.** Një përmbledhje e incidentit duhet të përfshihet në Raportin Vjetor të Mjedisit.
- 6.2.3.** Në rastin e një incidenti i cili ka shkaktuar shkarkime në kanalizime, operatori duhet të njoftojë pronarin përkatës të kanalizimeve në kohën më të shkurtër të mundshme /menjëherë pas incidentit.
- 6.2.4.** Njësitë e qeverisjes vendore përkatëse duhet të njoftohen për incidentin në kohën më të shkurtër të mundshme/menjëherë pas incidentit.

**6.3.** Operatori duhet të njoftojë me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur, për secilin nga rastet e mëposhtme:

- 6.3.1.** Ndërprerjen e përhershme të operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për të cilin është dhënë Leja;
- 6.3.2.** Ndërprerjen e operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për të cilin është dhënë Leja për një periudhë, që ka gjasa të tejkalojë (\_\_\_\_) vit/vjet; dhe
- 6.3.3.** Rifillimin e operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për të cilin është dhënë Leja pas një ndërprerje të njoftuar sipas pikës 6.3.2.

**6.4.** Operatori duhet të njoftojë me shkrim autoritetin kompetent lidhur me çështjet e mëposhtme, brenda (\_\_\_\_) ditëve nga ndodhja e tyre:

- 6.4.1.** Çdo ndryshim në emrin tregtar të operatorit, emrin e regjistruar ose adresën e zyrës së regjistruar në përputhje me të dhënat që rezultojnë në Ekstraktin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR);

- 6.4.2.** Çdo ndryshim në të dhënat e shoqërisë mëmë të Operatorit (përfshirë detajet e shoqërisë mëmë kur vlerësohet se ekziston një marrëdhënie shoqëri mëmë-Operator dhe Operatori është bërë shoqëri bijë)<sup>1</sup>;
- 6.4.3.** Çdo hap i ndërmarrë me synimin që Operatori të shkojë drejt administrimit, të lidhjes së një marrëveshje vullnetare ose të shkojë drejt procedurave të likuidimit.

---

<sup>1</sup> Për çdo informacion shtesë, lutemi konsultoni Pjesën e VII "Grupimi I shoqërive", të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## KUSHTI 7 – SHKARKIMET

### 7.1. SHKARKIMET NË AJËR

- 7.1.1. Shkarkimet në ajër nga pika(t) e shkarkimit të specifikuara në Tabelën 1.1.1 të Shtojcës 1.1 duhet të dalin vetëm nga burimi/burimet e specifikuara në atë Tabelë. (Referohuni numrit të referencës së Planit të vendndodhjes.)
- 7.1.2. Vlerat kufi të shkarkimeve apo Kufijtë për shkarkimet në ajër për parametrin/parametrat dhe pikën/pikat e shkarkimit të përcaktuara në Tabelën 1.1.2 të Shtojcës 1.1 nuk duhet të tejkalohen në periudhën kohore të treguar indicated në këtë Tabelë.
- 7.1.3. Operatori duhet të kryejë monitorimin dhe analizën për çdo shkarkim/parametër të listuar në Tabelën 1.2.1 të Shtojcës 1.2 nga pikat e shkarkimit dhe të paktën në frekuencat e specifikuara në atë Tabelë. Analiza duhet të kryhet me aparate/mjete të kalibruar ose në rastin e monitorimit jo të vazhdueshëm matjet duhet të kryhen nga një ekspert ose laborator i çertifikuar.
- 7.1.4. Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimin, monitorimit dhe kontrollit duhet të kalibrohen dhe mirëmbahen, ndërkohë që janë në përdorim, dhe të dhënat e regjistruara përkatëse të kalibrimit dhe mirëmbajtjes duhet të mbahen në vendndodhje dhe të jenë të disponueshme në rast inspektimi nga personeli i autorizuar i autoritetit kompetent. Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimin duhet të funksionojnë gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprimtarive, përveç rasteve kur është rënë dakord me autoritetin kompetent për zgjidhje alternative.
- 7.1.5. Raporti përmbledhës mbi shkarkimet duhet t'i dërgohet Inspektoratit të Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit çdo (\_\_\_\_) muaj dhe duhet të përfshihet në Raportin Vjetor të Mjedisit.
- 7.1.6. Të gjitha shkarkimet nga instalimi nuk duhet të kenë erë të pakëndshme sulmuese jashtë kufirit të instalimit.
- 7.1.7. Të gjitha shkarkimet në ajër, përveç avullit ose avull uji të kondensuar, nuk duhet të kenë pikëza, mjegull dhe tym të vazhdueshëm.
- 7.1.8. Të gjitha shkarkimet nuk duhet të kenë tym të dukshëm. Nëse për arsye mirëmbajtje, shkaktohen shkarkime tymi për shkak të rindezjes nga i ftohti, kjo nuk duhet të ndodhë për një periudhë më të gjatë se 20 minuta në çdo periudhë prej 8 orësh dhe kur të jenë marrë të gjithë hapat praktikë për të minimizuar shkarkimin.
- 7.1.9. Shkarkimet e përgjithshme të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) nuk duhet të tejkalojnë 20% të tretësit të përdorur, nëse konsumi tejkalon 5t/vit.
- 7.1.10. Operatori, brenda gjashtë muajve nga data e lëshimit të kësaj Leje, duhet të përgatisë një plan të përshtatshëm të menaxhimit të tretësve organikë dhe t'ia paraqesë autoritetit kompetent për miratim.
- 7.1.11. Operatori, brenda gjashtë muajve nga data e lëshimit të kësaj Leje, duhet të përgatisë një program për identifikimin, monitorimin dhe pakësimin e shkarkimeve fluruese në ajër dhe paraqesë tek autoriteti kompetent për miratim. Programi duhet të zbatohet tërësisht brenda 3 muajve nga data e miratimit.
- 7.1.12. Operatori duhet të sigurojë që veprimtaritë në vendndodhje të zbatohen në mënyrë të tillë që shkarkimet në ajër dhe (ose) erërat e pakëndshme të mos shkaktajnë dëmtime të rëndësishme të mjedisit përtej kufijve të instalimit.

## **7.2. SHKARKIMET NË KANALIZIME**

- 7.2.1.** Shkarkimet në kanalizime nga pika(t) e shkarkimit të specifikuara në Tabelën 2.1.1 të Shtojcës 2.1 duhet të dalin vetëm nga burimi(et) e specifikuara në atë Tabelë. (Referohuni numrit të referencës së Planit të vendndodhjes).
- 7.2.2.** Kufijtë për shkarkimet në kanalizime për parametrin/parametrat dhe pikën/pikat e shkarkimit të përcaktuara në Tabelën 2.1.2 të Shtojcës 2.1 nuk duhet të tejkalohen në periudhën kohore të treguar në këtë Tabelë.
- 7.2.3.** Operatori duhet të kryejë monitorimin dhe analizën e parametrave të listuar në Tabelën 2.2.1 të Shtojcës 2.2 nga pikat e shkarkimit dhe të paktën në frekuencat e specifikuara në atë Tabelë.
- 7.2.4.** Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimit, monitorimit dhe kontrollit duhet të kalibrohen dhe mirëmbahen, ndërkohë që janë në përdorim, dhe të dhënat e regjistruara përkatëse të kalibrimit dhe mirëmbajtjes duhet të mbahen në vendndodhje dhe të jenë të disponueshme në rast inspektimi nga personeli i autorizuar i autoritetit kompetent. Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimit duhet të funksionojnë gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprimtarive, përveç rasteve kur është rënë dakord me autoritetin kompetent për zgjidhje alternative.
- 7.2.5.** Raporti përmbledhës për shkarkimet duhet të përfshihet në Raportin Vjetor të Mjedisit.
- 7.2.6.** Operatori duhet të paraqesë raportin përmbledhës tek autoritetet e autorizuar të higjenës dhe të shëndetit publik.
- 7.2.7.** Përveç ujit sanitar, asnjë lloj tjetër uji nuk duhet të shkarkohet në kanalizime.
- 7.2.8.** Ujërat e ndotur nuk duhet të përmbajnë tretës organikë (përfshirë tretësit organikë të klorinuar) që mund të çojnë në krijimin e avujve shpërthyes brenda kanalizimeve.
- 7.2.9.** Operatori nuk duhet të shkarkojë lëndë të lëngshme ose lëndë të tjera që mund të ngecin ose ngurtësohen në temperaturën mesatare të ujit të kanalizimit ose mund të krijojnë gazra që marrin flakë ose që janë shpërthyes ose acide, alkaline apo substanca të tjera në përqendrime që mund të shkatërrojnë tubacionet e kanalizimeve dhe pajisjet e tyre ose t'i dëmtojnë ato në mënyrë tjetër.
- 7.2.10.** Nuk lejohet të shkarkohet në kanalizime lëndë në përqendrime të cilat do të ishin të rrezikshme për shëndetin e personelit të mirëmbajtjes ose të cilat do të ndikonin në trajtimin biologjik në fazat e ardhshme të trajtimit të ujërave të ndotura.
- 7.2.11.** Nuk duhet të shkarkohen në kanalizime substanca, në përqendrime të cilat pas hollimit fillestar në një mjedis pritës mund të rezultojnë të dëmshme për jetën ujore.
- 7.2.12.** Operatori duhet t'i krijojë mundësi personelit të autorizuar nga autoriteti kompetent/inspektorati që të inspektojë, kontrollojë ose testojë çdo operacion ose pajisje në çdo kohë (moment) të arsyeshme në lidhje me ujërat e ndotur ose të marrë një mostër uji që është objekt i kushteve të kësaj Leje.
- 7.2.13.** Ndalohet shkarkimi i substancave të cilat shkaktojnë reaksione kimike ose që shkaktojnë krijimin e ndërmjetësve me ndikime të rëndësishme negative në mjedis.

### **7.3. SHKARKIMET NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË (PËRVEÇ SHKARKIMEVE NË KANALIZIME)**

- 7.3.1.** Shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë nga pika(t) e shkarkimit të specifikuara në Tabelën 3.1.1 të Shtojcës 3.1 duhet të dalin vetëm nga burimi(et) e specifikuara në atë tabelë (Referohuni numrit të referencës së Planit të vendndodhjes ).
- 7.3.2.** Vlerat kufi Kufijtë për shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë për parametrin/parametrat dhe pikën/pikat e shkarkimit të përcaktuara në Tabelën 3.1.2 të Shtojcës 3.1 nuk duhet të tejkalohen në periudhën kohore të treguar në këtë Tabelë.
- 7.3.3.** Operatori duhet të kryejë inspektime vizuale ditore të shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore. Të dhënat e inspektimit duhet të mbahen dhe të vihen në dispozicion autoritetit kompetent për inspektimin.
- 7.3.4.** Monitorimi i ujërave të shkarkuara tek ujërat sipërfaqësore duhet të kryhet siç është përcaktuar në Tabelën 3.2.1 të Shtojcës 3.2 mbi Monitorimin e Shkarkimeve në Ujërat Sipërfaqësorë. Raporti duhet të jetë pjesë përbërëse e Raportit Vjetor të Shkarkimeve. Operatori duhet të marrë mostra dhe të monitorojë kanalën e kullimit {specifiko} në një frekuencë {specifiko}.
- 7.3.5.** Nuk duhet të ketë asnjë shkarkim në ujë nga instalimi i pajisur me Leje mjedisi të ndonjë substance për të cilën nuk ka vlera kufi të specifikuara në Tabelën 3.1.2 të Shtojcës 3.1 (përveçse në një përqendrim i cili nuk është më i madh se sa përqendrimi i mjedisit ekzistues).
- 7.3.6.** Në rast të ndonjë konstatimi të ndotjes, mbajtësi i Lejes duhet të:
  - a) Kryejë menjëherë investigimin në mënyrë që të identifikojë dhe izolojë burimin e ndotjes.
  - b) Përgatisë masat për parandalimin e ndotjes dhe reduktimin e pasojave nëse ndodh një ndotje e tillë.
  - c) Njoftojë autoritetin kompetent dhe inspektoratin brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.

### **7.4. UJËRAT NËNTOKËSORË DHE TOKA**

- 7.4.1.** Nuk lejohet të shkarkohet asnjë lëndë ndotëse në tokë ose në ujërat nëntokësorë nën vendndodhjen e instalimit.
- 7.4.2.** Mjetet për mbrojtjen e tokës dhe ujërave nëntokësorë  
Operatori duhet të zbatojë gjithashtu masat e mëposhtme:
  - a. Testi i parë i papërshkueshmërisë së rrethimit/arginaturës duhet të përfundohet brenda datës (dita/muaji/viti).
  - b. Ngarkimi dhe shkarkimi i lëngjeve dhe lëndëve të tjera që mund të ndikojnë tek ujërat nëntokësorë, duhet të kryhet në zonat e përcaktuara në kërkesë për këtë qëllim dhe që janë të mbrojtura kundër rrjedhjeve ose derdhjeve.
  - c. Të gjitha bashkimet dhe valvulat për transportin e të gjitha materialeve, duhet të kontrollohen rregullisht (inspektim vizual javor), me përjshatim të ujit të pastër për të cilin nuk ka mënyrë të parashikuar për kontrollin e shkarkimit.
  - d. Të gjitha këto inspektime duhet të dokumentohen dhe të dhënat e regjistruara duhet të mbahen në vendndodhje dhe duhet t'i vihen në dispozicion personave të autorizuar për inspektim.

## **KUSHTI 8 – MENAXHIMI I MBETJEVE**

- 8.1.** Asgjësimi dhe përdorimi i mbetjeve duhet të kryhet vetëm sipas përcaktimeve të Tabelës 4.1.1 të Shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe Tabelës 4.1.2 të Shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të tjera në këtë Leje. Tipet e tjera të mbetjeve, me përjashtim të atyre të specifikuara në tabela, nuk duhet të asgjësohen/trajtohen në vendndodhje ose jashtë saj pa informuar më parë Ministrinë dhe pa marrë miratim me shkrim nga Ministria. (Nëse mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme nuk ruhen ose trajtohen në vendndodhje , është e nevojshme që në shtojcën përkatëse të shkruhet se "mbetjet nuk trajtohen/asgjësohen në këtë vendndodhje").
- 8.2.** Operatori, në përputhje me kushtet e kësaj Leje, duhet të trajtojë dhe ruajë mbetjet siç përshkruhet në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 4.2.1 të Shtojcës 4.2 për ruajtjen e Mbetjeve ose ndryshe siç është rënë dakord me shkrim nga autoriteti kompetent. Mbetjet nuk duhet të ruhen në vendndodhje për një periudhë më të gjatë se 1 vit në qoftë se ato janë paracaktuar për asgjësim ose jo më shumë se 3 vjet nëse ato janë të paracaktuar për riciklim/trajtim.
- 8.3.** Mbetjet e larguara nga vendndodhja për asgjësim/trajtim duhet të transportohen vetëm nga një kontraktor i autorizuar dhe i pajisur me Lejet/licensat përkatëse. Operatori, në përputhje me kushtet e kësaj Leje, duhet të rikuperojë dhe asgjësojë mbetjet siç përshkruhet në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 4.3.1 të Shtojcës 4.3 mbi rikuperimin dhe asgjësimin, apo ndryshe siç është rënë dakord me shkrim nga autoriteti kompetent.
- 8.4.** Amendamentet e e kërkesave të marrëveshjes, klasifikimit, trajtimit dhe asgjësimit duhet të kryhen vetëm me anë të një marrëveshje paraprake nga autoriteti kompetent.
- 8.5.** Paketimi, etiketimi duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet kombëtare, europiane dhe standardet e tjera..
- 8.6.** Nuk lejohet përzjerja e mbetjeve të rrezikshme të njëjës kategori me mbetje të rrezikshme nga një kategori tjetër, me përjashtim të rasteve kur kjo është miratuar me shkrim nga autoriteti kompetent.
- 8.7.** Të gjitha të dhënat e regjistruara që lidhen me menaxhimin e mbetjeve duhet t'i vihen në dispozicion për inspektim autoritetit kompetent. Këto të dhëna duhet të përmbajnë si minimum elementët e mëposhtëm:
  - a) Sasinë dhe kodet KEM (EWC) për mbetjen në Tabelën 4.1.1 të Shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe Tabelës 4.1.2 të Shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të tjera në këtë Leje.
  - b) Emrin e grumbulluesit të mbetjeve dhe transportuesit dhe detajet e Lejeve/licencave/autorizimeve të tyre (përfshirë autoritetin lëshues).

- c) Detaje rreth instalimit për asgjësimin/trajtimin përfundimtar të mbetjeve dhe pajtueshmërinë e instalimit për asgjësimin/trajtimin e mbetjeve dorëzuara, detajet e Lejes/licencës/autorizimit dhe detajet për autoritetin lëshues.
- d) Konfirmimin me shkrim për pranimin dhe asgjësimin/trajtimin të çdo dërgese mbetjesh jashtë vendndodhjes.
- e) Detaje për çdo dërgesë jashtë shtetit për qëllim të trajtimit të përcaktuar si “të listës së Gjelbër” në bazë të Rregullores KEE Nr. 259/1993 dhe amendamenteve të saj. Arsyetimi për klasifikimin duhet të përbëjë një pjesë integrale të dokumentacionit.
- f) Të dhëna për të gjitha dërgesat e refuzuara.
- g) Detaje për të gjitha përzierjet e miratuara të mbetjeve në përputhje me kushtet e pikës 8.6.

**8.8.** Një kopje e dokumentacionit mbi menaxhimin e mbetjeve duhet t’i dorëzohet autoritetit kompetent si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit.

## **KUSHTI 9 – ZHURMA DHE VIBRACIONET**

- 9.1.** Operatori duhet të propozojë shpeshtësinë, metodologjinë dhe kohën e matjeve.
- 9.2.** Dokumentacioni mbi kushtet dhe rezultatet e matjes duhet t’i vihet në dispozicion për inspektim autoritetit kompetent ose inspektoratit të mjedisit në çdo kohë të arsyeshme. Raporti përmbledhës mbi këto të dhëna të regjistruara siç përcaktohet në Tabelën 5.1.1 të Shtojcës 5.1 duhet të jetë pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit.
- 9.3.** Veprimtaritë në vendndodhje nuk duhet të rezultojnë me nivele të rritura të zhurmës ose të tejkalojnë vlerat e mëposhtme (Leq, t):
  - Ditën: \_\_\_\_\_ dB (A)
  - Në mbrëmje: \_\_\_\_\_ dB (A)
  - Natën: \_\_\_\_\_ dB (A)
- 9.4.** Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës gjatë operimit të instalimeve.
- 9.5.** Operatori duhet të.....(kushte specifike për vibracionet/shpërthimet).

## **KUSHTI 10 – LËNDËT E PARA DHE PËRDORIMI I ENERGJISË**

- 10.1.** Operatori duhet të kryejë auditimin e efiçencës së energjisë brenda një viti nga lëshimi i kësaj Leje. Operatori duhet të konsultohet me autoritetin kompetent mbi natyrën dhe qëllimin e auditimit dhe të hartojë një program auditimi. Programi i auditimit duhet t'i paraqitet organit kompetent për miratim të paktën një muaj përpara kryerjes së tij. Kopja e raportit të auditimit duhet t'i vihet në dispozicion autoritetit kompetent në vendndodhje, dhe një përmbledhje e gjetjeve të tij duhet t'i paraqitet atij si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit. Auditimi i efiçencës së energjisë duhet të kryhet në përputhje me intervalet e përcaktuara nga autoriteti kompetent.
- 10.2.** Operatori duhet të identifikojë çdo mundësi për përmirësimin e efiçencës së energjisë dhe rekomandimet duhet të bëhen pjesë e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në Kushtin 2.
- 10.3.** Operatori duhet të identifikojë potencialin për reduktim të sasisë së ujit të përdorur në vendndodhje. Operatori duhet të paraqesë një raport të hollësishëm lidhur me progresin dhe propozimet për reduktimin e ujit të përdorur dhe shkarkimin e ujërave të ndotura tek autoriteti kompetent, si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit.
- 10.4.** Operatori duhet të përgatisë vlerësimin e efiçencës së përdorimit të lëndëve të para në të gjitha proceset, me theks të veçantë në reduktimin e mbetjeve të gjeneruara.

## **KUSHTI 11 – MONITORIMI**

**11.1.** Operatori duhet të kryejë marrjen e mostrave, të bëjë analiza, matje, testime dhe kalibrimin e pajisjeve, siç përcaktohet në Shtojcat si vijon:

*Shtojca 1.2: Monitorimi i shkarkimeve në ajër*

*Shtojca 2.2: Monitorimi i shkarkimeve në kanalizime*

*Shtojca 3.2: Monitorimi i shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore*

**11.2.** Nëse mundësia e matjes së një parametri ndikohet nga përzierja përpara shkarkimit, ky parametër duhet të matet përpara momentit të përzierjes, pas marrjes së miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.

**11.3.** Të gjithë monitorët automatikë dhe pajisjet e marrjes së mostrave duhet të funksionojnë në çdo moment (me përjashtim të periudhave gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimit) gjatë operimit të një instalimi, me përjashtim të rasteve kur autoriteti kompetent ka miratuar marrjen e mostrave ose monitorimin alternativ. Në rast të avarive ose mosfunksionimit të ndonjë pajisje të monitorimit të vazhdueshëm, operatori duhet të informojë autoritetin kompetent sa më shpejt të jetë e mundur dhe të vendosë një pajisje alternative. Përdorimi i pajisjeve alternative jashtë rasteve emergjente është i mundur vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.

**11.4.** Pajisjet për monitorimin dhe analizën duhet të përdoren dhe mirëmbahen në mënyrë që të tregojnë saktë shkarkimet dhe/ose çlirimet.

**11.5.** Ndryshimi i shpeshtësisë, metodës dhe qëllimit të monitorimit është i mundur vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent, bazuar në analizën e rezultateve të testimit.

**11.6.** Operatori duhet do të sigurojë akses të sigurt dhe të përhershëm për të mundësuar marrjen e të gjitha mostrave dhe monitorimet që do të kryhen në lidhje me pikat e shkarkimit që lidhen me:

- a) Shkarkimin në ajër
- b) Rrjedhjet pas largimit nga instalimi
- c) Burimet e zhurmës në vendndodhje
- d) Vendet e përcaktuara për asgjësimin e mbetjeve në vendndodhje
- e) Shkarkimet në ujërat sipërfaqësore

**11.7.** Operatori duhet të sigurojë akses të sigurt në të gjitha pikat e tjera monitoruese sipas kërkesës së autoritetit kompetent.

**11.8.** Marrja e mostrave dhe analizat duhet do të kryhen siç përcaktohen në standardet ISO.

## **KUSHTI 12 – DOKUMENTIMI DHE RAPORTIMI TEK AUTORITETI KOMPETENT**

- 12.1.** Operatori duhet të bëjë regjistrimin e të dhënave për të gjitha rastet e marrjes së mostrave, matjeve, testimeve, kalibrimeve dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të monitorimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Leje.
- 12.2.** Operatori duhet do të hartojë dhe të mbajë dhëna për çdo incident që mund të ndikojë në funksionimin e rregullt dhe që mund të paraqesë një rrezik për mjedisin.
- 12.3.** Operatori duhet të përgatisë një raport për çdo ankesë që ka të bëjë me mjedisin që lidhet me operimin e instalimit. Çdo raport duhet të përmbajë informacion mbi kohën dhe datën e ankesës, emrin e ankuesit dhe natyrën e ankesës. Operatori duhet të mbajë gjithashtu një kopje të përgjigjeve ndaj secilës ankesë. Brenda një muaji nga marrja e ankesës, operatori duhet të paraqesë një raport mbi ankesën tek autoriteti kompetent. Përmbledhja mbi numrin dhe natyrën e ankesave duhet të përfshihet në Raportin Vjetor të Mjedisit.
- 12.4.** Forma e raportit duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kompetent. Këto raporte duhet të mbahen në vendndodhje të paktën (\_\_\_\_) vjet dhe të jenë të disponueshme në rast inspektimi.
- 12.5.** Raportet mbi të gjitha të dhënat e regjistruara, rastet e marrjes së mostrave, të matjeve, analizave, kalibrimit dhe mirëmbajtjes siç përcaktohet në Tabelën 6.1.1 të Shtojcës 6.1 Dokumentimi i të dhënave dhe Raportimi tek Autoriteti Kompetent duhet t'i dorëzohen autoritetit kompetent jo më vonë se (data dhe formati i raportit).
- 12.6.** Me kërkesë të autoritetit kompetent, operatori duhet të paraqesë gjithashtu informacionin mjedisor në lidhje me këtë Leje në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit kompjuterik të autoritetit kompetent.
- 12.7.** Të gjithë raportet duhet të miratohen nga menaxheri i përgjithshëm i instalimit ose nga menaxheri teknik i autorizuar nga menaxheri i përgjithshëm i instalimit.
- 12.8.** Përshkrime me shkrim të procedurave për kontrollin e operimeve që mund të jenë të lidhura me Lejen, duhet t'i vihen në dispozicion nëpunësve të autorizuar të inspektoratit ose të autoritetit kompetent në vendndodhje në çdo kohë të arsyeshme.
- 12.9.** Në varësi të rezultateve, autoriteti kompetent mund të ndryshojë shpeshhtësinë dhe qellimin e raportimit.

## **KUSHTI 13 – INCIDENTET DHE VEPRIMET GJATË EMERGJENCEVE**

- 13.1.** Brenda (\_\_\_\_) muajve nga dhënia e kësaj Leje, operatori duhet të miratojë një politikë për parandalimin e aksidenteve, në mënyrë të veçantë ato që mund të kenë ndikim në mjedis.
- 13.2.** Brenda (\_\_\_\_) muajve nga dhënia e kësaj Leje, operatori duhet të përcaktojë procedurat për t'iu përgjigjur emergjencave, të cilat duhet të përfshijnë çdo situatë të rrezikshme që mund të krijohet në vendndodhje. Këto procedura duhet të përfshijnë masat që synojnë minimizimin e ndikimit në mjedis të këtyre situatave.
- 13.3.** Politikat dhe procedurat duhet të vlerësohen çdo vit dhe amendohen sipas nevojës.
- 13.4.** Operatori gjatë përgatitjes së politikës për parandalimin e aksidenteve duhet të marrë në konsideratë edhe parashikimet e ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe veçanërisht dispozitat mbi përgjegjësinë mjedisore.

## **KUSHTI 14 – ÇMONTIMI, REHABILITIMI DHE KONTROLLI PAS NDËRPRERJES SË OPERACIONEVE**

- 14.1.** Brenda (\_\_\_\_) muajve nga data e marrjes së Lejes, operatori duhet të përgatisë dhe paraqesë për miratim tek AKM një plan të detajuar dhe kostot përkatëse për çmontimin ose mbylljen e instalimit.
- 14.2.** Planet për çmontimin dhe rehabilitimin duhet të rishikohen çdo vit dhe të paraqiten për miratim në AKM.
- 14.3.** Pas mbylljes së instalimit ose të një pjese të tij për më shumë se (\_\_\_\_) muajsh ose ndërprerjes së planifikuar të operacioneve në të gjithë instalimin ose në një pjesë të tij, operatori duhet të kryejë rehabilitimin në përputhje me planin e miratuar nga AKM.
- 14.1.** Garanci Bankare ose Sigurim me qëllim vënien paraprakisht në dispozicion të fondeve për kompensimin e dëmit në përputhje me metodat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për sigurimin e fondeve të tilla.

## SHTOJCA 1.1 – SHKARKIMET NË AJËR

**Tabela 1.1.1: Pikat e shkarkimit në ajër**

Numri i referencës i pikës së shkarkimit:	A1
Vendndodhja e pikës së shkarkimit (përdor Sistemin e Koordinatave GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4):	X: Y:
Burimi	
Sasia e emetuar: maksimumi ditor:	m <sup>3</sup>
Rrjedhja maksimale në një orë:	m <sup>3</sup> /h
*Lartësia minimale e shkarkimit:	m mbi tokën

\* Përsëriteni për pikat e tjera të shkarkimit

**TABELA 1.1.2: Vlerat kufi të shkarkimit në ajër**

Parametrat	Referenca e pikës së shkarkimit A1-1	
	Deri në (datën)*	Nga (data)**

\* VKSH para zbatimit të Planit të Përputhshmërisë

\*\* VKSH bazuar në TMD të arritura pas zbatimit të Planit të Përputhshmërisë

*Shto rreshta dhe/ose kolona nëse është e nevojshme*

*Për çdo pikë shkarkimi tabelë e veçantë*

## SHTOJCA 1.2 – SHKARKIMET NË AJËR – Kontrolli i reduktimit/trajtimit

**TABELA 1.2.1 - Monitorimi i parametrave nga pika(t) e shkarkimit**

Parametri	Pika e shkarkimit (A1-1)	Metodat/teknikat
	{Specifiko shpeshtësinë/frekuencën}	-
	{ Specifiko shpeshtësinë }	-
	{Specifiko shpeshtësinë}	-

*Shenim: Një grup tabelash për pajisjet e reduktimit të shkarkimeve në çdo vend shkarkimi.*

*Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kushtet e reja kanë hyrë në fuqi.*

## SHTOJCA 2.1 – SHKARKIMET NË KANALIZIME

TABELA 2.1.1 Pikat e shkarkimit në kanalizime			
Numri i referencës i pikës së shkarkimit:	K1		
Koordinatat e pikës së shkarkimit në Sistemin e Koordinatave GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	X:		
	Y:		
Burimi			
Kanalizimi			
Vëllimi i emetuar	Maksimumi ditor	m <sup>3</sup>	
	Maksimumi në orë	m <sup>3</sup>	

TABELA 2.1.2 Vlerat kufi të shkarkimit në kanalizime				
Parametri	Pika e shkarkimit K1		Pika e shkarkimit K2	
	Deri në (datën)	Nga (data)	Deri në (datën)	Nga (data)
Rrjedhja (m <sup>3</sup> /h)				
pH				
Temperatura (°C)				
Toksiciteti				

## SHTOJCA 2.2 – SHKARKIMET NË KANALIZIME – Monitorimi

TABELA 2.2.1 - Kërkesat e monitorimit për kanalizimet (nga dita/muaji /viti)		
Parametri	Pikat e shkarkimit (K1)	Metodat /teknikat
	{specifiko frekuencën}	-
	{specifiko frekuencën}	-
	{specifiko frekuencën}	-
Oksigjen i shpërbërë		-
Azot Amoniaku si N mg/l		
Rrjedhja ditore m <sup>3</sup>		
Niveli maksimal i rrjedhjes m <sup>3</sup> /orë		-
Përbërës organikë të fosforit		-

*Shenim: Një grup tabelash për pajisjet e reduktimit të shkarkimeve në çdo vend shkarkimi*

*Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kushtet e reja kanë hyrë në fuqi.*

### SHTOJCA 3.1 – SHKARKIMET NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË (PËRVEÇ SHKARKIMEVE NË KANALIZIME)

**TABELA 3.1.1: Pikat e shkarkimit në ujë**

Numri i referencës i pikës së shkarkimit:	U1	
Koordinatat e pikës së shkarkimit në Sistemin e Koordinatave GAUS KRUGE:	X: Y:	
1942_GK_ZONE_4		
Burimi		
Uji i pritur		
Rrjedhja :		
Maksimumi ditor:		m3/h
Maksimumi në orë:		m3/h

**TABELA 3.1.2 Vlerat kufi të shkarkimit në ujërat sipërfaqësorë**

Parametri	Pika e shkarkimit U1		Pika e shkarkimit U2	
	To (data)	Nga (data)	Në (data)	Nga (data)
Rrjedhja (m3/h)				
pH				
Temperatura (°C)				
Toksiciteti				
PE				

### SHTOJCA 3.2 – SHKARKIMET NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË (PËRVEÇ SHKARKIMEVE NË KANALIZIME– Monitorimi)

**TABELA 3.2.1 - Monitorimi i parametrave nga pika (t) e shkarkimit**

Parametri	Pika e shkarkimit (TU 1)	Metodat /teknikat
	{Specifiko shpeshtësinë}	-
	{Specifiko shpeshtësinë}	-
	{Specifiko shpeshtësinë }	-

*Shenim: Një grup tabelash për pajisjet e reduktimit të shkarkimeve në çdo vend shkarkimi Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Pajtueshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kushtet e reja kanë hyrë në fuqi.*

#### SHTOJCA 4.1 – MENAXHIMI I MBETJEVE – Asgjësimi/trajtimi

TABELA 4.1.1 Asgjësimi / trajtimi i mbetjeve të rrezikshme				
Mbetja	Numri i katalogut	Trajtim i mëtejshëm në vendndodhje	Ripërdorimi, riciklimi ose trajtimi në vendndodhje	Metoda e asgjësimit /trajtimin në vendndodhje

Shenim: Shtoni rreshta nëse është e nevojshme

TABELA 4.1.2 Asgjësimi / trajtimi i mbetjeve të tjera				
Mbetja	Numri i katalogut	Trajtim i mëtejshëm në vendndodhje	Ripërdorimi, riciklimi ose or trajtimi në vendndodhje	Metoda e asgjësimit /trajtimin jashtë vendndodhjes

Shenim: Shtoni rreshta nëse është e nevojshme

#### SHTOJCA 4.2 – MENAXHIMI I MBETJEVE – Ruajtja

TABELA 4.2.1 : Mbetjet e ruajtura në vendndodhje			
Përshkrim i mbetjes	Vendndodhja e vendit të ruajtjes	Mënyra e ruajtjes	Kushtet e ruajtjes

Shenim: Shtoni rreshta nëse është e nevojshme

#### SHTOJCA 4.3 – MENAXHIMI I MBETJEVE – Rikuperimi dhe asgjësimi

Tabela 4.3.1: Rimarrja dhe asgjësimi i mbetjeve		
Përshkrimi	Dokument	Data e marrë

Shenim: Shtoni rreshta nëse është e nevojshme

## SHTOJCA 5.1 – ZHURMA

Tabela 5.1.1 Vlerat kufi të zhurmës				
Vendndodhja	Koordinatat (sistemi GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Natë
	X Y			
	X Y			

*Shenim: Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kanë hyrë në fuqi kushtet e reja.*

## SHTOJCA 6.1 – DOKUMENTIMI I TË DHËNAVE DHE RAPORTIMI TEK AUTORITETI KOMPETENT

**Tabela 6.1.1. Dokumentimi i të dhënave dhe raportimi**

Paraqisni raporte të përfunduara tek:

Adresa:

Raporte	Shpeshësia e raportimit	Data e paraqitjes së raportit
Monitorimi i shkarkimeve në ajër		
Monitorimi i shkarkimeve në ujëra		
Ujë sipërfaqësor		
Ankesa (nëse ka)		
Propozimi për regjistrin e shkarkimit të ndotjes		
Programi i Monitorimit të Zhurmës		
Programi i Menaxhimit të Mjedisit me shtojcë për objektivat dhe detyrat		
Raporti Vjetor i Mjedisit		

## SHTOJCA 6.2 PËRMBAJTJA E RAPORTIT VJETOR TË MJEDISIT

<b>TABELA 6.2.1 – Përmbajtjetja e Raportit Vjetor të Mjedisit</b>
Programi i Menaxhimit të Mjedisit – raport.
Regjistri i shkarkimit të ndotjes – raporti për vitin paraardhës.
Regjistri i shkarkimit të ndotjes – propozimi për vitin aktual
Raport përmbledhës mbi rezultatet për monitorimin e zhurmës
Përshkrim i monitorimit të mjedisit
Përshkrim i monitorimit të zhurmës
Përshkrim i incidenteve
Raporti mbi testimin e depozitave dhe tubacioneve
Raport përmbledhës për auditimin e efikasitetit të energjisë, përfshirë raportin e djegies të secilit <i>bojler</i> në instalim, të kryer nga një person i autorizuar
Raport për vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të lëndëve të para dhe reduktimin e gjenerimit të mbetjeve
Dokumentacioni përkatës për menaxhimin e mbetjeve
Raporti për progresin dhe propozimet për reduktimin e konsumit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura
Deklaratë mbi masat për parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe veprimet e rehabilitimit (përgjegjësia mjedisore)
Përshkrim i vlerësimit të riskut në terma të përgjegjësisë mjedisore (çdo tre vjet ose më shpesh nëse kjo bëhet e nevojshme nga kushtet në vendndodhje)
Raporte të tjera të kërkuara nga autoriteti kompetent

SHTOJCA 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

MIRATOHET

MINISTRI  
LEFTER KOKA

(firma, vula)

Nr. \_\_\_ Prot.

Nr.i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrit të AKM)

Datë \_\_\_\_\_

**AKT MIRATIMI**  
**Leje Mjedisi Tipi B**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisi, AKM propozon dhënien e lejes me kushtet bashkëngjitur për Kërkuesin si më poshtë;

a) Person juridik (Kompania) ( Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa,)

\_\_\_\_\_

ose

b) Personi Fizik ( emri, mbiemri, Nr NIPT.....)

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" \_\_\_\_\_
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" \_\_\_\_\_
3. Vendndodhja \_\_\_\_\_

Vlefshmëria e kësaj Leje dhe kushteve të saj fillon në datë \_\_\_\_\_

Tarifa e paguar në datë .....

- për kërkesë për leje mjedisi  
 ndryshim të kushteve të lejes

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**  
(emri, mbiemri, firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

REFUZOHET

MINISTRI  
LEFTER KOKA

(firma, vula)

Nr. \_\_\_Prot.

Nr. i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrit të AKM)

Datë \_\_\_\_\_

**AKT REFUZIMI**  
**Leje Mjedisit Tipi B**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisit, AKM jep mendimin për refuzimin e lejes me argumentimet bashkëngjitur për Kërkesuesin si më poshtë;

- a) Person juridik (Kompania) ( Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa)

\_\_\_\_\_

ose

- b) Personi Fizik ( emri, mbiemri, Nr NIPT.....)

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kolonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" \_\_\_\_\_
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kolumnës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" \_\_\_\_\_
3. Vendndodhja \_\_\_\_\_

Tarifa e paguar në datë .....

- për kërkesë për leje mjedisit  
 ndryshim të kushteve të lejes

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**  
(emri, mbiemri, firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

## Përmbajtja

Kushti	1	Objekti
Kushti	2	Menaxhimi i Instalimit
Kushti	3	Funksionimi dhe Infrastruktura
Kushti	4	Plani i përputhshmërisë
Kushti	5	Interpretimi
Kushti	6	Njoftimet
Kushti	7	Shkarkimi
Kushti	8	Menaxhimi i Mbetjeve
Kushti	9	Zhurma
Kushti	10	Lëndët e para dhe përdorimi i energjisë
Kushti	11	Monitorimi
Kushti	12	Dokumentimi dhe raportimi tek autoriteti kompetent
Kushti	13	Incidentet dhe veprimet gjatë emergjencave
Kushti	14	Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve

## Akronime dhe Shkurtime

DPP	Drejtoria e Punëve Publike
KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
KEM	Katalogu Evropian i Mbetjeve
MM	Ministria e Mjedisit
N <sub>eq</sub>	Niveli Ekuivalent i Tingullit
IPPC	Integrated Pollution Prevention and Control Direktiva e Kontrollit dhe Parandalimit të Integruar të Ndotjes
ISO	Organizata ndërkombëtare për standardizimin
POA	Përbërës Organikë të Avullueshëm
TMD	Teknikat më të Mira të Disponueshme
RESHTN	Regjistri Evropian i Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve
RSHTN	Regjistri Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve
RSHN	Regjistri i Shkarkimit të Ndotjes
RVM	Raporti Vjetor i Mjedisit
SMM	Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit
VKSH	Vlerë Kufi e Shkarkimit

## KUSHTI 1 – OBJEKTI

- 1.1. Kjo Leje, dhe kushtet e përcaktuara në të, jepet për veprimtaritë dhe kapacitetet e përcaktuara në kapitullin 2-4 të kërkesës për këtë Leje, ose e modifikuar sipas kushteve të kësaj Leje. Operatori është i autorizuar të zhvillojë veprimtaritë dhe/ose veprimtaritë shoqëruese siç specifikohen në Tabelën 1.1.1 dhe 1.1.2.

TABELA 1.1.1 – Lista e Veprimtarive		
Veprimtaria sipas Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 17.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit"	Përshkrim i veprimtarisë së specifikuar	Kapaciteti kufi i veprimtarisë së specifikuar

TABELA 1.1.2 – Lista e Veprimtarive Shoqëruese	
Veprimtaritë shoqëruese kryesore	Përshkrim i veprimtarisë së specifikuar

- 1.2. Operimi, kontrolli, mirëmbajtja e instalimit dhe shkarkimet nga instalimi duhet të kryhen vetëm në përputhje me kushtet e kësaj Leje. Të gjitha programet, planet dhe dokumentet e tjera që do të gjenerohen si rezultat i kësaj Leje do të jenë pjesë përbërëse e saj.
- 1.3. Ndryshimet në lidhje me funksionimin dhe ndryshimet e konsiderueshme në lidhje me instalimin, që mund të çojnë në një ndryshim në natyrën e shkarkimeve ose rritje të tyre, në sistemin e pakësimit të shkarkimeve, në lëndën djegëse, lëndët e para dhe materialet ndihmëse, produktet ose gjenerimin e mbetjeve, në menaxhimin e instalimit dhe kontrollin, mund të kryhen vetëm pas një kërkesë paraprake me shkrim dhe miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.
- 1.4. Kjo Leje jepet me qëllim parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes në përputhje me Ligjin Nr. 10431, datë 09.09.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" dhe legjislacionin mjedisor në fuqi dhe nuk e përjashton mbajtësin e kësaj Leje nga detyrimet që rrjedhin nga ligjet e tjera në fuqi.
- 1.5. Instalimi për të cilin është dhënë kjo Leje nuk duhet të vihet në punë derisa të jenë marrë masat e mëposhtme dhe AKM si autoritet kompetent të jetë njoftuar me shkrim për këtë.
- 1.5.1. Nëse është e nevojshme, shtoni kushte tjera ose theksoni: nuk kërkohet ASNJË masë para-operacionale shtesë.

- 1.6. Në këtë Leje, vendndodhje nënkupton zonën e përcaktuar nga vija e kuqe (me ngjyrë të errët) në hartën e mëposhtme (me koordinatat e përzgjedhura - gjatësia dhe gjerësia - Koordinatat e vendit sipas Sistemit të Koordinatave (GAUS KRUGE: 1942\_GK\_ZONE\_4)). Veprimtaritë e autorizuara sipas kushtit 1.1 nuk duhet të shtrihen përtej vendndodhjes, që është zona e përcaktuar në hartën e mëposhtme.

## **Harta**

**Koordinatat e vendit sipas Sistemit të  
Koordinatave (GAUS KRUGE:  
1942\_GK\_ZONE\_4)**

## **KUSHTI 2 – MENAXHIMI I INSTALIMIT**

- 2.1. Të gjitha impiantet, pajisjet dhe mjetet teknike të përdorura për operimin e instalimit për të cilin është dhënë kjo Leje mbahen në kushte të mira funksionimi.
- 2.2. Operatori i pajisur me Leje duhet do të punësojë në vendndodhje si person përgjegjës për instalimin, në përputhje me natyrën e punës, një menaxher me arsimin dhe eksperiencën e duhur. Menaxheri ose një person i caktuar prej tij si person përgjegjës, që të ketë gjithashtu arsimin dhe eksperiencën e duhur, duhet të jenë te pranishëm në vendndodhje vazhdimisht gjatë orarit të operimit të instalimit. Menaxheri/Personi përgjegjës duhet të jenë te disponueshëm për t'u takuar me personat e autorizuar të autoritetit kompetent në çdo kohë.
- 2.3. Operatori duhet të sigurojë që të gjithë punonjësit, të kontraktuarit apo persona të tjerë që kryejnë detyra specifike të jenë të kualifikuar si duhet, të trajnuar dhe të njohur si duhet me kushtet e kësaj Leje.
- 2.4. Regjistri Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (RrSHTN)
  - 2.4.1. Jo më vonë se (\_\_\_\_\_) muaj pas hyrjes në fuqi të rregullave dhe kërkesave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për RrSHTN, mbajtësi i Lejes duhet të deklarojë në AKM të dhënat për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve që janë subjekt i këtij Rregjistri.
- 2.5. Dokumentacioni
  - 2.5.1. Operatori duhet të hartojë dhe mirëmbajë dokumentacionin lidhur me menaxhimin e përbërësve të mjedisit për instalimin/impianitit e tij në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe kërkesat e autoritetit kompetent.
  - 2.5.2. Menaxhimi i informacionit mjedisor bëhet nga AKM/ARM sipas legjisilacionit në fuqi.
  - 2.5.3. Operatori duhet t'i sigurojë një kopje të Lejes çdo personi detyrat, kompetencat apo përgjegjësitë e të cilit lidhen me ndonjë kusht të kësaj Leje.
- 2.6. Veprimet Korrigjuese
  - 2.6.1. Operatori duhet të hartojë procedurat për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese për rastet kur nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë Leje dhe duhet të përcaktojë përgjegjësitë dhe autorizimet për të filluar ivestigimet dhe për të ndërmarrë veprimet korrigjuese përkatëse.
- 2.7. Trainimi
  - 2.7.1. Mbajtësi i Lejes duhet të hartojë procedurat për identifikimin e nevojave për trainim dhe duhet të zhvillojë trainimet e duhura për të gjithë punonjësit, puna e të cilëve mund të ketë ndikime të rëndësishme në mjedis. Të dhënat dhe dokumentacioni i trainimeve i vihen në dispozicion inspektorëve.
  - 2.7.2. Punonjësit që kryejnë një detyrë specifike duhet të kenë arsimin, trainimin dhe përvojën e përshtatshme me natyrën e punës.
- 2.8. Përgjegjësia

2.8.1. Operatori duhet të sigurojë praninë e një personi përgjegjës në çdo kohë gjatë operimit të instalimit. Personi përgjegjës duhet të jetë i autorizuar dhe i disponueshëm për t'u takuar me persona të autorizuar nga Ministria ose Inspektorati.

## 2.9. Komunikimi

2.9.1. Operatori duhet të hartojë një procedurë për t'i mundësuar publikut marrjen e informacionit lidhur me performancat mjedisore në çdo kohë. Kjo procedurë duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent për miratim së bashku me dokumentacionin e Lejes.

2.9.2. Operatori duhet të paraqesë një Raport Vjetor të Mjedisit tek autoriteti kompetent çdo vit kalendarik. Ky raport, duhet të përfshijë minimalisht informacionin e specifikuar në Tabelën 2.9.1 më poshtë (Përmbajtja e Raportit të Mjedisit).

<b>TABELA 2.9.1 – Përmbajtja e Raportit Vjetor të Mjedisit</b>
Programi i Menaxhimit të Mjedisit– raport
Regjistri i shkarkimit dhe transferimit të ndotjes – raporti për vitin paraardhës
Regjistri i shkarkimit dhe transferimit të ndotjes – propozimi për vitin ushtrimor aktual
Raport përmbledhës mbi rezultatet për monitorimin e zhurmës
Përshkrim i monitorimit të mjedisit
Përshkrim i monitorimit të zhurmës
Përshkrim i incidenteve/aksidenteve
Raporti për testimin e depozitave dhe tubacioneve
Raport përmbledhës për auditimin e efikasitetit të energjisë, përfshirë raportin e djegies të secilit <i>bojler</i> në instalim, të kryer nga një person/laborator i autorizuar/certifikuar
Raport për vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të lëndëve të para dhe reduktimin e gjenerimit të mbetjeve
Dokumentacioni përkatës për menaxhimin e mbetjeve
Raporti për progresin dhe propozimet për reduktimin e konsumit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura
Deklaratë mbi masat për parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe veprimet e rehabilitimit (përgjegjësia mjedisore)
Përshkrim i vlerësimit të riskut në terma të përgjegjësisë mjedisore (çdo tre vjet ose më shpesh nëse kjo bëhet e nevojshme nga kushtet në vendndodhje)
Raporte të tjera të kërkuara nga autoriteti kompetent

## **KUSHTI 3 – OPERIMI DHE INFRASTRUKTURA**

- 3.1.** Operatori duhet të krijojë të gjithë infrastrukturën e duhur në lidhje me këtë Leje, në përputhje me kushtet e kësaj Leje, përpara fillimit të funksionimit të instalimit.
- 3.2.** Operatori duhet të parashikojë në çdo pikë shkarkimi një vend për pajisjet e marrjes së mostrave ose monitorimit, duke përfshirë edhe pajisjet për mbledhjen e të dhënave dhe komunikimin e tyre siç kërkohet nga autoriteti kompetent.
- 3.3.** Operatori duhet të sigurojë akses të sigurt në të gjitha pikat e marrjes dhe monitorimit të mostrave në vendndodhje si dhe tek ato që ndodhen jashtë saj, në përputhje me kërkesat e autoritetit kompetent ose të inspektoratit të mjedisit.
- 3.4.** Ruajtja në depozita dhe fuçi
  - 3.4.1.** Sipërfaqet ku janë vendosur depozitat dhe/ose fuçitë duhet të jenë të papërshkueshme dhe rezistente ndaj materialit të ruajtur brenda tyre.
  - 3.4.2.** Të gjitha zonat me depozita dhe/ose fuçi duhet të jenë minimalisht të mbyllura me argjinatura/rrethime lokale ose në distancë me vëllim të barabartë ose më të madh se vlerat e mëposhtme:
    - a) 110% të kapacitetit të depozitës më të madhe që tërhiqet nga graviteti në drejtim të argjinaturës/rrethimit;ose
    - b) 25% të shumës së kapaciteteve të të gjithë depozitave që tërhiqen nga graviteti në drejtim të një argjinature/rrethimi të dhënë.
  - 3.4.3.** Të gjitha rrjedhjet nga zona e rrethuar duhet të devijohen për t'u mbledhur dhe asgjësuar në mënyrë të sigurt.
  - 3.4.4.** Çfarëdolloj tubi hyrje ose dalje, valvule, tubat e daljes dhe matësit duhet të mbahen brenda zonës së argjinaturës/rrethuar.
  - 3.4.5.** Të gjitha argjinaturat/rrethimet duhet të testohen për dëmtime dhe mundësinë e depërtimit të ujit të paktën çdo tre vjet.
  - 3.4.6.** Operatori duhet të ketë sasi të mjaftueshme të përthithësit në vendndodhje, i cili do të përthithë çdo derdhje në instalim. Përthithësi, pas përdorimit duhet të asgjësohet në mënyrë të përshtatshme për tipin e materialit përthithës.
  - 3.4.7.** Operatori, duhet të kryejë një vlerësim të riskut në mënyrë që të përcaktojë nëse është e nevojshme të mbahet uji i përdorur për shuarjen e zjarrit përpara paraqitjes së kërkesës për Leje.
  - 3.4.8.** Nëse përcaktohet që risku ekziston, operatori duhet të përgatisë një Program për Menaxhimin e Riskut, i cili duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent për miratim. Programi duhet të zbatohet tërësisht brenda 3 muajve nga marrja e Lejes.
- 3.5.** Nuk duhet të ketë mbetje të ndërtimit brenda instalimit dhe rrugët duhet të mirëmbahen në mënyrë që të mos shkaktohet gjenerim i pluhurave.
- 3.6.** Të gjithë transportuesit shirit në vend të hapur si dhe ato në ambientet e brendshme me shpejtësi të barabartë ose më të madhe se 3m/s duhet të mbyllën nga sipër.

## KUSHTI 4 – PLANI I PËRPUTHSHMËRISË DHE AFATET KOHORE

Operatori duhet të zbatojë Planin e Përputhshmërisë siç përcaktohet në Tabelën 4.1.1. Përmbajtja e Planit të Përputhshmërisë dhe afatet kohore të zbatimit janë paraqitur në tabelën më poshtë:

TABELA 4.1.1 – Plani i Përputhshmërisë						
Kushti Ref.	Veprimtaria e Përputhshmërisë	Kostot e investimit (EURO)	Fillimi i veprimtarisë (datë)	Fundi i veprimtarisë (datë)	Rezultatet e veprimtarisë	Metoda e kontrollit
		(Totali)				

### SHËNIM

<i>Veprimtaritë:</i>	Përshkrim i veprimtarisë/veprimtarive që duhet të zhvillohen në mënyrë që të arrihet përputhshmëria e instalimeve me legjislacionin e mjedisit
<i>Investimet:</i>	Investimet për veprimtarinë
<i>Fillimi:</i>	Data (muaji/viti) në të cilën është planifikuar fillimi i veprimtarisë
<i>Përfundimi:</i>	Data (muaji/viti) në të cilën është planifikuar përfundimi i veprimtarisë ose nisja e operacioneve
<i>Rezultatet e Veprimtarisë:</i>	Duhet të përshkruhen rezultatet specifike (shembull: reduktimi i shkarkimeve)
<i>Metoda e kontrollit:</i>	Përshkrim i mënyrës sipas të cilës mund të kontrollohet veprimtaria e kryer

### TABELA 4.1.2 – Afatet kohore

	Veprimtaritë	KOSTOT VJETORE – EURO				
		Viti*	Viti*	Viti*	Viti*	Viti*

\*Analizat kosto-përfitim të operatorit, përfshirë shpenzimin vjetor të nevojshëm për zbatimin e secilës veprimtari të tabelës 4.1.2.

## **KUSHTI 5 – INTERPRETIMI**

**5.1.** Vlerat kufi për shkarkimet në ajër duhet të interpretohen si më poshtë:

**5.1.1.** Monitorimi i vazhdueshëm:

- a) Asnjë vlerë mesatare për 24 orë nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të shkarkimit;
- b) 95% të të gjithë vlerave mesatare për 30 minuta nuk duhet të tejkalojë vlerat kufi të shkarkimit me më shumë se 20%;
- c) Asnjë vlerë mesatare për 30 minuta nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të shkarkimit më shumë se dy herë.

**5.1.2.** Monitorim jo i vazhdueshëm:

- a) Nëse për ndonjë arsye, 30 minuta marrje mostre nuk është e mundur të realizohet, është e nevojshme të aplikohet një periudhë e përshtatshme e marrjes së mostrës, dhe vlerat e përfutuara nuk duhet të tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimit.
- b) Për rrjedhjen, asnjë mesatare ditore nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi.
- c) Për parametrat e tjerë, asnjë vlerë mesatare për 30 minuta nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të shkarkimit.
- d) Pragjet e rrjedhjes në masë duhet t'i referohen shkarkimeve të shprehura në njësi të kg/orë mbi të cilat zbatohet vlera kufi e shkarkimit të përqendrimit.
- e) Vlerat prag të rrjedhjes në masë duhet të llogariten mbi bazën e përqendrimit të përcaktuar si një mesatare në një periudhë të dhënë të shumëzuar me një matje të përshtatshme të rrjedhjes. Asnjë vlerë e përcaktuar në këtë mënyrë nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të përcaktuar të rrjedhjes në masë.

**5.2.** Vlerat kufi të përqendrimit për shkarkimet në ajër të përcaktuara në këtë Leje duhet të bazohen në vëllimin e gazit në kushte normale:

**5.2.1.** Gazet jo të djegshëm:

- a) Temperatura 273K, trysnia 101.3kPa (pa korrigjim për oksigjenin ose përmbajtjen e ujit).

**5.2.2.** Gazet e djegshëm:

- a) Temperatura 273K, trysnia 101.3kPa, gaz i thatë; 3% oksigjen për lëndët djegëse të lëngshme dhe të gazta, 6% oksigjen për lëndët djegëse të ngurta.

**5.3.** Vlerat kufi për shkarkimet në ujë:

**5.3.1.** Matje e vazhdueshme:

- a) Asnjë vlerë e pH nuk duhet të jetë jashtë gamës së specifikuar.
- b) Asnjë vlerë e rrjedhjes nuk duhet të tejkalojë kufirin e specifikuar.

**5.3.2.** Matja jo e vazhdueshme:

- a) Asnjë vlerë e pH nuk duhet të jetë jashtë gamës së specifikuar.
- b) Asnjë vlerë e temperaturës nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi.

- c) Për të gjithë parametrat përveç pH-it, temperaturës dhe rrjedhjes, asnjë mostër mesatare ditore nuk duhet të tejkalojë vlerat kufi të shkarkimit të specifikuara në Shtojcën 3 të Ligjit për Lejet e Mjedisit.
- d) Për të gjithë parametrat përveç pH-it, temperaturës dhe rrjedhjet, asnjë mostër e rastësishme nuk duhet të tejkalojë 1.2 herë vlerat kufi të shkarkimit të përcaktuara në Shtojcën 2.1 dhe /ose 3.1.

#### **5.4. Zhurma**

- 5.4.1. Zhurma nga instalimi nuk duhet të kalojë ato nivele të përcaktuara për të nga legjislacioni në fuqi për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Shqipëri. Vlerat kufi të zhurmës duhet të përcaktohen në varësi të vendndodhjes së secilit instalim bazuar në hartat strategjike të zhurmës që ndajnë territorin e Republikës së Shqipërisë për këtë qëllim.

#### **Për Minierat:**

#### **5.5. Vibrimet**

- 5.5.1. Vibrimet nga shpërthimet duhet të mos çenojnë/dëmtojnë palët e treta në ambientet apo banesat përreth.

## KUSHTI 6 – NJOFTIMET

**6.1.** Operatori, brenda \_\_\_\_\_(orëve/ditëve) nëpërmjet telefonit, faksit, postës elektronike, duhet të njoftojë AKM dhe Inspektoratin e Mjedisit lidhur me:

- 6.1.1.** Konstatimin e një shkarkimi të çdo substance nga çdo burim potencial, i cili tejkalon ndonjë kufi ose kriter në këtë Leje të specifikuar në lidhje me substancën;
- 6.1.2.** Konstatimin e çdo shkarkimi flurues i cili ka shkaktuar ose mund të shkaktojë ndotje përveç rasteve kur sasia e shkarkuar është kaq e parëndësishme sa do të ishte e pamundur të shkaktonte ndotje;
- 6.1.3.** Konstatimin e çdo keqfunksionimi, defekti ose avarie të impiantit ose teknikave që kanë shkaktuar ose mund të kenë potencialin të shkaktojnë ndotje; dhe
- 6.1.4.** Çdo aksident që ka shkaktuar ose mund të ketë potencialin të shkaktojë ndotje.

Në njoftim, operatori duhet të tregojë qartë datën dhe kohën e incidentit, detajet e ngjarjes dhe masat për të minimizuar çdo shkarkim.

**6.2.** Operatori duhet të njoftojë me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur, për secilin nga rastet e mëposhtme:

- 6.2.1.** Ndërprerjen e përhershme të operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për të cilin është dhënë Leja;
- 6.2.2.** Ndërprerjen e operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për të cilin është dhënë Leja për një periudhë, që ka gjasa të tejkalojë (\_\_\_\_) vit/vjet; dhe
- 6.2.3.** Rifillimin e operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për të cilin është dhënë Leja pas një ndërprerje të njoftuar sipas pikës 6.2.2.

**6.3.** Operatori duhet të njoftojë me shkrim autoritetin kompetent lidhur me çështjet e mëposhtme, brenda (\_\_\_\_) ditëve nga ndodhja e tyre:

- 6.3.1.** Çdo ndryshim në emrin tregtar të operatorit, emrin e regjistruar ose adresën e zyrave të regjistruara, në përputhje me të dhënat që rezultojnë në Ekstraktin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR);
- 6.3.2.** Cdo ndryshim në të dhënat e shoqërisë mëmë të Operatorit (përfshirë detajet e shoqërisë mëmë kur vlerësohet se ekziston një marrëdhënie mëmë-Operator dhe Operatori është bërë shoqëri bijë)<sup>1</sup>;
- 6.3.3.** Çdo hap i ndërmarrë me synimin që Operatori të shkojë drejt administrimit, të lidhë një marrëveshje vullnetare ose të shkojë drejt procedurave të likuidimit.

---

<sup>1</sup> Për cdo informacion shtesë, lutemi konsultoni Pjesën e VII "Grupimi I shoqërive", të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## KUSHTI 7 – SHKARKIMET

### 7.1. SHKARKIMET NË AJËR

7.1.1. Shkarkimet në ajër nga pika(t) e shkarkimit të specifikuara në Tabelën 7.1.1 duhet të dalin vetëm nga burimi(et) e specifikuara në atë Tabelë. (Referohuni numrit të referencës së Planit të vendndodhjes)

Tabela 7.1.1: Pikat e shkarkimit në ajër	
Numri i referencës i pikës së shkarkimit:	A1
Vendndodhja e pikës së shkarkimit (përdor Sitemin e Koordinatave GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4):	X: Y:
Burimi	
Sasia e emetuar: maksimumi ditor:	m <sup>3</sup>
Rrjedhja maksimale në një orë:	m <sup>3</sup> /h
*Lartësia minimale e shkarkimit:	m mbi tokën

\* Përsëriteni për pikat e tjera të shkarkimit

7.1.2. Kufijtë për shkarkimet në ajër për parametrin/parametrat dhe pikën/pikat e shkarkimit të përcaktuara në Tabelën 7.1.2 nuk duhet të tejkalohen në periudhën kohore të treguar në këtë Tabelë.

TABELA 7.1.2: Vlerat kufi të shkarkimeve në ajër		
Parametrat	Referenca e pikës së shkarkimit A1-1	
	Deri në (datën)*	Nga (data)**

\* VKSH para zbatimit të Planit të Përputhshmërisë

\*\* VKSH bazuar në TMD të arritura pas zbatimit të Planit të Përputhshmërisë

*Shto rreshta dhe/ose kolona nëse është e nevojshme*

*Për çdo pikë shkarkimi tabelë e veçantë*

7.1.3. Operatori duhet të kryejë monitorimin dhe analizën për çdo shkarkim/parametër të listuar në Tabelën 7.1.3 nga pikat e shkarkimit dhe të paktën në frekuencat e specifikuara në atë Tabelë. Analiza duhet të kryhet me aparate/mjete të kalibruar ose në rastin e monitorimit jo të vazhdueshëm matjet duhet të kryhen nga një ekspert ose laborator i çertifikuar.

<b>TABELA 7.1.3 - Monitorimi i parametrave nga pika(t) e shkarkimit</b>		
Parametri	Pika e shkarkimit (A1-1)	Metodat /teknikat
	{Specifiko shpeshtësinë}	-
	{ Specifiko shpeshtësinë }	-
	{Specifiko shpeshtësinë}	-

\* Një grup tabelash për pajisjet e reduktimit të shkarkimeve në çdo vend shkarkimi

\* Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kushtet e reja kanë hyrë në fuqi.

- 7.1.4.** Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimit, monitorimit dhe kontrollit duhet të kalibrohen dhe mirëmbahen, ndërkohë që janë në përdorim, dhe të dhënat e regjistruara përkatëse të kalibrimit dhe mirëmbajtjes duhet të mbahen në vendndodhje dhe të jenë të disponueshme në rast inspektimi nga personeli i autorizuar i autoritetit kompetent. Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimit duhet të funksionojnë gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprimtarive, përveç rasteve kur është rënë dakord me autoritetin kompetent për zgjidhje alternative.
- 7.1.5.** Raporti përmbledhës mbi shkarkimet duhet t'i dërgohet Inspektoratit të Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit çdo (\_\_\_\_) muaj dhe duhet të përfshihet në Raportin Vjetor të Mjedisit.
- 7.1.6.** Të gjitha shkarkimet nga instalimi nuk duhet të kenë erë të pakëndshme sulmuese jashtë kufirit të instalimit.
- 7.1.7.** Të gjitha shkarkimet në ajër, përveç avullit ose avull uji të kondensuar, nuk duhet të kenë pikëza, mjegull dhe tym të vazhdueshëm.
- 7.1.8.** Të gjitha shkarkimet nuk duhet të kenë tym të dukshëm. Nëse për arsye mirëmbajtje, shkaktohen shkarkime tymi për shkak të rindezjes nga i ftohti, kjo nuk duhet të ndodhë për një periudhë më të gjatë se 20 minuta në çdo periudhë prej 8 orësh dhe kur të jenë marrë të gjithë hapat praktikë për të minimizuar shkarkimin.
- 7.1.9.** Shkarkimet e përgjithshme të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) nuk duhet të tejkalojnë 20% të tretësit të përdorur, nëse konsumi tejkalon 5t/vit.
- 7.1.10.** Operatori, brenda gjashtë muajve nga data e lëshimit të kësaj Leje, duhet të përgatisë një plan të përshtatshëm të menaxhimit të tretësve organikë dhe t'ia paraqesë autoritetit kompetent për miratim.
- 7.1.11.** Operatori, brenda gjashtë muajve nga data e lëshimit të kësaj Leje, duhet të përgatisë një program për identifikimin, monitorimin dhe pakësimin e shkarkimeve fluruese në ajër dhe paraqesë tek autoriteti kompetent për miratim. Programi duhet të zbatohet tërësisht brenda 3 muajve nga data e miratimit.
- 7.1.12.** Operatori duhet të sigurojë që veprimtaritë në vendndodhje të zbatohen në mënyrë të tillë që shkarkimet në ajër dhe (ose) erërat e pakëndshme të mos shkaktojnë dëmtime të rëndësishme të mjedisit përtej kufijve të instalimit.

## 7.2. SHKARKIMET NË KANALIZIME

7.2.1. Shkarkimet në kanalizime nga pika(t) e shkarkimit të specifikuara në Tabelën 7.2.1 duhet të dalin vetëm nga burimi(et) e specifikuara në këtë Tabelë.

**TABELA 7.2.1 Pikat e shkarkimit në kanalizime**

Numri i referencës i pikës së shkarkimit:	K1	
Koordinatat e pikës së shkarkimit në Sitemin e Koordinatave GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	X:	Y:
Burimi		
Kanalizimi		
Vëllimi i emetuar	Maksimumi ditor	m <sup>3</sup>
	Maksimumi në orë	m <sup>3</sup>

7.2.2. Kufijtë për shkarkimet në kanalizime për parametrin/parametrat dhe pikën/pikat e shkarkimit të përcaktuara në Tabelën 7.2.2 nuk duhet të tejkalohen në periudhën kohore të treguar në këtë Tabelë.

**TABELA 7.2.2 Vlerat kufi të shkarkimeve në kanalizime**

Parametri	Pika e shkarkimit K1		Pika e shkarkimit K2	
	Deri në (datën)	Nga (data)	Në (data)	Nga (data)
Rrjedhja (m <sup>3</sup> /h)				
pH				
Temperatura (°C)				
Toksiciteti				

7.2.3. Operatori duhet të kryejë monitorimin dhe analizën e parametrave të listuar në Tabelën 7.2.3 nga pikat e shkarkimit dhe të paktën në frekuencat e specifikuara në atë Tabelë.

**TABELA 7.2.3- Kërkesat e monitorimit për kanalizimet (nga dita/muaji /viti)**

Parametri	Pikat e shkarkimit (K1)	Metodat /teknikat
	{specifiko frekuencën}	-
	{specifiko frekuencën}	-
	{specifiko frekuencën}	-
Oksigjen i shpërbërë		-
Azot Amoniaku si N mg/l		
Rrjedhja ditore m <sup>3</sup>		
Niveli maksimal i rrjedhjes m <sup>3</sup> /orë		-
Përbërës organikë të fosforit		-

*Shënim: Një grup tabelash për pajisjet e reduktimit të shkarkimeve në çdo vend shkarkimi Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kushtet e reja kanë hyrë në fuqi.*

- 7.2.4.** Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimit, monitorimit dhe kontrollit duhet të kalibrohen dhe mirëmbahen, ndërkohë që janë në përdorim, dhe të dhënat e regjistruara përkatëse të kalibrimit dhe mirëmbajtjes duhet të mbahen në vendndodhje dhe të jenë të disponueshme në rast inspektimi nga personeli i autorizuar i autoritetit kompetent. Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimit duhet të funksionojnë gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprimtarive, përveç rasteve kur është rënë dakord me autoritetin kompetent për zgjidhje alternative.
- 7.2.5.** Raporti përmbledhës për shkarkimet duhet të përfshihet në Raportin Vjetor të Mjedisit.
- 7.2.6.** Operatori duhet të paraqesë raportin përmbledhës tek autoritetet e autorizuar të higjienës dhe të shëndetit publik.
- 7.2.7.** Përveç ujit sanitar, asnjë lloj tjetër uji nuk duhet të shkarkohet në kanalizime.
- 7.2.8.** Ujërat e ndotur nuk duhet të përmbajnë tretës organikë (përfshirë tretësit organikë të klorinuar) që mund të çojnë në krijimin e avujve shpërthyes brenda kanalizimeve.
- 7.2.9.** Operatori nuk duhet të shkarkojë lëndë të lëngshme ose lëndë të tjera që mund të ngecin ose ngurtësohen në temperaturën mesatare të ujit të kanalizimit ose mund të krijojnë gazra që marrin flakë ose që janë shpërthyes ose acide, alkaline apo substanca të tjera në përqendrimet që mund të shkatërrojnë tubacionet e kanalizimeve dhe pajisjet e tyre ose t'i dëmtojnë ato në mënyrë tjetër.
- 7.2.10.** Nuk lejohet të shkarkohet në kanalizime lëndë në përqendrimet të cilat do të ishin të rrezikshme për shëndetin e personelit të mirëmbajtjes ose të cilat do të ndikonin në trajtimin biologjik në fazat e ardhshme të trajtimit të ujërave të ndotura.
- 7.2.11.** Nuk duhet të shkarkohen në kanalizime substanca, në përqendrimet të cilat pas hollimit fillestar në një mjedis pritës mund të rezultojnë të dëmshme për jetën ujore.
- 7.2.12.** Operatori duhet t'i krijojë mundësi personelit të autorizuar nga autoriteti kompetent/inspektorati që të inspektojë, kontrollojë ose testojë çdo operacion ose pajisje në çdo kohë (moment) të arsyeshme në lidhje me ujërat e ndotur ose të marrë një mostër uji që është objekt i kushteve të kësaj Leje.
- 7.2.13.** Ndalohet shkarkimi i substancave të cilat shkaktojnë reaksione kimike ose që shkaktojnë krijimin e ndërmjetësve me ndikime të rëndësishme negative në mjedis.

### 7.3. SHKARKIMET NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË (PËRVEÇ SHKARKIMEVE NË KANALIZIME)

- 7.3.1. Shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë nga pika(t) e shkarkimit të specifikuara në Tabelën 7.3.1 duhet të dalin vetëm nga burimi(et) e specifikuara në atë tabelë.

TABELA 7.3.1: Pikat e shkarkimit në ujë	
Numri i referencës i pikës së shkarkimit:	U1
Koordinatat e pikës së shkarkimit në Sitemin e Koordinatave GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	X: Y:
Burimi	
Uji i pritur	
Rrjedhja :	
Maksimumi ditor:	m3/h
Maksimumi në orë:	m3/h

- 7.3.2. Kufijtë për shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë për parametrin/parametrat dhe pikën/pikat e shkarkimit të përcaktuara në Tabelën 7.3.2 nuk duhet të tejkalohen në periudhën kohore të treguar në këtë Tabelë.

TABELA 7.3.2 Vlerat kufi të shkarkimit në ujërat sipërfaqësorë				
Parametri	Pika e shkarkimit U1		Pika e shkarkimit U2	
	To (data)	Nga (data)	Në (data)	Nga (data)
Rrjedhja (m3/h)				
pH				
Temperatura (°C)				
Toksiciteti				
PE				

- 7.3.3. Operatori duhet të kryejë inspektime vizuale ditore të shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore. Të dhënat e inspektimit duhet të mbahen dhe të vihen në dispozicion autoritetit kompetent për inspektimin.
- 7.3.4. Monitorimi i ujërave të shkarkuara tek ujërat sipërfaqësore duhet të kryhet siç është përcaktuar në Tabelën 7.3.4 mbi Monitorimin e Shkarkimeve në Ujërat Sipërfaqësorë. Raporti duhet të jetë pjesë përbërëse e Raportit Vjetor të Shkarkimeve. Operatori duhet të marrë mostra dhe të monitorojë kanalin e kullimit {specifiko} në një frekuencë {specifiko}.

<b>TABELA 7.3.4 - Monitorimi i parametrave nga pika (t) e shkarkimit</b>		
Parametri	Pika e shkarkimit (TU 1)	Metodat/teknikat
	{Specifiko shpeshtësinë}	-
	{Specifiko shpeshtësinë}	-
	{Specifiko shpeshtësinë }	—

*Shenim: Një grup tabelash për pajisjet e reduktimit të shkarkimeve në çdo vend shkarkimi Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kushtet e reja kanë hyrë në fuqi.*

**7.3.5.** Nuk duhet të ketë asnjë shkarkim në ujë nga instalimi i pajisur me Leje mjedisi të ndonjë substance për të cilën nuk ka vlera kufi të specifikuar në Tabelën 3.1.2 (përveçse në një përqendrim i cili nuk është më i madh se sa përqendrimi i mjedisit ekzistues).

**7.3.6.** Në rast të ndonjë konstatimi të ndotjes, mbajtësi i Lejes duhet të:

- a) Kryejë menjëherë investigimin në mënyrë që të identifikojë dhe izolojë burimin e ndotjes.
- b) Përgatisë masat për parandalimin e ndotjes dhe reduktimin e pasojave nëse ndodh një ndotje e tillë.
- c) Njoftojë autoritetin kompetent dhe inspektoratin brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.

## **7.4. UJËRAT NËNTOKËSORË DHE TOKA**

**7.4.1.** Nuk lejohet të shkarkohet asnjë lëndë ndotëse në tokë ose në ujërat nëntokësorë nën vendndodhjen e instalimit.

**7.4.2.** Mjetet për mbrojtjen e tokës dhe ujërave nëntokësorë

Operatori duhet të zbatojë gjithashtu masat e mëposhtme:

- a. Testi i parë i papërshkueshmërisë së rrethimit/argjinaturës duhet të përfundohet brenda datës (dita/muaji /viti).
- b. Ngarkimi dhe shkarkimi i lëngjeve dhe lëndëve të tjera që mund të ndikojnë tek ujërat nëntokësorë, duhet të kryhet në zonat e përcaktuara në kërkesë për këtë qëllim dhe që janë të mbrojtura kundër rrjedhjeve ose derdhjeve.
- c. Të gjitha bashkimet dhe valvulat për transportin e të gjitha materialeve, duhet të kontrollohen rregullisht (inspektim vizual javor), me përjshatim të ujit të pastër për të cilin nuk ka mënyrë të parashikuar për kontrollin e shkarkimit.
- d. Të gjitha këto inspektime duhet të dokumentohen dhe të dhënat e regjistruara duhet të mbahen në vendndodhje dhe duhet t'i vihen në dispozicion personave të autorizuar për inspektim.

## KUSHTI 8 – MENAXHIMI I MBETJEVE

**8.1.** Asgjësimi dhe përdorimi i mbetjeve duhet të kryhet vetëm sipas përcaktimeve të Tabelës 8.1.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe Tabelës 8.1.2 të Shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të tjera në këtë Leje. Tipet e tjera të mbetjeve, me përjashtim të atyre të specifikuara në tabela, nuk duhet të asgjësohen/trajtohen në vendndodhje ose jashtë saj pa informuar më parë Ministrinë dhe pa marrë miratim me shkrim nga Ministria. (Nëse mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme nuk ruhen ose trajtohen në vendndodhje , është e nevojshme që në shtojcën përkatëse të shkruhet se "mbetjet nuk trajtohen/asgjësohen në këtë vendndodhje").

TABELA 8.1.1 Asgjësimi/trajtimi i mbetjeve të rrezikshme				
Mbetja	Numri i katalogut	Trajtim i mëtejshëm në vendndodhje	Ripërdorimi, riciklimi ose trajtimi në vendndodhje	Metoda e asgjëimit /trajtimin në vendndodhje

*Shenim: Shtoni rreshta nëse është e nevojshme*

TABELA 8.1.2 Asgjësimi/trajtimi i mbetjeve të tjera				
Mbetja	Numri i katalogut	Trajtim i mëtejshëm në vendndodhje	Ripërdorimi, riciklimi ose trajtimi në vendndodhje	Metoda e asgjëimit /trajtimin jashtë vendndodhjes

*Shenim: Shtoni rreshta nëse është e nevojshme*

**8.2.** Operatori, në përputhje me kushtet e kësaj Leje, duhet të trajtojë dhe ruajë mbetjet siç përshkruhet në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 8.2.1 për ruajtjen e Mbetjeve ose ndryshe siç është rënë dakord me shkrim nga autoriteti kompetent. Mbetjet nuk duhet të ruhen në vendndodhje për një periudhë më të gjatë se 1 vit në qoftë se ato janë paracaktuar për asgjësim ose jo më shumë se 3 vjet nëse ato janë të paracaktuar për riciklim/trajtim.

TABELA 8.2. 1: Mbetjet e ruajtura në vendndodhje			
Përshkrim i mbetjes	Vendndodhja e vendit të ruajtjes	Mënyra e ruajtjes	Kushtet e ruajtjes


*Shenim: Shtoni rreshta nëse është e nevojshme*

- 8.3.** Mbetjet e larguara nga vendndodhja për asgjësim/trajtim duhet të transportohen vetëm nga një kontraktor i autorizuar dhe i pajisur me Lejet/licensat përkatëse. Operatori, në përputhje me kushtet e kësaj Leje, duhet të rikuperojë dhe asgjësojë mbetjet siç përshkruhet në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 8.3.1 mbi rikuperimin dhe asgjësimin, apo ndryshe siç është rënë dakord me shkrim nga autoriteti kompetent.

Tabela 8.3.1: Rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve		
Përshkrimi	Dokument	Data e marrë

*Shenim: Shtoni rreshta nëse është e nevojshme*

- 8.4.** Amendamentet e e kërkesave të marrëveshjes, klasifikimit, trajtimit dhe asgjësimit duhet të kryhen vetëm me anë të një marrëveshje paraprake nga autoriteti kompetent.
- 8.5.** Paketimi, etiketimi duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet kombëtare, europiane dhe standardet e tjera..
- 8.6.** Nuk lejohet përzjerja e mbetjeve të rrezikshme të njëres kategori me mbetje të rrezikshme nga një kategori tjetër, me përjashtim të rasteve kur kjo është miratuar me shkrim nga autoriteti kompetent.
- 8.7.** Të gjitha të dhënat e regjistruara që lidhen me menaxhimin e mbetjeve duhet t'i vihen në dispozicion për inspektim autoritetit kompetent. Këto të dhëna duhet të përmbajnë si minimum elementët e mëposhtëm:
- Sasinë dhe kodet KEM (EWC) për mbetjen në Tabelën 4.1.1 të Shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe Tabelës 4.1.2 të Shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të tjera në këtë Leje.
  - Emrin e grumbulluesit të mbetjeve dhe transportuesit dhe detajet e Lejeve/licencave/autorizimeve të tyre (përfshirë autoritetin lëshues).
  - Detaje rreth instalimit për asgjësimin/trajtimin përfundimtar të mbetjeve dhe pajtueshmërinë e instalimit për asgjësimin/trajtimin e mbetjeve dorëzuara, detajet e Lejes/licencës/autorizimit dhe detajet për autoritetin lëshues.
  - Konfirmimin me shkrim për pranimin dhe asgjësimin/trajtimin të çdo dërgese mbetjesh jashtë vendndodhjes.
  - Detaje për çdo dërgesë jashtë shtetit për qëllim të trajtimit të përcaktuar si "të listës së Gjelbër" në bazë të Rregullores KEE Nr. 259/1993 dhe amendamenteve të saj. Arsyetimi për klasifikimin duhet të përbëjë një pjesë integrale të dokumentacionit.
  - Të dhëna për të gjitha dërgesat e refuzuara.

g) Detaje për të gjitha përzierjet e miratuara të mbetjeve në përputhje me kushtet e pikës 8.6.

8.8. Një kopje e dokumentacionit mbi menaxhimin e mbetjeve duhet t'i dorëzohet autoritetit kompetent si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit.

#### **Për Minierat:**

8.1. Bëzhdila/Mbetjet. Një plan për menaxhimin e bëzhdilave/mbetjeve duhet të dorëzohet në AKM brenda (\_\_\_\_) muajsh pas datës së lëshimit të lejes.

## **KUSHTI 9 – ZHURMA DHE VIBRACIONET**

9.1. Operatori duhet të propozojë shpeshtësinë, metodologjinë dhe kohën e matjeve.

9.2. Dokumentacioni mbi kushtet dhe rezultatet e matjes duhet t'i vihet në dispozicion për inspektim autoritetit kompetent ose inspektoratit të mjedisit në çdo kohë të arsyeshme. Raporti përmbledhës mbi këto të dhëna të regjistruara siç përcaktohet në Tabelën 9.1.1 duhet të jetë pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit.

<b>Tabela 9.1.1 Vlerat kufi të zhurmës</b>				
Vendndodhja	Koordinatat (Sistemi GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Natë
	X Y			
	X Y			

*Shenim: Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kanë hyrë në fuqi kushtet e reja.*

9.3. Veprimtaritë në vendndodhje nuk duhet të rezultojnë me nivele të rritura të zhurmës ose të tejkalojnë vlerat e mëposhtme (Leq, t):

Ditën: \_\_\_\_\_ dB (A)

Në mbrëmje: \_\_\_\_\_ dB (A)

Natën: \_\_\_\_\_ dB (A)

9.4. Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës gjatë operimit të instalimeve.

9.5. Operatori duhet të.....(kushte specifike për vibracionet/shpërthimet).

## **KUSHTI 10 – LËNDËT E PARA DHE SHFRYTËZIMI I ENERGJISË**

- 10.1.** Operatori duhet të kryejë auditimin e efikasitetit të energjisë brenda një viti nga lëshimi i kësaj Leje. Operatori duhet të konsultohet me autoritetin kompetent mbi natyrën dhe qëllimin e auditimit dhe të hartojë një program auditimi. Programi i auditimit duhet t'i paraqitet organit kompetent për miratim të paktën një muaj përpara kryerjes së tij. Kopja e raportit të auditimit duhet t'i vihet në dispozicion autoritetit kompetent në vendndodhje, dhe një përmbledhje e gjetjeve të tij duhet t'i paraqitet atij si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit. Auditimi i efikasitetit të energjisë duhet të kryhet në përputhje me intervalet e përcaktuara nga autoriteti kompetent.
- 10.2.** Operatori duhet të identifikojë çdo mundësi për përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe rekomandimet duhet të bëhen pjesë e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në Kushtin 2.
- 10.3.** Operatori duhet të identifikojë potencialin për reduktim të sasisë së ujit të përdorur në vendndodhje. Operatori duhet të paraqesë një raport të hollësishëm lidhur me progresin dhe propozimet për reduktimin e ujit të përdorur dhe shkarkimin e ujërave të ndotura tek autoriteti kompetent, si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit.
- 10.4.** Operatori duhet të përgatisë vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të lëndëve të para në të gjitha proceset, me theks të veçantë në reduktimin e mbetjeve të gjeneruara.

## **KUSHTI 11 – MONITORIMI**

**11.1.** Operatori duhet të kryejë marrjen e mostrave, të bëjë analiza, matje, testime dhe kalibrimin e pajisjeve, siç përcaktohet në Tabelat si vijon:

*Tabela 7.1.3: Monitorimi i shkarkimeve në ajër*

*Tabela 7.2.3: Monitorimi i shkarkimeve në kanalizime*

*Tabela 7.3.4: Monitorimi i shkarkimeve në ujërat sipërfaqësorë*

**11.2.** Nëse mundësia e matjes së një parametri ndikohet nga përzierja përpara shkarkimit, ky parametër duhet të matet përpara momentit të përzierjes, pas marrjes së miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.

**11.3.** Të gjithë monitorët automatikë dhe pajisjet e marrjes së mostrave duhet të funksionojnë në çdo moment (me përjashtim të periudhave gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimit) gjatë operimit të një instalimi, me përjashtim të rasteve kur autoriteti kompetent ka miratuar marrjen e mostrave ose monitorimin alternativ. Në rast të avarive ose mosfunksionimit të ndonjë pajisje të monitorimit të vazhdueshëm, operatori duhet të informojë autoritetin kompetent sa më shpejt të jetë e mundur dhe të vendosë një pajisje alternative. Përdorimi i pajisjeve alternative jashtë rasteve emergjente është i mundur vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.

**11.4.** Pajisjet për monitorimin dhe analizën duhet të përdoren dhe mirëmbahen në mënyrë që të tregojnë saktë shkarkimet dhe/ose çlirimet.

**11.5.** Ndryshimi i shpeshtësisë, metodës dhe qëllimit të monitorimit është i mundur vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent, bazuar në analizën e rezultateve të testimit.

**11.6.** Operatori duhet do të sigurojë akses të sigurt dhe të përhershëm për të mundësuar marrjen e të gjitha mostrave dhe monitorimet që do të kryhen në lidhje me pikat e shkarkimit që lidhen me:

- a) Shkarkimin në ajër
- b) Rrjedhjet pas largimit nga instalimi
- c) Burimet e zhurmës në vendndodhje
- d) Vendet e përcaktuara për asgjësimin e mbetjeve në vendndodhje
- e) Shkarkimet në ujërat sipërfaqësore

**11.7.** Operatori duhet të sigurojë akses të sigurt në të gjitha pikat e tjera monitoruese sipas kërkesës së autoritetit kompetent.

**11.8.** Marrja e mostrave dhe analizat duhet do të kryhen siç përcaktohen në standardet ISO.

## KUSHTI 12 – DOKUMENTIMI DHE RAPORTIMI

- 12.1. Operatori duhet të bëjë regjistrimin e të dhënave për të gjitha rastet e marrjes së mostrave, matjeve, testimeve, kalibrimeve dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të monitorimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Leje.
- 12.2. Operatori duhet do të hartojë dhe të mbajë dhëna për çdo incident që mund të ndikojë në funksionimin e rregullt dhe që mund të paraqesë një rrezik për mjedisin.
- 12.3. Operatori duhet të përgatisë një raport për çdo ankesë që ka të bëjë me mjedisin që lidhet me operimin e instalimit. Çdo raport duhet të përmbajë informacion mbi kohën dhe datën e ankesës, emrin e ankuesit dhe natyrën e ankesës. Operatori duhet të mbajë gjithashtu një kopje të përgjigjeve ndaj secilës ankesë. Brenda një muaji nga marrja e ankesës, operatori duhet të paraqesë një raport mbi ankesën tek autoriteti kompetent. Përmbledhja mbi numrin dhe natyrën e ankesave duhet të përfshihet në Raportin Vjetor të Mjedisit.
- 12.4. Forma e raportit duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kompetent. Këto raporte duhet të mbahen në vendndodhje të paktën (\_\_\_\_) vjet dhe të jenë të disponueshme në rast inspektimi.
- 12.5. Raportet mbi të gjitha të dhënat e regjistruara, rastet e marrjes së mostrave, të matjeve, analizave, kalibrimit dhe mirëmbajtjes siç përcaktohet në Tabelën e mëposhtme 12.1.1 Dokumentimi i të dhënave dhe Raportimi tek Autoriteti Kompetent duhet t'i dorëzohen autoritetit kompetent jo më vonë se (data dhe formati i raportit).

**Tabela 12.1.1. Dokumentimi i të dhënave dhe raportimi**

Paraqisni raporte të përfunduara tek:

Adresa:

Raporte	Shpeshtësia e raportimit	Data e paraqitjes së raportit
Monitorimi i shkarkimeve në ajër		
Monitorimi i shkarkimeve në ujëra		
Ujë sipërfaqësor		
Ankesa (nëse ka)		
Propozimi për regjistrin e shkarkimit të ndotjes		
Programi i Monitorimit të Zhurmës		
Programi i Menaxhimit të Mjedisit me shtojcë për objektivat dhe detyrat		
Raporti Vjetor i Mjedisit		

- 12.6. Me kërkesë të autoritetit kompetent, operatori duhet të paraqesë gjithashtu informacionin mjedisor në lidhje me këtë Leje në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit kompjuterik të autoritetit kompetent.
- 12.7. Të gjithë raportet duhet të miratohen nga menaxheri i përgjithshëm i instalimit ose nga menaxheri teknik i autorizuar nga menaxheri i përgjithshëm i instalimit.
- 12.8. Përshkrime me shkrim të procedurave për kontrollin e operimeve që mund të jenë të lidhura me Lejen, duhet t'i vihen në dispozicion nëpunësve të autorizuar të inspektoratit ose të autoritetit kompetent në vendndodhje në çdo kohë të arsyeshme.
- 12.9. Në varësi të rezultateve, autoriteti kompetent mund të ndryshojë shpeshtësinë dhe qellimin e raportimit.

### **KUSHTI 13 – INCIDENTET DHE VEPRIMET GJATË EMERGJENCAVE**

- 13.1. Brenda (\_\_\_\_) muajve nga dhënia e kësaj Leje, operatori duhet të miratojë një politikë për parandalimin e aksidenteve, në mënyrë të veçantë ato që mund të kenë ndikim në mjedis.
- 13.2. Brenda (\_\_\_\_) muajve nga dhënia e kësaj Leje, operatori duhet të përcaktojë procedurat për t'iu përgjigjur emergjencave, të cilat duhet të përfshijnë çdo situatë të rrezikshme që mund të krijohet në vendndodhje. Këto procedura duhet të përfshijnë masat që synojnë minimizimin e ndikimit në mjedis të këtyre situatave.
- 13.3. Politikat dhe procedurat duhet të vlerësohen çdo vit dhe amendohen sipas nevojës.
- 13.4. Operatori gjatë përgatitjes së politikës për parandalimin e aksidenteve duhet të marrë në konsideratë edhe parashikimet e ligjit "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe veçanërisht dispozitat mbi përgjegjësinë mjedisore.

## **KUSHTI 14 – ÇMONTIMI, REHABILITIMI DHE KONTROLLI PAS NDËRPRERJES SË OPERACIONEVE**

- 14.1.** Brenda (\_\_\_\_) muajve nga data e marrjes së Lejes, operatori duhet të përgatisë dhe paraqesë për miratim tek AKM një plan të detajuar dhe kostot përkatëse për çmontimin ose mbylljen e instalimit.
- 14.1.** Planet për çmontimin dhe rehabilitimin duhet të rishikohen çdo vit dhe të paraqiten për miratim në AKM.
- 14.2.** Pas mbylljes së instalimit ose të një pjese të tij për më shumë se (\_\_\_\_) muajsh ose ndërprerjes së planifikuar të operacioneve në të gjithë instalimin ose në një pjesë të tij, operatori duhet të kryejë rehabilitimin në përputhje me planin e miratuar nga AKM.
- 14.2.** Garanci Bankare ose Sigurim me qëllim vënien paraprakisht në dispozicion të fondeve për kompensimin e dëmit në përputhje me metodat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për sigurimin e fondeve të tilla.

SHTOJCA 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT

Nr. \_\_\_ Prot.

Nr. i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrit të ARM)

Datë \_\_\_\_\_

**AKT MIRATIMI**  
**Leje Mjedisit Tipi C**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,

Agjencia Rajonale e Mjedisit, jep miratimin për lejen e mjedisit me kushte të detajuara bashkëngjitur për Kërkuesin si më poshtë;

a) Person juridik (Kompania) ( Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa)

\_\_\_\_\_

ose

b) Personi Fizik ( emri, mbiemri, Nr NIPT.....)

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përkruaj sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" \_\_\_\_\_

2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përkruaj sipas kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" \_\_\_\_\_

3. Vendndodhja \_\_\_\_\_

Vlefshmëria e kësaj Leje dhe kushteve të saj fillon në datë \_\_\_\_\_.

Tarifa e paguar në datë \_\_\_\_\_

- për kërkesë për leje mjedisi  
 ndryshim të kushteve të lejes

**DREJTORI I ARM**  
(emri, mbiemri, firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT

Nr. \_\_\_ Prot.

Nr. i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrit të ARM)

Datë \_\_\_\_\_

**AKT REFUZIMI**  
**Leje Mjedisi Tipi C**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisi, ARM refuzon dhënien e lejes me argumentimet bashkëngjitur për Kërkuesin si më poshtë;

a) Person juridik (Kompania) ( Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa)

ose

b) Personi Fizik ( emri, mbiemri, Nr NIPTI.....)

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit"\_\_\_\_\_

2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit"\_\_\_\_\_

3. Vendndodhja\_\_\_\_\_

Tarifa e paguar në datë .....

për kërkesë për leje mjedisi

ndryshim të kushteve të lejes

**DREJTORI I ARM**  
(emri, mbiemri, firma, vula)



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT

## **Përmbajtja**

Kushti	1	Objekti
Kushti	2	Menaxhimi i Instalimit
Kushti	3	Operimi dhe Infrastruktura
Kushti	4	Njoftimet
Kushti	5	Shkarkimi
Kushti	6	Menaxhimi i Mbetjeve
Kushti	7	Zhurma

## **KUSHTI 1 – OBJEKTI**

1.1. Kjo Leje, dhe kushtet e përcaktuara në të, jepet për veprimtaritë dhe kapacitetet e përcaktuara në kapitullin 2-4 të kërkesës për këtë Leje.

1.2. Operimi, kontrolli, mirëmbajtja e instalimit dhe shkarkimet nga instalimi duhet të kryhen vetëm në përputhje me kushtet e kësaj Leje .

1.3. Ndryshimet në lidhje me funksionimin dhe ndryshimet e konsiderueshme në lidhje me instalimin, që mund të çojnë në një ndryshim në natyrën e shkarkimeve ose rritje të tyre, në sistemin e pakësimit të shkarkimeve, në lëndën djegëse, lëndët e para dhe materialet ndihmëse, produktet ose gjenerimin e mbetjeve, në menaxhimin e instalimit dhe kontrollin, mund të kryhen vetëm pas një kërkesë paraprake me shkrim dhe miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.

1.4. Kjo Leje jepet me qëllim parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes në përputhje me Ligjin Nr. 10431, datë 09.09.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” dhe legjislacionin mjedisor në fuqi dhe nuk e përjashton mbajtësin e kësaj Leje nga detyrimet që rrjedhin nga ligjet e tjera në fuqi.

## **KUSHTI 2 – MENAXHIMI I INSTALIMIT**

2.1. Operatori i pajisur me Leje duhet të punësojë një menaxher të instalimit të arsimuar në përputhje me natyrën e punës dhe me përvojë, si person përgjegjës.

2.2. Operatori i pajisur me Leje duhet të sigurojë që të gjithë punëmarrësit që kryejnë detyra specifike të jenë të kualifikuar, të trainuar dhe të njohur si duhet me kushtet e kësaj Leje.

2.3. Operatori duhet të krijojë dhe mirëmbajë dokumentacionin mbi menaxhimin e mjedisit, në përputhje me kërkesat e autoritetit kompetent.

## **KUSHTI 3 – OPERIMI DHE INFRASTRUKTURA**

3.1. Mbajtësi i Lejes do të ndërtojë të gjithë infrastrukturën që kërkohet nga kjo Leje, në përputhje me kushtet e saj përpara fillimit të funksionimit të instalimit.

3.2. Ruajtja në depozita dhe fuçi

3.2.1. Sipërfaqet ku janë vendosur depozitat dhe/ose fuçitë do të jenë të papërshkrueshme dhe rezistente ndaj materialit të ruajtur brenda tyre.

3.2.2. Të gjitha zonat me depozita dhe/ose fuçi duhet të jenë minimalisht të mbyllura me argjinatura/ rrethime lokale ose në distancë.

## **KUSHTI 4 – NJOFTIMET**

4.1. Operatori, brenda 24 orëve/ditëve nëpërmjet telefonit, faksit ose postës elektronike duhet të njoftojë AKM dhe Inspektoratin e Mjedisit lidhur me:

4.1.1. Konstatimin e shkarkimeve të rëndësishme në atmosferë nga çdo burim i mundshëm.

- 4.1.2. Konstatimin e keqfunksionimit ose prishjes së pajisjeve për uljen e shkarkimeve.
- 4.1.3. Çdo aksident që ka shkaktuar ose mund të ketë çuar në ndotje të konsiderueshme të ujërave nëntokësorë, ujërave sipërfaqësore, tokës ose ndonjë mjedisi tjetër.

Në njoftim, operatori duhet të tregojë qartë datën dhe kohën e incidentit, detajet e ngjarjes dhe masat për të minimizuar çdo shkarkim.

## **KUSHTI 5 – SHKARKIMET**

### **5.1. SHKARKIMET NË AJËR**

- 5.1.1. Nën kushtet normale të operimit, nuk duhet të ketë pluhur të dukshëm, përveç avullit të ujit.

### **5.2. SHKARKIMET NË KANALIZIME**

- 5.2.1. Nuk duhet të ketë shkarkime të tjera të rëndësishme në kanalizime.
- 5.2.2. Përveç ujit sanitar, asnjë lloj uji tjetër nuk duhet të shkarkohet në kanalizime, në sasi të konsiderueshme.
- 5.2.3. Ujërat e ndotura nuk duhet të kenë përmbajtje të tretësave organike (përfshirë tretësit organike të klorinuar) që mund të lehtësojnë krijimin e avujve shpërthyes brenda kanalizimeve.
- 5.2.4. Nuk lejohet të shkarkohet në kanalizime çfarëdolloj lëndë në përqendrim të cilat do të ishin të rrezikshme për shëndetin e personelit të mirëmbajtjes së kanalizimeve ose të cilat do të ndikonin në trajtimin biologjik në fazat e ardhshme të trajtimit të ujërave të ndotura.
- 5.2.5. Ndalohet shkarkimi i substancave të cilat shkaktojnë reaksione kimike ose krijimin e ndërmjetësve që janë me ndikime të rëndësishme negative për mjedisin.

### **5.3. SHKARKIMET NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË**

- 5.3.1. Nuk duhet të ketë shkarkime të tjera të rëndësishme në ujërat sipërfaqësorë

### **5.4. UJËRAT NËNTOKËSORË DHE TOKA**

- 5.4.1. Nuk lejohet të shkarkohet asnjë lëndë ndotëse në tokë ose në ujërat nëntokësorë nën vendndodhjen e instalimit.

## **KUSHTI 6 – MENAXHIMI I MBETJEVE**

- 6.1. Mbetjet nuk duhet të ruhen në vendndodhje për një periudhë më të gjatë se 1 vit në qoftë se ato janë paracaktuar për asgjësim ose jo më shumë se 3 vjet nëse ato janë të paracaktuar për riciklim/trajtim.
- 6.2. Mbetjet e larguara nga vendndodhja për asgjësim/trajtim duhet të transportohen vetëm nga një kontraktor i autorizuar dhe i pajisur me Lejet/licensat përkatëse.
- 6.3. Të gjitha të dhënat e regjistruara që lidhen me menaxhimin e mbetjeve duhet t'i vihen në dispozicion për inspektim autoritetit kompetent.

## **KUSHTI 7 – ZHURMA**

7.1. Veprimtaritë në vendndodhje nuk duhet të rezultojnë në nivele të rritura të zhurmës në zonat e ndjeshme, dhe nuk duhet të tejkalojnë vlerat e mëposhtme (Leq, t):

Ditën: \_\_\_\_\_ dB (A)

Në mbrëmje: \_\_\_\_\_ dB (A)

Natën: \_\_\_\_\_ dB (A)